



*Ismail*  
**KADARE**  
*DOSJA H*

BIBLIOTEK  
85H-31  
K 14



*roman*



8SH-31  
K 14

Ismail  
KADARE

---

DOSJA H

---

roman

---



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

*Lišma*

**ЕВАДАЦИ**

*Redaktor*

PIRO MISHA

---

*Piktor*

BESNIK TRUNGU

Recensues:

Dilaver Dilaveri  
Nasi Lera

— Ishte një ditë e mërzitshme, nga ato që dimri dukej sikur i kishte sajuar enkas për kryeqytetet e shteteve të vogla, të prapambetura, kur mbërriti posta diplomatike. Kërkesën për vizë të dy irlandezëve me banim të përkohshëm në Nju-Jork ambasada e Mbretërisë Shqiptare në Uashington e kishte shoqëruar me një shkressë përcjellëse, në të cilën, një herë ata quheshin «studiu të folklorit» dhe herën e dytë «të ash-tuquajturit studiu të folklorit». Të dhënat e tjera që jepeshin për ta ishin të kursyera. Thuhet se dinin pak shqip, se do të udhëtonin në Shqipëri për të bërë hulumtime për eposin e vjetër oral shqiptar dhe se kishin me vete skeda dhe harta të shumta, sidomos të zonës veriore, në afërsi të së cilës do të vendoseshin. Veç kë-

tyre, dhe kjo ishte më e çuditshmja, kishin me vefë ca aparate për regjistrimin e zërave dhe tingujve, aparate të papara ndonjëherë, që quhen magnetofonë dhe që, siç arritën të saronin nëpunësit e ambasadës, porsa ishin shpikur dhe vënë në përdorim. Në fund të shkresës thuhet se nuk përjashtohej mundësia që dy vizitorët të ishin spiunë.

Dy javë pas marrjes së njoftimit nga Uashingtoni dhe vetëm pak ditë para mbërritjes së irlandezëve, ministri i Brendshëm i dërgoi një shkresë nënprefektit të N., ku i shkruante pak a shumë të njëjtat gjëra që i kishte raportuar atij ambasada e Uashingtonit, me të vetmin ndryshim që fjalët «nuk përjashtohet mundësia që vizitorët të janë spiunë», qenë bërë «me sa duket vizitorët janë spiunë». Megjithatë, vazhdonte në shkresën e vet ministri, përgjimi i tyre duhej të bëhej më me kujdes, në mënyrë që ata kurrsesi të mos dyshonin për të, dhe në përgjithësi ishte mirë që vizitorët e huaja ndienin veten në N. si në shtëpinë e tyre.

Ministri buzëqeshi me vete duke përfytyruar habinë e nënprefektit për udhëzimin e fundit. Idiot, tha me vete. Ku mund të kuptosh ti në atë humbëtirë punët e shtetit. Përtej xhamave të dritares dukej pullazi i Ministrisë së Jashtme. Ministri e dinte se kishte muaj të tërë që funksionarët e saj, duke u endur kryeqytet më kryeqytet, nëpër Evropë e, duke shpërndarë

para djathtas e majtas, përpinqeshin të gjenin një gjysmë shkrimtari apo gjysmë historiani të huaj për të shkruar biografinë e mbretit. E po, helbete, i pëlqente të thoshte si me vete, njerëz të ditur këta të Ministrisë së Jashtme. Kur ishte fjala për t'i gjetur dashnore sovranit nëpër kabaretë e Parisit, apo çuna kryetarit të Parlamentit, apo gjithfarë punësh të fëlliqtë, ngarkonin atë, ministrin e Brendshëm, kurse, kur vinte puna për gjëra të larta, biografira, akademira, e ku di unë çfarë, merreshin të tjerët me to. Por ai do t'ua hidhte ndonjë ditë, t'i linte me gisht në gojë të gjithë, në qoftë se do të ishte ai dhe jo ata karafilët e Ministrisë së Jashtme, që të gjente shkruesin e biografisë së mbretit. Sa herë që kishin ardhur të huaj në Shqipëri, e kishte vrarë mendjen për këtë, por rast të volitshëm ende s'kishte pasur. Këta studiuesit irlandezë i dukeshin të përshtatshëm, aq më tepër që dyshoheshin për spiunë. Do t'i linte ca kohë të livadhitnin dhe pastaj, në qoftë se do të kishte fat, do t'i kapte me presh në duar (Kjo e fundit skicohej në mendjen e tij në dekorin e një krevati bashkëshortor, ku njëri prej tyre gjendej lakuriq bashkë me një grua). Pas kësaj ishte radha e tij të merrej me ta. «Pa ejani pakëz këtu, pëllumbthat e mi, lërini një çikë ato eposet e magnetofundet dhe uluni të bëni një punë për lalën. S'doni, ju dogja, vallahi. Aha, u zbutët, ashtu de. Tani ejani të me-

rremi vesh, një punë e thjeshtë është për ju. Studiues jeni, apo jo, sipas pasaportave keni mbaruar Universitetin e Ha... Ha... Havardit, apo jo? Shumë mirë, uluni tani, lala ju sjell letër e laps e mjaltë e para e kurva sa të doni, veç më mbaroni këtë punë. Të shkruani jetën apo biografinë, siç i thonë tani, të mbretit, ja këtë kërkon lala prej jush..»

I kënaqur, ministri mbylli zarfin për nën-prefektin e N. dhe kaq fort e përplasi vulën sipër tij, saqë ajo doli e dyzuar në zarf. Pas dy ditësh, kur në orën dhjetë të mëngjesit nën-prefekti e mori në dorë zarfin, para se ta hapte, e vështroi një grimë vulën. Përvoja i kishte mësuar se një vulë e tillë ishte zakonisht e një dore të tronditur ose nga zemërimi ose nga frika.

Shyqyr, tha me vete kur e lexoi shkresën. S'ishte as njëra, as tjetra. I lehtësuar, kapi do-rezën e telefonit për t'i dhënë lajmin së shoqes.

Ajo e ngriti telefonin me atë pikëllimin e lehtë, të shkaktuar nga dhjetëra zhgënjime që kishte pësuar prej ziles së tij, kur kishte vrapiuar përherë me shpresë se diçka të mirë e të jashtëzakonshme do të dëgjonte më në fund, kurse nga vrimat e vogla të dëgjueses s'kishin ardhur veçse fjalë të mërzitshme të të shoqit: çka je duke bërë, apo, dreka a është gati, ose kërkimi i formulës së një reçeli prej gruas së

rejtorit të Postë-Telegrafit, me të cilën thahethemet i kishin mbaruar prej kohësh.

Por këtë herë diçka kishte ndryshuar. Ajo ë po i thoshte i shoqi ishte gati e pabesuehme. saqë ajo, e trembur se mos e kishte dëjuar gabim, dy-tri herë thirri: po vijnë dy rlandezë te ne. Ashtu the? Po, po, i përgjigjej i. Madje për një kohë të gjatë.

— Ç'mrekulli, — nuk u përbajt dot ajo.  
— Sa mirë që ma the këtë lajm. U zgjova kaq mërzitur sot.

Kishte qenë vërtet i pikëlluar atë mëngjes. Shiu i kishte qullur xhamat ashtu si një ditë në parë dhe tymtarët e pullazeve matanë rrugës dukeshin si të përthyer nga kjo. O zot, ja jë ditë krejt si e djeshmja, kishte psherëtirë, e shtrirë siç qe në krevat. Asnjë mendim gjallërohej dot në trurin e saj, dhe ngjashmëria e ditës së sotme me të djeshmen iu duk si vërtetimi më i saktë, se kjo do të ishte një ditë e panevojshme, të cilën ajo do ta falte me qejf. Një çast iu duk se ndofta askujt nuk do t'i duhej një ditë e tillë, por aty për aty mendoi se kishte plot gra që do ta lakmonin atë thjesht për të pushuar pas javës së rëndë të punës, të sherreve në familje apo të të ftohtit.

Ishte duke menduar pak a shumë këtë gjë, domethënë se si ndoshta pak veta do ta besonin që ajo, gruaja tërheqëse e nënprefektit, duke pasur gjithë të mirat, mërzitez megjithatë për

vdekje në këtë qytetth; kur kishte rënë telefoni. Dita ishte dredhur e tendosur befas prej tij dhe nga një njësi kohe e flashkët qe shndërruar befas në të kundërtën e saj: një ditë e vërtetë plot të papritura dhe mister.

Dy irlandezë dhe për një kohë të gjatë, përsëriti me vete fjalët e të shoqit: Ç'mrekulli, mendoi. Ky dimër do të ishte tjetërloj. Dhe udhëzimi ishte që ta ndienin veten si në shtëpi të tyre, kishte thënë i shoqi në telefon. Natyrish, i qe përgjigjur ajo me mendje, ndërsa letrat e brixhit qenë shpalosur gëzueshëm në përfytyrimin e saj dhe bashkë me to zjarri i oxhakut dhe gotat prej kristali të pijes nën refleksin e flakës. Kanë sjellë me vete ca aparate të çuditshme, ca si gramafona, por shumë më modernë, kishte vazhduar t'i shpjegonte ai, dhe ajo e ndjeu veten në krahët e njërit prej tyre, pastaj të tjetrit duke vallëzuar «Tangon e xhelozisë». Me sa dukej, ishin të rinj, përdërisa kishin sjellë me vete të gjitha këto.

Ajo vrapi te telefonin, por në çast u step përparrë tij. Përparrë se t'i jepte lajmin e mrekullueshëm gruas së drejtorit të Postës, iu duk se do të ishte më mirë ta shijonte njëfarë kohe në vetmi.

Pra janë dy, mendoi, dhe, me sa dukët, të rinj. I shoqi i kishte thënë edhe emrat e tyre: Maks Roth dhe Vili Norton, kështu që ai

uhej të dinte edhe moshën e tyre. Në drekë rastësisht ajo do ta merrte vesh.

Pa e kuptuar se si, ajo qe drejtar nga anja. Një copë herë vështroi ndriçimin e ftohë të vaskës, pastaj duart e saj ngadalshëm u gjatën te rubineti i ujit të ngrohtë. Me lëvizje ë ngadalta nisi të zhvishej. E provoi ujët me orë dhe pa pritur që ai të arrinte mesin e vaskës, u fut në të. Disa herë i kishte ndodhur që, kur kishte qenë e ngarkuar me mendime të një lloji të veçantë, kishte ndier dëshirën që ajo t'i përsiaste zhytur në vaskën e banjës.

Ashtu, e shtrirë, me vështrim të përhumbur, vështron te se si niveli i ujit ngrihej pak nga pak, duke mbuluar trupin e saj. Kështu e mbulojnë njeriun, nisi të mendonte, por bëri një përpjekje për ta shkatërruar fundin e mendimit, ashtu siç bënte pérherë, kur ndonjë ide e shëmtuar ose tepër e kobshme lindte papritur në trurin e saj. Jo, jo, tha me vete. Ishte kaq herët të mendonte gjëra të tillë. Ajo ishte ende e re, tridhjetë e dy vjeçë dhe, veç kësaj, përpëra kishte një mrekulli të tillë, siç qe ardhja e dy irlandezëve. Maks Roth dhe Vili Norton, përsëriti me vete emrat e tyre. Kishte bërë mirë që prej kohësh qe kujtuar ta shndërronte emrin e saj të shëmtuar oriental Mukadez në Dezi. Shumica e njerëzve e kishin harruar emrin e saj të parë, disa nuk e dinin fare që ashtu uhej dhe, kur dikush, i shtyrë nga hutimi apo

ligësia e thërriste ashtu, ajo e llogariste qysh atë çast midis armiqve të saj. Dezi, tingëllonte vërtet bukur. Do të ishte kureshtare të dinte se si do t'u dukej atyre sikur ta dinin që një grua e re, me emrin Dezi, në vaskën e banjës, mendonte për ta. Ajo shpesh përpiquej t'i përfytyronte njerëzit sipas emrave që kishin. Ja dhe tani kishte nisur me mendjen e saj të bënte këtë gjë.

Kështu, pra, njëri prej tyre, ai Maks Rothi, kushedi pse, ndoshta për shkak të gërmave «r» dhe «ks» e sidomos të «th» (urith), iu përfytyrua pakëz leshtak e kuqs, kurse tjetri, Vili, me flokë të krehur lëmueshëm, më pak burrëror, por megjithatë më i rrezikshëm. Kishte èndërruar prej kohësh të njihej me një njeri me emër të tillë, të rrëshqitshëm, disi të pabesë, por që ishte tèrheqës pikërisht në pabesinë e tij.

Ujët e ngrohtë e kishte mbuluar tani plotësisht trupin e saj dhe ajo u kujtua se kishte harruar të merrte sapunin nga rafti. Po s'kishte gjë. Do të rrinte kështu thjesht brenda vaskës, ndoshta ishte edhe më mirë. Pa dyshim ishte më mirë, mendoi papritur. Kishte vënë re se shkuma e sapunit në kësorastesh bashkë me tejdukshmërinë e ujit, prishte edhe fluturimin e fantazisë.

Me vështrimin e pjerrët ajo vërente se si nën syprinën e ujit trupi i saj i bardhë, me

njollën e pubisit në mes, valavitej i dyzuar. Kishte në atë lëkundje një molisje tinëzare, e cila bënte që gjithçka të dukej e pakapshme dhe me dy kuptime.

Sado që përpiquej të mos ia pohonte vetes aq haptas, ajo e ndiente se në atë provincë të mërzitshme, ajo ishte e pjekur plotësisht për një aventurë dashurie. S'ishte e rastit që pak më parë, ndërsa ujët po e mbulonte, mendime të trishtueshme përpinqeshin ta kaplonin. Një mallëngjim që kishte kujtar se e kishte harxhuar në sallën e kinemasë, ku shfaqeshin filma dashurie, e bënte më të lehtë, thua se i hapte udhën përfytyrimit. Ai rendte përpara me ngut dhe ajo e kishte pérherë e më vështirë ta frenonte. Në mënyrë kaotike, pa pritur ndërhyrjen e logjikës më të thjeshtë, ajo e pa veten të pleksur në fillim me leshatakun kuqs Maks Roth, por kjo, jo aq se donte vërtet ashtu, por nga rrethanat, ose më mirë nga dëshira për ta bërë sa më të plotë e të rafinuar gjithçka (rivalitet, mprehje e ndjenjave prej xhelozisë etj.) për të shijuar plotësisht lidhjen me të dytin, Vilin. O zot, ia bëri papritur me vete ajo, duke mos i hequr sytë nga bardhësia valavitëse e trupit të saj flu, sikur mendimi t'i vinte që andej. Prej një dashnori me emër të tillë mund të ngelte dhe shtatzanë.

Mundimshëm ajo lëvizi në ujë si njeriu që vërtitet në shtrat. Llapashitja e ujit, bashkë

me prishjen e skicës trupore, krijoi një pauzë midis përfytyrimit. E bardhë në fytyrë, disi e prerë, ajo e pa veten të ngjiste shkallët e shtëpisë dykatëshe, të veshur më drethkëz, te porta e së cilës, mbi një pllakë bronzi, qe shkruar emri i doktorit të vetëm në N. dhe poshtë emrit fjalët: «Chirurg-gynecolog».

Qyshse pas një mëdyshjeje të gjatë i shoqikishte pranuar më në fund që mjeku i N. tibënte analizën, prej së cilës qe vërtetuar se shkaku për moslindjen e fëmijës qe ai, Dezi nuk përfytyronte dot asnjë lidhje dashurie të saj që të mos e kishte epilogun te klinika e mjekut i cili duhej të zhdukte gjurmët.

Kështu, pra, ajo do të gjendej para atij që plotësonte tablonë e mërzitshme të N., mjekut të zhgënjiyer nga jeta, apo ndoshta hiqësikur ishte ashtu, ngaqë ashtu pikërisht dilniqë mjekët e provincës nëpër filma dhe në novelat e një shkrimitari rus me emrin Çehov. Aksident?, do të pyeste ai, duke vështruar me lakinato pjesë të trupit të saj, të ftetur tashmë rrasat e mermerit në amfiteatrin, ku pak komë parë ishte luajtur drama e dashurisë. Dëajo do të thoshte me vete: ku mund të kuptati, mjek i mërzitshëm provincial, këtë malkulli të trishtuar.

Ajo lëvizi prapë, dhe, kur ujët, pasi u zbulos disa çaste, u qetësua dhe nën të zbardi prapë konturet e trupit të saj si të çliruara n

një ankth. Përse duhet ta çoj mendjen te gjëra të tilla?, mendoi. Përpara kishte një gëzim të vërtetë përzier me kënaqësi, kureshtje dhe mister, q'ishte nevoja ta sëmurte atë me gjithfarë zhbirimesh? Letrat e brixhit, vera dhe flakët e oxhakut, të gjitha të kuqe dhe të nxehta, e tërhoqën më në fund nga ai akuarel pikëllimi. Ato ishin të gjitha përpura saj, gati të prekshme në ditët që vinin. Me një gjallëri të papritur ajo u ngrit nga vaska, dhe, pasi u mbështoll me peshqirin e madh, vrapi në dhomën e gjumit për t'u veshur.

Jashtë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, ishte po ajo ditë dimri, me shiun e gjithëgjendshëm gri, ngadalësia e rënies së të cilit dukej sikur ishte model për ritmin e gjithë jetës. Pas pak, me anë të telefonimeve të saj, përmes atij shiu plak, ajo do t'u jepte damarëve të N., në fillim gruas së drejtorit të Postës, dhe pastaj të tjerave, lajmin e jashtëzakonshëm.

Pas gjysmë ore, pasi i kishte mbaruar krejt telefonimet, ajo u afrua prapë te dritarja, prej së cilës dukej një pjesë e qytetit të vogël në pamjen e të cilit asgjë s'kishte ndryshuar. Megjithatë, pavarësisht nga apatia e pullazeve dhe tymtarëve, ajo e dinte se lajmi gërryes ishte ndërkaq atje.

## II

Spiuni Dullë Baxhaja, më i miri në N.. që  
ishte caktuar për të gjurmuar mbërritjen dhe  
më vonë lëvizjet e dy të huajve, në raportin e  
tij me shkrim dërguar nënprefektit, në mbrë-  
mjen e ditës së shtunë, ditë në të cilën ata ki-  
shin mbërritur, shkruante se pasi ishte ngulur  
katër orë përpara ardhjes së autobusit ndër-  
qytetës, në agjencinë e udhëtarëve, për të vë-  
rejtur nëse kishte ndonjë lëvizje të dyshimtë  
nga dikush që mund të priste mbërritjen e të  
huajve, kishte ardhur në përfundimin se asgjë  
të tillë s'kishte pasur. Në të vërtetë, për të pri-  
tur autobusin që vinte një herë në javë nga  
kryeqyteti dhe pikërisht ditën e shtunë, kishin  
dalë, përveç hamejve të zakonshëm, nëntë veta,  
por të gjithë ata, sipas vrojtimeve tepër të kuj-

deSSHme tē raportuesit, kishin takuar vërtet, madje me përmallimin e nevojshëm nē këso rastesh, tē afërmit e tyre udhëtarë që vinin nga kryeqyteti, kështu që e kishin përligjur plotësisht pritjen.

Bënte përjashtim këtu jevgu Haxhi Gaba, pér tē cilin zoti nënprefekt ndoshta do tē kishte dëgjuar, por raportuesi nuk e kishte llojgaritur atë ngaqë dihej tashmë se çdo tē shtunë ai e priste rregullisht autobusin nga kryeqyteti me shpresë se do tē gjendej dikush nga udhëtarët pér tē paguar një sasi qindarkash kundrejt — tē më falni, zoti nënprefekt — bërjes rresht tē një sasie pordhësh prej tij. Siç mund tē jetë nē dijeni zoti nënprefekt, disa herë është bërë problem çështja e tē lartpërmendurit si diçka që ka lidhje me nderin e qytetit etj. etj., por që, me sa është informuar raportuesi i këtyre radhëve, ende s'është arritur nē ndonjë përfundim. Kështu pra, me përjashtim tē tē sipërpërmendurit jevg, asgjë e dyshimtë nuk qe vërejtur prej raportuesit.

Ndonëse i specializuar pér përgjim me vesh, vazhdonte më poshtë spiuni, ai qe përpjekur ta kryente sa më saktë këtë detyrë, domethënë përgjimin nē largësi tē mbërritjes së tē huajve, gjë që, sipas mendimit tē tij (le ta falte zoti nënprefekt pér këtë guxim tē tepruar), i përkiste më shumë përgjimit me sy.

Pra, pa i lejuar vetes t'i japë këshilla ndo-

kujt, e aq më pak zotit nënprefekt, ai do të kishte menduar se për këtë fazë të parë të përgjimit do të ishte ndoshta më i përshtatshëm kolegu i tij, Pjetër Prenushi, i specializuar për syrin, aftësitë e të cilat në këtë fushë kanë qenë të padiskutueshme dhe kanë ardhur përherë duke u përkryer, qysh nga dita e paharrueshme, kur, siç mund t'i kujtohet ndoshta zotit nënprefekt, ai arriti të dallonte në largësinë dy-qind metra se njëri sy i gruas së konsullit franez, ardhur përvizitë në qytetin tonë lashtë, me gjithë lyerjen e tepruar maskuese, ishte i vëngër.


Megjithatë, i mësuar të mos vejë në dyshim urdhrat e eprorëve, pa kurrfarë pakënaqësie përrëndesë në punë që s'i përkasin, përkundrazi i mikluar nga kënaqësia që i jep besimi, duke u përpjekur si përherë ta kryente sa më me ndërgjegje detyrën dhe ato që renditi më lart janë katërcipërisht të sakta.

Për sa u përket dy të huajve, vazhdonte raportuesi, nuk mund të thuhej se sjelljet e tyre s'ishin të dyshimta. Në të vërtetë ndihej menjëherë që nuk e ndienin veten mirë dhe kjo vërtetohej nga kthimet e kokës djathtas e majtas, nga një pamje e hutuar dhe nga lëvizjet krejt të pasigurta që bënин dhe që tregonin fare qartë trazimin, përvizitë mos thënë, frikën, që i kishte kapluar së brendshmi.

Me një shqipe të cunguar, më tepër nga tronditja sesa nga mosditja e gjuhës, sipas mendimit të raportuesit, ata iu drejtuani në fillim Haxhi Gabës, duke e pandehur, me sa duket, hamall, kurse ky i fundit, duke kujtuar se po i kërkonin të ushtron teprimin e tij të turpshëm, u bë gati të kryente atë teprim, d.m.th. mori njëfarë qëndrimi të tendosur të trupit që do t'i lejonte nxjerrjen me forcë dhe me zhurmë të sasisë së nevojshme të ajrit për të sajuar — përsëri të më falë zoti nënprefekt — sasinë e pordhëve, të porositura, pas mendjes së tij, prej dy të huajve. Pra, i lartpërmenduri u bë gati të përsëritë teprimin e tij njollosës, këtë herë në një shkallë që, pa e tepruar aspak, mund të quhej ndërkontaktare, sikur raportuesi, pavarësisht se kjo nuk hynte në detyrat e tij, i shtyrë thjesht nga patriotizmi, të mos ndërhynte për ta larguar Haxhi Gabën që andej.

Për sa u përket valixheve dhe sidomos arkave metalike që të huajt kishin me vete, raportuesi e kishte të vështirë të jepte një gjykim për to, me një të parë nga larg, aq më tepër që, sic dihej dhe siç e kishte përmendur pak më parë, stera e tij është kryesisht përgjimi me vesh etj. etj...

Në këtë rast, ndonëse nuk e kishte zakon të ndërhynte në punët e të tjeraëve, por i shty-



rë thjesht nga dëshira që punët e shtetit të shkonin sa më mbarë, ai, duke mos vënë për asnjë çast në dyshim aftësitë sypërgjuese të kolegut të tij, Pjetër Prenushit, do të mendonte megjithatë se në këtë rast as ato nuk do të ishin të mjaftueshme për të dhënë saktë peshën e valixheve e sidomos të arkave metalike, e aq më pak të bënин njëfarë lidhjeje midis peshës dhe asaj që ndrynin brenda. Në këtë rast ai merrte guximin të mendonte se do të ishte mirë që për këtë gjë t'i kërkohej një gjykim njeriut që i ngriti në shpinë ato, domethënë hamallit Cute Arapi.

Hamalli Cute Arapi: Valixhet? Lëre, pas zotin, desh më thyen kërbishtat. Kam dyzet vjet që kam dalë hamall, po valixhe të tillë s'kam ngritur kurrë. Plumb e shkuar plumbit. Ç'mund të kishin brenda? Vallahi s'di ç'të thotë Cutja: gurë, hekur, djallin vetë mund të kishin, po tesha jo. Vë dorën në zjarr Cutja që s'ishin tesha ato. Veç po të ishin tesha hekur nga ato që mbanin të vjetrit që i kemi parë në kinema, po ata njerëz të sotëm ishin, s'duke shin as të atillë, as të lajthitur nga trutë e kokës. Po tesha nuk ishin, jo, jo. I njeh Cutja te shat me një të prekur të valixhes. Posa e ngrë valixhen për ta hedhur në shpinë, e kupton

menjëherë Cutja: valixhe pasaniku kjo, me rroba me stof të rëndë a të qëndisura me argjend, apo valixhe peshkopi e myftiu me librat e shenjtë brenda, ungjill a kuran. Di Cutja çdo gjë që ka të bëjë me valixhet. Me një të prekur, i njeh teshat e nuseve, të lehta nga gazi, apo teshat e grave të veja, të rënda nga mërzia. Ka ngritur Cutja gjithfarë valixhesh në jetën e tij: valixhe të lumturish e mendjelehtësh, të internuarish që i largohen zemërimit të mbretit, të dëshpëruarish që kanë ndër mend të varen që pa gdhirë me rripin e saj, valixhe hajdutësh, artistësh, grash që bëjnë dashuri (eh, si fërgëllon shpina e Cutes nën to), valixhe zyrtarësh, heremitësh apo të qmendurish, mbushur përgjysmë me gurë, të gjitha i ka provuar Cutja, po valixhe si të këtyre dy të mallkuarve, jo, jo, jo, për shpirt të nënës, s'ka ngritur kurërë Cutja. Fryma m'u mek, thashë se u këputa; eh, Cute, thashë me vete, kaq e pat dhe hamallia jote. Bjer e vdis më mirë sesa të durosh këtë turp e të thuash «s'i ngre dot». Se ka parë njëherë një ëndërr Cutja më të hidhur se vdekja, një udhë shtruar si me letër katrama, gjysmëjeshile, gjysmëkafe, dhe një udhëtar me valixhe duke thirrur «ej, hamall» dhe Cutja që bën të ngrejë valixhen e s'e ngre dot. Ja kështu, si atë natë në ëndërr u mbyta në djersë të ftohta nën ato valixhe të nëmura. S'ishin valixha ato, djalli vetë ishin.

Hotelieri i hotelit «Globi»: Valixhet ishin të rënda vërtet, sidomos arkat. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se, për t'i ngjitur gjer në dhomë në katin e dytë, u desh të ndihmonin, përveç djalit që e kam enkas për kësot punësh, të dy pastrueset e dhomave, si edhe kuzhinieri.

Të huajt më folën mua shqip, po duhet thënë këtu, për hir të së vërtetës, se gjuha që përdornin ishte gjithsesi jo e zakonshme, një gjuhë, s'di si ta them, e ngrirë vende-vende, si akull, nuk e di në më kuptioni, ndoshta s'shprehëm dot qartë. Puna ime si hotelier më ka bërë që të kem të bëj shpeshherë me të huajt, kështu që për mua janë familjare shtrembërimet që i bëjnë ata shqiptimit të gjuhës sonë. Jo për t'u mburrur, por, për hir të së vërtetës, duhet thënë se pikërisht prej këtyre shtrembërimeve jam në gjendje të dalloj pa ia hapur fare pasaportën nëse klienti është italian, grek apo sllav. Por në rastin e këtyre të dyve s'ishte fjala për shtrembërimet të këtij lloji. Jo, ishte fjala për tjetër gjë, krejt tjetër. Ndoshta nuk arrij t'jua shpjegoj dot. Një gjuhë, si ta them, e ftohur... Vite më parë, ime më, ndjesë pastë, kur m'u shfaq një herë në ëndërr, më foli me një gjuhë të tillë. Dhe kaq jam tronditur atëherë, saqë më kujtohet në ëndërr i thashë: ç'të kam bërë që më flet kështu, moj ime më? Më falni, ju lutem.

Pastaj? Ah, po, desh e humba fillin e bisedës. Pastaj ata shkuan në dhomën që e kishim caktuar së bashku më parë. Megjithëse tri herë sipas porosisë suaj e kishim spërkatur dhomën me insekticide, për hir të së vërtetës, duhet thënë se s'mund të isha i sigurt për praninë ose jo të çimkave. Ato mund të futeshin nga dhomat e tjera, nëpërmjet të çarave të dyerve, dhe sidomos të binin nga tavani. Nejse, kjo është një çështje tjetër. E kisha fjalën që ata u mbyllën në dhomë gjersa erdhë i dërguari i zotit nënprefekt për t'u sjellë ftesën për brixh.

Mirëseardhjen e nënprefektit bashkë me ftesën për të luajtur një brixh me dy të porsaardhurit e solli nëpunësi i kadastrës, aty rrëth orës shtatë të mbrëmjes. Sipas fjalëve të nëpunësit, të përforcuara këto edhe nga hotelleri, që ishte i pranishëm në atë takim (madje ishte ai që kishte trokitur, së pari, në dhomën e të huajve për t'u njoftuar se një zotëri nga nënprefektura po i kërkonte), të porsaardhurit qenë habitur disi nga ftesa, të cilën jo vetëm nuk e prisnin, por kaq e pazakonshme, për të mos thënë e çuditshme, u qe dukur, saqë ishte dashur njëfarë kohe sa t'u bëhej e kuptueshme. As nëpunësi i kadastrës dhe aq më pak ho-

telieri, nëpërmjet tij, duke ia kaluar përgjigjen e të huajve nënprefektit, nuk i treguan atij se në ç'mënyrë e kishin pritur ata ftesën e tij fisnike. Megjithatë, kjo s'i pengoi aspak që të dy bashkë t'u thoshin miqve të tyre se të huajt e kishin pritur pa asnje gëzim atë ftesë, por kishin treguar një lloj të tillë përbajtjeje, që më saktë mund të quhej ftohtësi, për të mos thënë një ndjenjë e hapur bezdie, sidomos kur kishin dëgjuar fjalën «brixh». Gjithmonë sipas mendimit të nëpunësit të kadastrës dhe të hotelierit, mendim që shumë shpejt, me anë të dy spiunëve kishte mbërritur në veshët e nënprefektit, dy të porsaardhurit kishin pranuar të shkonin në shtëpinë e nënprefektit, më tepër të detyruar se nga kënaqësia. Për çudi, nënprefekti, jo vetëm s'kishte provuar asnje mllef ndaj dy thashethemsave, por, përkundrazi, në raportin favor për ministrin e Brendshëm e kishte futur këtë fakt, duke mos harruar të shënone se dy dëshmitarët ishin njerëz të ndershëm e të besueshëm.

Sidoqoftë, atë mbrëmje, kur bashkë me miqtë e tij të përnatshëm të brixhit, drejtorin e Postë-Telegrafit, gjykatësin e paqit dhe zotni Rrokun, pronarin e fabrikës së sapunëve «Venus», së vetmes fabrikë në N., pritnin ardhjen e të huajve misteriozë, nënprefekti s'dinte asgjë nga këto. Por, edhe po të dinte; nënprefekti nuk do t'u thoshte asgjë miqve të

tij, dhe aq më pak grave të tyre, sidomos gruas së tij, Dezit, për të cilën kjo ishte ngjarja më e mrekullueshme e stinës.

E veshur me një fustan mëndafshi bojë qielli, që i rrinte flladitshëm në trup, ndoshta për shkak të të kuqit të lehtë me të cilin kishte ngjyruar mollëzat, apo të rimelit gjithashtu bojë qielli rrotull syve, ajo dukej krejt e shpër-qendruar dhe si e dehur vërtitej nga salloni i madh te dhoma ku ishte tryeza e brixhit. Veshët e saj kapnin rastësisht copëra bisedash, që përherë e më tepër i dukeshin banale. Po flisin përvizitorët që duhej të vinin nga çasti në çast dhe përpinqeshin të gjenin se përsë kishin zgjedhur si vendqëndrim pikërisht qytetin N. Dezit kjo i dukej e padurueshme. Kaq e tmerrshme i dukej hamendja që ata mund të mos vinin në N., po të shkonin në ndonjë qytet tjetër, saqë vetë përmendja e kësaj, tani që mrekullia kishte ndodhur, i dukej se do ta rrezikonte atë mrekulli, dhe gati-gati druhej se të ardhurit do të kujtoheshin befas e do të thoshin: More, vërtet, pse iu qepëm këtij N.? A s'ka ndonjë qytet tjetër, ku mund të shkonim?

— Vërtet çudi, — thoshte zoti Rrok, — e habitshme ta mendosh që erdhën këtu. E, pra, humbëtirë është, as kufi me ndonjë shtet të huaj, as vend historik, as pikë strategjike si

i thonë. I padëgjuar kurrë për asgjë. Dhe, vec kësaj, në këmbë të bjeshkëve!

— Thonë se e kanë vendosur që atje, në Amerikë, — thoshte drejtori i postës, — thonë se, apo paskan vënë këmbën në Durrës, paskan nxjerrë hartën nga çanta e paskan thënë: këtu duam të shkojmë e në asnë vend tjetër.

Ndërsa flisnin, ata kthenin kokën nga nën-prefekti, por ai, me një buzëqeshje të vjetruar tashmë në fytyrë (o zot, si është e mundur që gjatë disa orëve rresht, me disa dhjetëra njerëz të përdornim të njëjtën buzëqeshje, i thoshte shpesh e shoqja), pra, me po atë buzë-qeshje të fillimit ai bënte sikur s'i dëgjonte. Në të vërtetë shumë herë kishte vrarë mendjen edhe vetë përsë të huajt kishin zgjedhur pikërisht N. për atë punën e tyre enigmatike. Disa herë i qe dukur se kjo do t'i sillte tela-she, disa herë, përkundrazi, se mund t'i sillte shans. Qëllonte kur ishte në gjendje shpirtë-rore të prishur që t'i dukej se dikush me qëllim të keq enkas ia kishte dërguar atij vizitorët e paftuar. Sido që të ishte, qysh sonte, në natën e parë të mbërritjes së tyre, sado ujq të vjetër që ata të ishin, diçka nga enigma e tyre nënprefekti do të zbulonte. Në letrën personale që i kishte dërguar ministri fill pas shkresës së fillimit, i jepte të kuptonte se për atë zbulimi i sëfshehtës së tyre që tepër i rëndë-

sishëm. Eh, shteti i ka të thella puset, psherëtiu me vete nënprefekti. Ishte duke menduar pikërisht se kushedi vallë ku do t'i dilte tëm kësaj pune, kur ra zilja e derës së jashtme, që i elektrizoi të gjithë. Shumica e të ftuarve kthyen kryet nga ai për të pritur një udhëzim se ç'duhej të bënin, disa i lanë gotat me vermut që mbanin në dorë te mermeri i oxhakut, të tjerët që i kishin lënë, i morën përkundrazi përsëri. Të gjithë bënë nga një lëvizje, vetëm Dezi mbeti si e ngrirë në vend, me vështrimin ngulur te shkallët.

Ndërkaq, shërbyesja e kishte hapur portën dhe në shkallë u ndien, në fillim hapat e tyre, që nënprefektit, ndoshta për shkak të raporteve që porsa kishte lexuar, ku, midis të tjersh, flitej edhe për gjuhën e tyre të ngrirë, apo ndoshta se ashtu i tingëlluan vërtet, ata hapa iu dukën prej këmbësh druri. Vetëtimthi sytë e tij kapën profilin e gruas që tregonte tronditjen e saj, qafën e butë, me krelat e çelëta, të zbuluar edhe më nga krehja lart e flokëve dhe më tepër me habi se me kënaqësi mendoi se përse vallë nuk po bëhej dot xheloz.

Dezi, pa u bërë aspak merak për të fshehur trazimin, ndiqte me sy dy të ftuarit, që po hipnin shkallëve të drunjta, fill pas shërbyeses, që ecte me shpinë nga shkallaret, e kthyer përgjysmë ndaj tyre, për t'u prirë kështu lart. Nuk ishin aspak siç i kishte menduar Dezi. As

njëri, as tjetri s'kishin flokë të zez, aq më pak të lëmuar rrezikshëm. Njëri ishte gjysmëbjond, por aspak kuqs dhe leshatak siç duhej të ishte Maks Rothi, përkundrazi i kishte flokët të butë, pakëz të rrallë, ngjyrëgështenjë të çelët. Kurse tjetri kishte një fytyrë energjike dhe flokët i kishte vërtet më të errët, por pa shkëlqim dhe, veç kësaj, të prerë shkurt, si boksierët. Vili s'duhej të ishte ky, por as Maksi, urithi besnik e babaxhan. Dezi gati sa nuk psherëtiu me zë. S'ishin fare ashtu siç i kishin menduar, megjithatë, o zot, shyqyr që ishin të rinj. Në të vërtetë si nuk e kishte menduar më parë? Shkencëtarët ishin në përgjithësi pleq dhe ata fare mirë mund të ishin ashtu, megjithëse i shoqi thoshte se ata s'ishin aspak shkencëtarë, por tjetër gjë. Megjithatë, ishte e njëjta gjë, përderisa maskoheshin me pamjen e shkencëtarit. Mund të ishte vërtet një katastrofë e pandreqshme mosha e tyre.

Asaj i kishte ardhur radha për të zgjatur dorën dhe, për habinë e saj, biondi syçelët që po ia shtrëngonte atë, i tha shqip:

— Shumë gëzohem, zonjë, që ju njoh, Vili Norton.

— Dezi, — tha ajo. Ato që kishte menduar disa ditë më parë për ta te vaska e banjës, hamendjet për mjekun gjinekolog e dhjetëra hollësi të marrëzishme, e bënë të skuqej:

Pra, ky qenkësh Vili, tha me vete pas pak;

ndërsa ata po mbaronin njohjen me të tjerët. I kishte menduar krejt ndryshe, megjithatë s'mund të thoshte se ishte zhgënjer. Do të ishte e padrejtë, aq më tepër po të kishte parasysh shkencëtarët pleq me pantoflat dhe skufjet qesharake në kokë para gjumit. Kishte vetëm një ndjesi prishjeje drejtpeshimi në të gjitha... Duhej të ishte e ëmbël ndaj tjetrit, Maks Rothit, megjithatë, ndonëse ai ishte flokerrët dhe kuksi ishte tjetri, e ndiente se po anonte ndaj këtij të fundit. Pa dyshim s'ishte emri Vili që vendoste, po tjetër gjë. Dezi mezi e përballonte ndjenjën e zbrazëtisë. Megjithatë të pashëm ishin të dy, ngushëlløhej ajo, dhe, kryesorja, të rinj, madje më tepër se ç'i kishte përfytyruar. Kurse për sa i takonte gjuhës, pavarësisht se shqipen e flisnin ashtu, ata e kishin anglishten e tyre. My darling, my lord...

Dezi e ndjeu befas qartë se në qoftë se do të kishte një natë pa gjumë, pagjumësinë nuk do ta shkaktonte as trazimi shpirtëror për njërin prej tyre, siç e kishte pritur, as ndjenja e hidhur e zhgënjinimit, por tjetër gjë, dhe pikërisht përshtatja e saj ndaj pamjes reale të vizitorëve. Gjithë natën ndoshta në netët e mëvonshme, brenda saj do të bëheshin ndryshimet e nevojshme për ta bërë prapë qenien e saj po aq të ndjeshme ndaj tyre si dhe më parë. Ndërkaq, të huajt kishin mbaruar njohjen

me të gjithë dhe po kalonin ato sekonda të vështira të njerëzve që porsa arrijnë në një shoqëri të mbledhur qysh më parë. Ata u bu-zëqeshën për të dytën herë e disa herë për të tretën atyre që kishin përreth, gjersa i zoti i shtëpisë e kapërceu i pari hutimin e dyanshëm duke bërë pyetjen:

— Ç’do të pini, zotërinj?

Biseda për pijet dhe zgjedhja e tyre prej të huajve i çlirroi disi të gjithë. Prisnin që të huajt të ishin pak më tepër njohës të pijeve, por, për çudi, s’qe ashtu. Ndoshta kjo u bë shkak që të vërenin se edhe veshja e tyre s’iste ajo që pritej. Njëfarë pakujdesie, për të mos thënë një fjalë më të rëndë, spikatej në të. E gjithë kjo bëri që të zotit të shtëpisë t’i zgjidej goja:

— Mora vesh ardhjen tuaj në qytetin tonë dhe thashë me vete, larg prej të vetëve janë, në vend të huaj, në provincë të humbur dhe krejt në vetmi, apo jo? — kështu mendova t’ju ftoj për një brixh, ndoshta më pak do ta ndieni vetminë.

Nënprefekti fliste ngadalë, duke i ndarë mirë fjalët që ata ta kuptionin. Ndërsa fliste, ata tundnin kryet.

— Zot, faleminderit, — tha njëri prej tyre, flokëshkurtri, — fort gjithkund e çmojnë mik-pritjen e shqiptarëve.

— Do tē jeni pēr mjaft kohë këtu? — pyeti zoti Rrok.

Të huajt bënë një lëvizje me krahë.

— Besa po. Ne mjaft këtu do tē rrimë.

— Është kënaqësi pēr ne, — tha nënprefekti.

— Faleminderit, zot.

Në tē folurën e tyre Dezit iu duk se kapi një ritmikë tē njojur. Në shkollën qytetse tē vajzave, mësimi i metrikës së vjetër shqipe... por e kishte vështirë tē përqendrohej.

— Me sa dëgjova, ju do tē merreni me çështjen e folklorit, — tha nënprefekti.

Njëri prej tyre ngriti vetullat, pēr tē ngadalësuar përgjigjen në çastin që nënprefekti këmbeu një vështrim tē shpejtë me gjykatësin e paqit, tē vetmit që i kishte treguar dyshimet e veta pēr tē huajt.

— Si me thënë. Pikërisht... Ndoshta më tepër, — u përgjigj ai që quhej Vili Norton.

— Me eposin e vjetër fort do tē merremi, — u përgjigj i huaji, — e ndoshta...

«Shumë po shndrit nj'ai diell e pak po nxeh», përsëriti me vete Dezi vargun me tē cilin fillonte një nga epet e vjetra që ndodhej në tē gjitha antologjitë e leximit letrar. Ishte pikërisht ritmika e tij që ndihej në tē folurën e tē ftuarve.

— E ndoshta me diçka që me tē lidhet

krejt, — vazhdoi biondi. — E kam për Homerin.

— Për shëndetin tuaj, — tha gruaja e drejtorit të postës, duke ngritur pakëz gotën e vermutit. Nën shtresën e lehtë të pudrës ndihej padurimi i saj që të merrte fund ky këmbim frazash i mërzitshëm, për të dëgjuar diçka më të këndshme prej të huajve. Dezi i kishte folur për ca lloj gramafonash modernë që ata pas-këshin sjellë me vete. Ç'vallëzohej vallë tani andej nga Nju-Jorku, nga Kalifornia?

— Përmendët Homerin? — tha nënprefekti. — Me ç'di unë, është ai poeti i vjetër grek dhe pa sy?

— O, jes, — i shpëtoi tjetrit për gjëzimin e beftë të Dezit që ktheu sytë me triumf nga gratë e tjera si për t'u thënë: a s'janë tamam të huaj, me anglishten e tyre?

— O, po, Homeri. Treqind vjet një diskutim për të vazhdon nëse qe një apo qenë shumë Homerë.

Zoti Rrok lëvizi me dorë kravatën flutur dhe, si e mbuloi me buzëqeshje çdo centimetër të fytyrës së tij, ndërhyri kujdeshëm:

— Na falni, zotërinj, të paditur jemi, provincialë të humbur, ja unë merrem me probleme sapunësh, sic ju thashë pakëz më parë, sapun «Venus», sapun për zonja, eh, he-he, këto i di mirë, po ç'janë punët e thella të filozofisë, domethënë Homeri, Xhuzepe Verdi, e ku

di unë, s'para i marr vesh. Pra, më falni injorancën time, por desha të di, ç'lidhje mund të ketë midis atij Homerit dhe vizitës suaj të nderuar këtu? Me sa kam dëgjuar, ai ka jetuar para katër a pesë mijë vjetëve dhe tepër larg që këndeja, apo jo?

— Uf, — ia bëri gruaja e drejtorit të postës. I kishte thënë përherë Dezin se truri i zotit Rrok ishte më i lëmuar se sapunët që prodhonte.

Të huajt këmbyen një nënqeshje, që nën-prefektit iu duk gjithë nënkuptim.

— Tri mijë vjet më parë, zot, sigurisht, — tha njëri prej tyre. — Dhe tepër larg, o, tepër larg që këndeja. Por një lidhje ka megjithatë.

Midis vështrimeve të tyre u shkarkua prapë vetëtimthi e njëjta nënqeshje plot nënkuptim dhe nënprefekti ia bëri me vete: hm, po tallen haptazi me ne. Pa dyshim që po talleshin, mendoi pas një grime. Si mund të besohej se kërkonin vërtet ta zbulonin atë punën e Homerit në qytetin e vogël, që s'kishte pasur kurrë lidhje me të? Së paku, të kishte gjetur një shkak më të besueshëm për ardhjen këtu. Mirëpo as për këtë s'e paskan vrarë mendjen, provincialë këta, kanë thënë me vete, humbamo. Hm, të shohim kush do të qeshë në fund. Mund të keni parë shumë gjëra ju, vazhdonte të shkrofëtinte me vete i zoti i shtëpisë, nën buzëqeshjen e tij të pandryshueshme, keni parë rrrokaqiej e marifete të tjera, po Dullë

Baxhanë që kur të qepet s'di tē tē ndahet më, në majë tē rrokaqjellit qofsh apo në fund tē rrokadjallit, këtë s'e keni parë.

Mendimi për Dullë Baxhanë e qetësoi ca çaste. Pastaj mendja i shkoi prapë te letra e ministrit tē Brendshëm ose më mirë te çasti i kapjes «me presh në duar», kështu pikërisht i shkruante ai, pas tē cilit «detyra jote me kaq mbaron, do tē kem unë punë me ta». Ç'ishte e vërteta, nënprefekti s'e kishte aspak tē qartë se ç'mund tē ishte kjo kapje me presh. Në letrën e ministrit flitej tepër ngutazi, me njëfarë padurimi, për tē kaluar te mendimi i çuditshëm se «edhe pas kësaj me ata duhej sjellë mirë, njëlloj si më parë, por ama duhej t'u bëhej e qartë se ishin kapur, kështu që tē mos bënин më vickla».

Tani që po e kujtonte edhe më e çuditshme se ç'i qe dukur kur e kishte lexuar, po i ngjante letra e ministrit. E gjithë kjo do t'i dukej paksa si lodër sikur ministri tē mos kishte rithksuar në fund tē letrës se çështja ishte më e rëndësishme se ç'mund ta mendonte ai.

Me njëfarë kujdesi për tē mos u vënë re, nënprefekti pa orën. Tani Pjetër Prenushi do tē kishte arritur, me siguri, tē hapte valixhet, tē gjente e tē fotografonte gjithë shënimet e dokumentet e shkruara, që, sipas sinjalizimit tē doganës, ata i kishin me shumicë. Pas kësaj, qysh atë natë, sipas urdhërave që kishte dhënë,

do të përkthehesin me ngut ato që do të gjy-koheshin të nevojshme prej përkthyesit, për të qenë pa gdhirë mirë në tryezën e tij.

I kënaqur me veten, nënprefekti nuk e kishte vështirë t'i buzëqeshte gjithkujt, madje dhe atyre që mendonte se nuk e meritonin vë-mendjen e tij. Tani Pjetër Prenushi vrapon-te me siguri drejt ndërtesës së vogël qesharake, në hyrjen e së cilës ishte shkruar me germa blu «Foto Lux», kurse brenda, i përthyer nga dhimbjet e hemoroideve (sa herë që punonte për nënprefektin e kapte kriza), i zoti i ateliesë pris-te gjithë tmerr. Do të qetësohej kur të shihte shkrime anglisht, përndryshe llahtarisej nga fotografitë e kufomave, të byzylykëve të vje-dhur e sidomos të grave lakuriq.

Nënprefekti ndihej vërtet i gjëzuar. Ideja se dy spiunët e tij më të mirë ndodhesin në punë e sipër jashtë, në natën e ftohtë e të lagësht, i jepte kënaqësi të veçantë. E dinte se të tjerët ia kishin zili atë çift të përsosur që ishin «syri dhe veshi i tij», por pavarësisht nga kjo zemra e tij anonte dukshëm nga Dullë Baxhaja. Ndaj dhe në rivalitetin midis tyre, shpërblimet e qejfmbetjet, ndonëse përpiquej të dukej i paanshëm, mbante anën e këtij të fundit.

Ky është një vend i pazhvilluar, i pëlgente të filozofonte herë pas here, dhe si në çdo vend të tillë kur është fjala për çështje zbulimi, syri

nuk lot asnjë rol kushedi çfarë. Shumica e një-rëzve janë analfabetë, por edhe ata që dinë shkrim e këndim s'karë qejf të shkruajnë. Këtu rrallëkush harton kujtime, ose mban ditar, ose letër-këmbim të rregullt. Madje edhe testament, që asgjékund s'mund të përfytyrohen pa shkrimin, nënshkrimin e vulën, këtu shpesh janë gojore. Dhe e dini çka e zëvendëson nënshkrimin e vulën? Mallkimet. Mos paç ditë të bardhë në këtë e atë jetë, po nuk e çove në vend dëshirën time. U bëfsh kruspull ja si ky trung. Ose, mos të trettë dheu etj. etj.

Kështu i pëlqente të fliste. Kurse, kur vinte puna pér veshin, toni i tij ndryshonte sakaq. O, veshi është tjetër gjë, zoterinj. Ai s'mbetet kurrë pa punë, sepse gjithmonë njerëzit kanë qejf të flasin e të pëshpëritin dhe dihet që ajo që flitet, e sidomos ajo që pëshpëritet është gjithmonë më e rrezikshme pér shtetin sesa ajo që shihet. Së paku në këtë vend, ngulmonte ai. Dhe, në qoftë se rrethi i miqve ishte tepër i ngushtë ose tepër i besuar, i pëlqente të rrëfente të vetmin dështim të bujshëm të tij në fushë të zbulimit, dështim i shkaktuar pikërisht «prej syrit», kur në letrat plot fjalë të ndyra të një donzhuani provincial dërguar kurtizanes kryeqytetase Lulu, letra që, siç dihej, kontrolloheshin pér shkak të flirtit të kësaj të fundit me mbretin, duke kujtar se kishte gjetur fjalët «organizatë sekrete» (pér perëndi,

ashtu m'u dukën, të fshehura si lepuri në ferrë midis barkut, pubisit e sqetullave të saj), kurse në të vërtetë ato s'qenë veç fjalët «orgazmë» dhe «sekrecion», zot i madh, dhe tan skuqej flakë kur e kujtonte atë histori.

Rreth vizitorëve vazhdonte biseda e nisur nga zoti Rrok dhe nënprefektit iu desh një grimë sa të ndiqte fillin e saj.

— Ka një lidhje, zot, — thoshte biondi, — veç vonë është sonte për shpjegimdhënien.

— Një tjetër gjë, pa dyshim, — ndërhyri tjetri. — Lodhur jemi, rruga e gjatë qe fort.

Sigurisht, tha me vete nënprefekti, sa t'i rregulloni pipëzat me njëri-tjetrin. As këtë s'e paskeni bërë, eh, provincë e mallkuar, as spiu-nët s'ia varin.

Dikush kishte përmendur brixhin, por të huajt tundën kokat në shenjë mohimi. Dhe prapë po ato fjalë për lodhjen dhe rrugën e gjatë. Veç kësaj, dhe kjo ishte më e papritura, ata s'ditkëshin të loznin. Kjo ishte me të vërtetë kulmi.

Pas heqjes dorë prej brixhit, nismën e bisedës me të huajt e morën më në fund gratë. Më tepër fliste gruaja e drejtorit të postës, e ndjekur nga shikimi gjysmëmospërfillës, gjysmëironik i së shoqes së fabrikantit.

— Sa s'më pëlqen kur gratë e rretheve tona mezi presin të vijë ndonjë i huaj që të nazetohen për t'ia tërhequr vëmendjen, — i tha

me zë të ulët Dezit. Dezi u kthye befas nga oxhaku që tjetra të mos shikonte skuqjen në fytyrën e saj. Ca sekonda u mor me zjarrin dhe, kur ngriti kryet, ishte vërtet e përflakur në fytyrë, por tani ishte e përligjur. — Është vërtet e neveritshme një grykësi e tillë për aventura.

Dezi buzëqeshi hutueshëm. E dinte se tjetra ishte nervoze që s'po e përdorte dot italishten e saj, gjë që pa dyshim i shkaktonte një lumburi të qetë gruas apatike të gjykatësit të paqit.

— Do të qëndroni në hotel «Globi»? — pyeti ajo mysafirët.

— O, jo, — u përgjigjën gati në një gojë ata.

Gjykatësi i paqit buzëqeshi me ngathtësi.

— E ku mendoni se do të vendoseni tjetër? Në qytetin tonë s'ka veç një hotel për të qenë dhe ky është «Globi».

— Në qytet ne jo, — tha Vili Norton. — Larg do të shkojmë.

— Si? — ia bëri Dezi, duke ndier një si krismë në gjoks. Ajo e kishte shhangur gjer atëherë ndeshjen e syve me vizitorët si njeriu që e lë gjithmonë për më pas diçka tepër të dëshirueshme, por në atë çast e vështroi dehshëm njeriun që i shtiu akull në shpirt me atë frazë të ngrirë. Kishte në vështrimin e saj edhe zjarrmi, edhe qortim, bashkë me premtimin e gruas, thua se ato bënин që tjetri ta

tërhiqtë mbrapsht atë që porsa kishte thënë. Mirëpo i huaji e përsëriti përgjigen pa pikë mëshire.

I zoti i shtëpisë, që ishte larguar ca çaste nga grupei i tyre, u afroa prapë për ta dëgjuar atë që po flitej për vendosjen e të ardhurve. Dhe ishte vërtet e habitshme ajo që po flitej. Fare qartë ata po shpjegonin se s'kishin aspak ndër mend të qëndronin në qytetin e tyre, me gjithë admirimin që ndienin për shoqërinë e tyre aq simpatike. Jo, s'ishte fjala për një qytet tjetër, e aq më pak për një krahinë tjetër, ata do të qëndronin pikërisht në këtë zonë, vetëm se jo në qytetin N. dhe në përgjithësi ata s'do të donin të kishin punë me qytetet, por do të vendoseshin në ndonjë bujtinë të vetmuar larg qendrave të banuara, një bujtinë e tillë ose më saktë një han nga ata që ndodhen zakonisht në udhëkryqe rrugësh të mëdha. Madje ata do të donin të ngjiteshin fare në bjeshkë, sikur stina e ftohtë të mos kishte filluar, dhe atje të kryenin punën e tyre, por, meqenëse bjeshkët tanë ishin me borë, do të pranonin të vendoseshin në këmbët e tyre, në ndonjë han ndanë udhës së madhe, siç e thanë pak më parë, atje ku zakonisht bujtin rapsodët, gjatë endjeve të tyre. Në të vërtetë, ata e kishin caktuar edhe bujtinën, që dukej se ndodhej jo larg që këndej.

— Te Hani i Kryqit, — ndërhyri fabri-

kanti i sapunëve. — Ajo bujtinë ndodhet ndanë xhadesë midis Shkodrës dhe kryeqytetit.

— Jo, — u përgjigj ai që quhej Maks Roth, — i thonë Hani i Rrafshit të Buallit, ose më shkurt Hani i Rashtbuallit.

— Ah, — ia bëri drejtori i postës, — por ai është tepër i vjetër dhe, veç kësaj, është kaq i mënjanuar, sa edhe telegramet shkojnë me katër ditë vonesë.

Të huajt qeshën.

— Ne hartë e kemi parë, — tha Vili Nortoni. — Është pikërisht pra vendi që na duhet.

Natyrisht, mendoi nënprefekti, vend më i mirë për ato punët tuaja të fshehta as që mund të mendohet.

— Keni me vete edhe harta? — pyeti ai.

— Po, zot, shumë harta. Krejt zonat epike në to i kemi.

Bukur fort, tha me vete nënprefekti. S'marrin as mundimin ta fshehin. Deshi të pyeste ç'ishin këto zona epike, por mendoi se ishte më mirë të bënte sikur nuk e kishte vënë re.

— Ku bie ky Hani i Rashtbuallit? — pyeti Dezi me zë të ulët gruan e drejtorit të postës.

— Si të ta them? — iu përgjigj ajo. — S'e mbaj mend mirë, një herë kam qenë me Petron, por është një han aq i vjetër, sa të merr frika. Një shkatërrimë e vërtetë.

— Me sa kam dëgjuar, — ndërhyri nën-

prefekti, — pas Hanit të Dy Robertëve në Shqipërinë Qendrore, ky është më i vjetri han i mbetur nga mesjeta.

— Është shumë larg?

— Eh, jo dhe aq. Besoj një orë me karrocë. Dezit i erdhi zemra në vend. Një orë larg me karrocë, s'ishte ndonjë hata.

Rreth të huajve biseda qe ngjallur përsëri.

— Të çuditshëm jeni, për besë, — u thoshte zoti Rrok, duke u buzëqeshur të dyve mu në hundë. — Ja unë merrem me sapunët dhe kujtoj se diçka kuptoj nga bota, sepse me sapunët, hm, me ta ka lidhje çdo njeri, apo jo, dhe përditë nga mëngjesi në mbrëmje. E pra, kur e mendoj, më duket diçka e madhe fort dhe e përgjithshme, dhe gati-gati besoj që gjithë bota merret veç me ta. Sepse s'është shaka, apo jo, është diçka që ka lidhje me trupin tënd, sapun për larjen e kokës, të fytyrës, lan mirë, s'lan mirë, veç kësaj çështja e aromës që duhet të ketë, për të mos përmendur cilësitë e tjera. si për shembull forca gjerryese, që s'duhet të jetë e tepruar, sepse, siç mund ta kuptioni, për lëkurët delikate të damave, sidomos po të kemi parasysh pjesët intime të trupit, hi-hi-hi. Kështu pra, kur e mendoj, më duket se gjithë bota aty e ka mendjen, por ja, takon befas njeriu zotërinj si ju, që s'pyesin hiç për ta dhe e kanë mendjen të vijnë gjer këtu në fund të

botës, për t'u vendosur në një han shkatarraq, që të mendohen pastaj si është puna e një të verbri që ka jetuar një milion vjet më parë. Botë e çuditshme, për besë.

C'idiot, tha me vete nënprefekti. Kishte pasur të drejtë inspektori i financës kur para dy vjetësh, gjatë një grindjeje bixhozi, i kishte thënë: s'do të bëje keq të hidheshe edhe vetë ndonjë ditë në kazanin e fabrikës për t'u bërë sapun.

Dezi solli kafetë e ndihmuar nga shërbysja. Ndërsa rrufiste filxhanin, nënprefekti mendonte se ndërkaq hotelieri do të kishte pasur kohë të bollshme për t'ua kontrolluar mbarë e mbrapsht valixhet klientëve.

Në fytyrat e të huajve dukeshin tanë qartë shenjat e lodhjes. Edhe rrënim i pudrës në fytyrën e gruas së drejtorit të postës, shenjë e sigurt, e njojur prej rrëthit të vogël mondan të N., tregonte se mesnata nuk ishte larg. Megjithëse njerëzit përpinqeshin t'i mbytnin gogësimat, prania e tyre ndihej përreth.

U desh vetëm një heshtje e vogël që të huajt të merrnin leje për t'u larguar. Në këmbë, te shkallët dhe pastaj në korridor u fol një copë herë nëse ata e mbanin mend udhën gjer në hotel, apo donin një shoqëruesh, pastaj zoti Rrok shfaqi dëshirën t'i shoqëronte gjer atje, gjë që krahas miratimit, skicoi një keqardhje, të cilën në atë orë të vonë për ta,

askush prej tyre s'e kishte të qartë se ç'e shkaktonte, por që gjithsesi lidhej me sapunët dhe me mërzinë.

Fill pas të huajve u larguan dhe të tjerët dhe në shtëpinë e nënprefektit mbetën vetëm hapat e bashkëshortëve, që, në heshtjen e ndërë, dukej se sa më shumë përpinqeshin të afro-heshin, aq më tepër iknin larg prej njëri-tjetrit, megjithëse i priste dhoma e gjumit.

Ndërsa zhvishej për të rënë në krevat, ku i shoqi ishte shtrirë ndërkaq, Dezi e shtyu sa mundi mendimin për ta, ose më saktë për njërin prej tyre, por, kur në dhomë zotëroi errë-sira dhe heshtja e plotë dhe xhamat e dritareve spikatën mekshëm kundruall krevatit bashkë-shortor, ajo, sikur të kishte gjetur më në fund shtegun prej nga mund t'i niste për udhë mendimet e saj, i nisi më në fund drejt të porsanjo-hurit thjesht dhe natyrshëm si në vajzëri. Ç'bënte vallë tani ai?

Të huajt ishin kthyer në hotel pak përpara mesnatës, shkruante në raportin e tij Dullë Baxhaja. Sipas udhëzimeve të zotit nënprefekt ai që ngjitur dhe kishte zënë vend sipër tavanit të dhomës së tyre qysh më parë dhe pikërisht në orën dhjetë e gjysmë plot. Pasi kishte hetuar gjendjen e tavanit, të çarat midis dërra-

save, prej të cilave, përveç dëgjimit, mund edhe diçka të shikonte, kërcitjen e tyre gjatë lëvizjeve që mund të ishte i detyruar të bënte, si dhe rrezikun e thyerjes së ndonjë dërrase të kalbët (edhe tani pas kaq vjetësh i kujtohej me tmerr ajo natë kur këmba e tij e djathhtë u shfaq si një llampadar i kobshëm në tavanin e dhomës së gjumit të bashkëshortëve Shkjezi, duke i shkaktuar infarkt zonjës plakë, infarkt që e çoi atë para kohe në varr), pra si kreu të gjitha këto, megjithëse në tavan kishte mjaft çimka, si dhe gjallesa të tjera të pështira, ai, sipas rregullave të miratuara kohët e fundit, që, siç dihet, ishin krijuar enkas për të penguar përgjumjen dhe sidomos fjetjen e përgjuesit gjatë shërbimit, kishte nxjerrë kutinë me çimka dhe i kishte përhapur ato sipër trupit të tij.

Siç e kishte shënuar edhe në fillim të raportit, të huajt u kthyen në dhomë gati në mesnatë dhe një copë herë u vërtitin si pa qëllim nga banja në dhomë dhe anasjelltas. Gjatë kësaj kohe këmbenin herë pas here fjalë në gjuhën e tyre, fjalë të cilat raportuesi nuk i merrte vesh dot fare dhe kjo, aspak për shkakun se një pjesë e fjalëve qenë shqiptuar gjatë kohës që viktimat lanin këmbët, pra i kishin furçat e dhëmbëve në gojë, (siç mund të ishte në dijeni zoti nënprefekt, raportuesi kishte dhënë prova të mjaftueshme se ishte në gjendje të kuptonte jo vetëm të folurën me furçën e dhë-

mbëve apo me ndonjë objekt tjetër në gojë, llullë, puro etj. gjer te rasti i Maria K. që kishte zakonin apo më mirë vesin që të fliste duke pasur në gojë gjëra, emërtimin e të cilave, le ta falte zoti nënprefekt, nuk guxonte ta shkruante në këtë raport). Pra raportuesi, jo vetëm ishte në gjendje të kuptonte të gjitha këto, por ishte plotësisht në gjendje të merrte vesh të folurën e viktimës që mbillaçitej, që kishte të dynofullat e dëmtuara, grykën të infektuar, tetëdhjetë për qind të dhëmbëve të hequr e të tjera raste si këto, për të ardhur gjer te fakti që me siguri dihej prej zotit nënprefekt se Dullë Baxhaja ishte i vetmi spiun përgjues në gjithë pjesën veriore të Mbretërisë që ishte në gjendje të dallonte në kushtet e përgjimit të folurën e njeriut të goditur nga damllaja, pra, shkaku i moskuptimit të bisedës s'ishte aspak se pjesa më e madhe e saj u bë me furçat e dhëmbëve në gojë (duhet shënuar këtu se larja e gojës vazhdoi jashtëzakonisht gjatë), por arsyjeja e thjeshtë se e gjithë biseda u bë në gjuhën angleze, gjuhë e cila, siç mund të ishte në dijeni zoti nënprefekt, s'dihej prej raportuesit.

Pas larjes së dhëmbëve të huajt hapën valixhet, nxorën pixhamet dhe ranë secili në krevatin e vet. Duhet shënuar se këmbyen ca fjalë në errësirë, pastaj heshtën. Në pjesën tjetër të natës s'ndodhi asgjë e veçantë për t'u shënuar. Asnjë trokitje e derës dhe aq më pak

hapje e saj prej klientëve, asnë dalje te dritarja dhe marrje apo dhënie sinjali dikujt përjashta me anë të ndonjë feneri, shkrepje çakmaku apo ndonjë mënyrë tjetër. E vëtmja gjë që mund të shënohej ishte se, ndërsa njërin e zuri gjumi, gjë që u kuptua menjëherë prej raportuesit, tjetri nuk flinte, rrrotullohej në shtrat mundimshëm, merrte frymë në formë pshëretime, kruhej. Me përjashtim të kësaj të fundit që merrej me mend se nga shkaktohej (megjithëse hotelieri kishte bërë be e rrufe se çimka s'kishte), ishte e vështirë të jepej një mendim se ç'kuptim mund të kishte gjithë kjo, domethënë që njëri prej keqbërësve flinte dhe tjetri rrinte zgjuar, dhe aq më pak se ç'tregonin rrrotullimet në shtrat dhe pshëretime. Mund të thuhej vetëm se nga përvoja e tij e gjatë raportuesi kishte vënë re se në këso rastesh, domethënë kur keqbërësit janë çift, zakonisht njërin prej tyre s'e zinte gjumi për shkak të frikës, dyshimit, ankthit apo mendi-mit për të tradhtuar. Kishte mundësi që edhe në këtë rast ky të ishte shkaku i fjetjes së njërit dhe mosfjetjes së tjetrit. Por mund të ishin dhe arsyet e tjera, dhe pikërisht që njëri prej tyre e kishte ndërgjegjen të papastër, gjë që, siç dihej, e largon gjumin, kurse tjetri, i pastri, flinte si qengj, ose, përkundrazi, i papastri, pra ai që ishte mësuar ta kishte ndërgjegjen të zhgënjer në llum, flinte i qe-

të, kurse tjetri i porsahyrë në këtë rrugë, pra ende i pastërvitur, provonte brerjen e saj. Këto zhbirime ndoshta nuk hynin në detyrën e përgjuesit dhe ndoshta zotit nënprefekt mund t'i dukej se raportuesi po futej në sferën që s'i përkiste atij, i shtyrë nga shkaqe meskine, si karrierizmi, ngritja e rrogës apo etja përlavdi, mirëpo ai dëshironte të pohonte se as gjë nga këto motive s'qëndronte dhe, në qoftë se ai zgjatej ose bëhej i mërzitshëm atje ku s'duhej, këtë nuk e bënte aspak për ato që u thanë më lart, por se kështu i qe dukur se e kryente më mirë detyrën, sepse, në fund të fundit, në një mbledhje me ta a nuk u kishte thënë vetë zoti nënprefekt se përgjuesit nuk ishin thjesht vegla dëgjimi, por njërijz të gjallë, nëpunës të shtetit, që kishin jo vetëm të drejtë, por edhe detyrë që ato që dëgjonin t'i interpretönin në mënyrë krijuese?

Duke u kthyer te shkaqet e fjetjes dhe mosfjetjes së dy viktimave, raportuesi shton me gjithatë se arsyet për këtë mund të mos ishin fare ato që ai përmendi më lart, por krejt të tjera, për të ardhur gjer te shpjegimi i thjeshtë se ndoshta kështu ata të dy i kishin ndarë rolet: njëri të flinte dhe tjetri të rrinte zgjuar për të ruajtur.

Sidoqoftë, raportuesi e kishte saktësuar në

cilin prej krevateve flinte secili, duke e shë-nuar këtë edhe në skicën që shoqëronte reportin e tij, kështu që me ndihmën e hotelierit mund të merrej vesh menjëherë kush qe i pagjumi.

## **III**

Ai që nuk flinte ishte Vili Nortoni. Ndënëse fjetjen e kishte në përgjithësi të vështirë, kishte kujtar se lodhja e rrugës, qëndrimi vonë dhe sidomos gotat që kishte pirë te nënprefekti do t'ia ndillnin gjumin. Mirëpo s'kishte qenë ashtu. Pas një ore, pasi kishin rënë, e kuptoi se ashtu do ta gdhinte atë natë. Kishte mjaftuar kafshimi i një pleshti apo çimke, që të trandej si nga një tërmet gjithë ajo materie e brishtë flu që ndante zonën e realitetit nga ajo e gjumit. Dreq, ia bëri ai me vete, paska çimka këtu. Fjalët e hotelierit: «çimka ju siguroj që s'ka, dje e kam spërkatur dhomën», të përziera me kujtimin e ecjes së mundimshme të autobusit, erën e dezinfektantit, mbërritjen në N. dhe kërkimin e hamallit, kjo e fundit

përzier me mbërritjen në Shqipëri, zyrat e pista të doganës, pastaj vështrimin e ëmbël të zonjës së shtëpisë në mbrëmje, kur dukej se gjëra të tilla qenë humbur përgjithmonë, dhe prapë fjalët e hotelierit për çimkat, «veç në rënçin nga tavani», të gjitha këto bashkë me një trazim të pashpjeguar. një nga ato lloj ankthesha që shkaktohen prej mendimit se dikush në terr po të hap derën e shtëpisë, e bënин të rrotullohej mundimshëm në shtrat.

Dyqind metra më tutje fotografi i vetëm i N., ai që pak orë më parë i shoqëruar prej spiu-nit Pjetër Prenushi, kishte fotografuar faqe për faqe fletoren e shënimeve të të ardhurave, po i lante tani filmat nën shikimin kërcënues e gjithë vrer të spiunit. Këtij të fundit ende s'po i dilte inati për fyeren që i kishte bërë nënprefekti duke ia besuar përgjimin fillestar të të huajve Dullë Baxhasë. T'u mbush mendja tanë, o kokëmish?, thoshte me vete. Kujtoje se nuk do të kishe nevojë për mua, hë? T'u mbush mendja tanë që këta njerëz janë me kulturë dhe njeriu me kulturë ato që ka në kokë nuk i llap andej-këndej, po i shkruan, he?

Fotografitë ende të lagura ishin vënë rresht mbi tharëse dhe fotografi po nxirrte të tjera prej solucionit. Le të stërviste veshët sa të donte Dullë Baxhaja, ajo që kishin në kokë të huajt ishte e shënuar aty, e zezë mbi të bardhë, he-he.

Pjetër Prenushi ndizte cigare pas cigaresh, ndërsa fotografi, me sy të prerë nga pagjumësia dhe sëmundja, po nxirrte nga ena letrat e fundit.

— Shpejt, shpejt, — thoshte herë pas here spiuni, duke parë orën.

Në orën dy pas mesnate karroca që do ta conte Pjetër Prenushin te frati, Zef Angjelini, i urdhrit të franceskanëve, i vetmi në N. që dinte të përkthente nga anglishtja, kaloi me kërkëllimë përpara hotelit ku Vili Norton rrotullohej ende në shtrat.

Në orën dy e gjysmë frati Zef, pasi bëri kryqin dhe u lut me fjalët: «falma, o Jezu Krisht, këtë mëkat», nisi përkthimin.

O perëndi, rënkoj me vete Vili Norton në shtrat. Kishte kaluar edhe net të tjera pa gjumë, por të tillë asnjëherë. Ankhi sa vente i rritej dhe fosfori i akrepave të orës që e kontrollonte herë pas here i dukej ngjethës si ndriçim qimenteresh.

Në orën gjashtë e gjysmë të mëngjesit karroca kaloi prapë me kërkëllimë përpara hotelit të tij, por ai ndihej tashmë i këputur sikur ta kishin shtrydhur.

Erdhën, për perëndi, tha me vete nënpre-

fekti që e kishte dëgjuar nëpër gjumë zhurmën e karrocës.

U ngrit me kujdes që të mos e zgjonte të shoqen dhe zbriti shkallët.

Pjetër Prenushi, pa i fshehur gjurmët e një pezmi, i zgjati zarfin e madh.

— Të lumtë, djalë, — i tha nënprefekti pa e vështruar. — Dhe tani shko të flesh.

U ngjit në studio dhe i nxori fletët e përkthyera. Në krye ishte një shënim i shkurër: «Po ju paraqes materialin e kërkuar me ngut prej jush. P.P.»

Nënprefekti mori frymë thellë. Ah, ku ishin raportet e Dullë Baxhasë. Asgjë nuk i shijonte si ato, madje turp ishte t'ia thoshtë ndokujt, as vetë romanet e dashurisë.

Po nejse, tha me vete duke hapur zarfin. Shkrimi i bukur i priftit i kishte mbushur fletët fund e majë. Tani të shohim pakëz ç'kanë në mendje pëllumbat, mendoi dhe në zemër ndjeu një sëmbim. Ishte një pikëllim përzier me një ndjenjë faji që këto të dhëna po i merrte prej tjetërkujt e jo prej Dullë Baxhasë.

Nejse, tha për të dytën herë dhe u vu të lexonte.

N.Y., 25 mars

Vili,

Erdha po s'të gjeta. Më prit pasdite rreth orës pesë. Materialet që kërkoja i gjeta. Madje më shumë se ç'shpresoja. Kam gjithashtu dy adresa për mësimin e shqipes. Përshëndetje.

**Maks**

N. Y. 26 mars

Vili,

Përsëri s'të gjeta. Ku dreqin je futur? Po t'i lë librat te postieri. Përveç metodës për mësimin e shqipes, ke aty dy vëllime me epe të vjetra në shqip, botuar në Shqipëri. Ke gjithashtu dy libra gjermanisht për baladat ballkanase të mesjetës së hershme (variante të krahasuara), si dhe librin e Shnelingut: «Homéri, i verbër?»

*Përshëndetje*

**Maks**

*Nju-Jork, 28 mars*

Mendoj se tani për tani gjërat më kryesore janë:

1. Mësimi i shqipes. Së paku sa për të lexuar eposin. E ngutshme.
2. Mësimi i stenografisë. Asnjë regjistrim i rapsodëve s'mund të përfytyrohet pa të.
3. Mbajtja e shënimave për të gjitha këto (Idetë, pandehmat, dyshimet). E detyrueshme kjo. Më vonë mund të na shërbejnë për librin.
4. Ruajtja e plotë e sekretit. Një pakujdesi e vogël do të ishte katastrofike.

**N.Y., 2 prill**

Maks i dashtun. Shum gëzu. Un telefon ty pasdite. Nadja mirë, heu!

**Vili**

(Kjo pusullë si edhe disa të tjera janë në shqip. Shënim i përkthyesit.)

*Nju-Jork, 4 prill, e diel*

E diela e parë me diell pas kaq kohe vranësinash. Në shqip kësaj i thonë e diela, d.m.th. e diellta.

Jashtë është shumë bukur, por neve as që na shkon mendja për shëtitje apo gjësend tjetër të tillë. Jemi krejt të magjepsur pas zbulimit tonë, aq sa gjithçka tjetër na duket e zbehtë dhe pa gëzim.

S'më besohet që kanë kaluar vetëm dy javë që nga koha kur, për ne të dy, mua dhe Maksin, nisi kjo aventurë pasionante. Më e madhja, themelorja, absolutja e jetës sonë.

E largët si nga një tjetër stinë më përfytyrohet tani ajo pasditja e mërzitshme, kur unë, nga që s'dija ç'të bëja gjysmë i shtrirë në kanape, dëgjoja radion. Dhe më e zakonshme se pasditja vetë, më ngjante intervista që po jepte në radio profesori Stjuart, rutinë e njobur; çështja homerike, një polemikë që vazhdonte qysh prej treqind vjetësh, dy pikëpamjet kryesore, pikëpamja e tretë, uh, nga të gjitha këto mund të vdisje nga mërzia, ishte Homeri vërtet krijuesi i mirëfilltë i «Iliadës» e i «Odisës», apo s'ishte veçse një lloj redaktori, apo më saktë një lloj shefi redaksie... Natyrisht, po të përdorim termat e kohës sonë, dhe këtu, tamam në vendin e planifikuar, e qeshura e reporterit e përzier me atë të të intervistuarit. Uff, po bëhesha gati të ngrihesha për ta mbyllur radion, madje kisha arritur të thosha me vete: emision i mirë për t'u habitur rrobaqepëset, kur në atë çast homeristi, duke iu përgjigjur **një ndërhyrjeje** të intervistuesit, kishte hapur

një parantezë. Ishte ajo parantezë e bekuar që e kishte mbajtur pezull krahun tim. A ekziston ndonjë vend apo ndonjë rajon në botë ku mund të krijohet ende epos i tillë? Jo, pyetja juaj nuk është aspak naive, kishte thënë profesori, përkundrazi është tepër interesante. Dhe homeristi, për habinë time (dhe aspak të rrobaqepëseve), kishte shpjeguar se në të vërtetë një rajon i tillë ekzistonte, një rajon i vogël, i vetmi në botë ku ende kultivohet kjo lloj poezie. Madje ai po e saktësonte edhe zonën: ndodhej në Gadishullin Ballkanik, më saktë ishte krejt Shqipëria Veriore, pastaj zona vazhdonte në një pjesë të Malit të Zi dhe vende-vende arrinte gjer në Bosnjë të Jugosllavisë. Pikërisht ky rajon, po shpjegonte i intervistuari, ishte i vetmi në globin tokësor që prodhonte ende një materie të tillë poetike si ajo e Homerit, me fjalë të tjera, ishte atelieja, laboratori i fundit, po të përdornim një fjalë të sotme, që ende jepte...

Kuptohet që unë, stazhieri i zakonshëm, Vili Norton, që bashkë me mikun tim, Maks Rothin, kishim ardhur që nga Irlanda për të bërë doktoratën për çështjen homerike, duke u përpjekur (por pa ndonjë besim) të thoshim një fjalë të re në debatin e lashtë, kisha mbutur i shtangur në mes të dhomës.

Laboratori i fundit, thosha me vete. Atelieja e fundit. I përsërisja si i lajthitur këto fja-

lë, thuase ndërgjegjja ime bënte një kundërsh-tim për t'i pranuar. Mendimi më ishte vënë në lëvizje gjithaq me një vërvitje të marrë, sa edhe me ngecjet në vend dhe rikthimet pas që shoqërojnë një gjendje të ethshme. Radioja vazhdonte të fliste, por unë s'e dëgjoja më. Atelieja e fundit në botë, thirra me zë, si të doja të çliroja mendimin nga mpirja. Së shpejtë ai mund të zhdukej. Qysh tani ishte në prag të zhdukjes. Duhej përfituar sa s'ishte vonë. Sa s'ishte rrënuar, mbuluar me rërë, me tis harrese.

E gjeta veten duke i rënë dhomës kryq e tërthor. Do të doja ta mendojë punën më që-tësisht, por s'ishte e mundur. O zot, duhet ngutur, thosha me vete. Duhet shkuar sa më parë atje. Në laboratorin e vjetër. Mijëvjeçar. Të hetohet nga afër, si në mikroskop, si në stetoskop si prodhohet dylli, palca homerike dhe pastaj një hap mbetet gjer tek enigma e Homerit vetë.

Shët, ia bëra me vete pas pak. Askujt, asnë fjalë për këtë. Veç Maks Rothit.

Truri vazhdonte të më shkumëzonte. Jo tru, po Niagarë. Si vallë nuk i kishte shkuar mendja askujt për këtë? Për të bërë analizën, për të studiuar në vend mekanizmin mijëvjeçar që prodhonte atë brumë të magjishëm. Dhe kjo mrekulli ndodhte ende në kohën tonë, kurse ata, në Manhattan, në Paris, në Dublin, mijëra kilometra larg, bënin diskutime shterpe.

I vetmi truall, përsërisja me vete. I vetmi që ishte në gjendje ende të pillte epose. Pjesa tjetër e globit prej kohësh ishte në menopauzë. Zona e vetme kishte mbetur ajo. Që ende ishte e ndjeshme. Që ende mund të mbarsej për të lindur epet e fundit. Se pastaj për gjithçka do të ishte vonë. Dhe rëra dhe braktisja do të mbulonin gjithçka bashkë me enigmën.

Pas kësaj gjëja e parë që mendova të bëj ishte t'i telefonoja Maksit. Por telefoni i tij s'përgjigjej. Dola në rrugë, ku nisa t'i këpusja nga një të sharë çdo taksie që s'ndalonte. E ndieja se nuk isha në gjendje ta mbaja brenda vetes atë gjë që e kishte ndarë më dysh ditën e ndoshta krejt jetën time. Një ide e tillë e hatashme, o zot, thosha me vete, nuk e di pse, në formë lutjeje. Frika se mos nuk arrija t'ia thosha askujt ato ide më pushtoi sakaq. Një ak-sident i papritur, një rrëshqitje dhe gjithçka varrosej përjetë. Dritëzat e zbehta të rrroka-qiejve i kisha mbi kokë. Mospërfillja e tyre ishte e padurueshme. Ta kisha formuluar së paku im dy fjalë atë ide. Në një copë letër. Në kartëvizitën time. Në librezën e arkës së kursimit. Kështu që gjithsesi të mos kishte rrezik humbjeje.

Më në fund e gjeta Maksin. Behja e tij ishte e menjëhershme dhe jo më pak se imja. Isha i lumtur. Replikat kryqëzoheshin si në ethe. Ide e hatashme. Do të tundej bota e tërë.

Katedra e antikitetit në Masaçusets. Kongresi i studimeve jugevropiane. Qyteti i tyre irlandez, ku njerëzit ndoshta do të tundnin kokat me mosbesim. Vili Norton me Maks Rothin? E keni dëgjuar ndoshta gabim. Do të jenë të tjerë.

Qeshnim me të gjitha këto. Këndo. Dhe prapë përfytyronim bujën e ardhshme. Këndo, o muzë, zemërimin e Harvardit, e International Center of Homeric Researches, e vjeħħrës sime idiote, Dianë Stratfortit, shtonte Maksi.

O zot, mos qeshäm shumë? Të niseshim menjéherë atje, te vendi, te rajoni, te laboratori që po jepte shpirt. Ta shpallnim që nesër në shtyp. Ta shpallnim? Përkundrazi ta mbanim sa më të fshehtë. Të bënim sikur s'na kishte shkuar kurrë mendja në gjëra të tilla. Pak peshkaqnenë kishte që do të suleshin me vrap pér të mbërritur para nesh atje? Jo. Kurrsesi s'duhej pëshpëritur asgjë. Atéherë s'na mbetej gjë tjetër veç të niseshim në çast. Pa lajmëruar askënd.

I përsëritëm disa herë këto fjalë, gjersa Maksi, duke më ngulur sytë, tha me zë të ulët: ide e mirë; pa dyshim, por... sidoqoftë duhet... një përgatitje.

Ishte hera e parë që mbi pérndezjen tonë ranë pikët e para të një dashi të ftohtë. Duhej pa dyshim një përgatitje, madje serioze. Por aty pér aty, duke dashur të zgjatnim edhe pak

dehjen tonë, ne nuk u ndalëm të vrisnim mendjen se ç'përgatitje duhej. Ishte më e këndshme të mendoje bujën e ardhshme, sensacionin, titujt me shkronja të mëdha të gazetave: Ç'ka qenë Homeri? Poet i verbër, siç e përfytyrojnë miliona shkollarë, apo redaktor, apo shef redaksie, siç thoshte Stjuarti. Poema të lashta «Iliada» e «Odiseja», mbledhur e botuar nën kujdesin e sër Xh. F. Homerit, i Akademisë Greke, ha-ha-ha.

Ndonëse na pëlqente ta zgjatnim gjendjen ngazëlluese, e ndienim se shqetësimi i parë se si do të kryhej kjo gjë kishte mbërritur ndërkaq në ndërgjegjen tonë. Atje rapsodët ishin ende të gjallë sipas Stjuartit. Rapsodët e fundit, pa dyshim, domethënë homerikët e fundit. Që do t'i dëgjonim e do t'i regjistroronim, por do të bënim krahasimin midis tyre. Edhe kjo merrej me mend. Krahasimi i rapsodëve. Krahasimi i motërzimeve. Po a mjaftonte kjo? Ne i shkruam këto dy fjalë në të gjitha fletoret tona dhe në çast e kuptuam se e gjithë kjo aventurë e ardhshme ishte më e ndërlikuar se ç'e menduam në fillim. Kuptuam gjithashtu se ne nuk mund të niseshim për në Shqipëri, jo vetëm pas dy ditësh, por as pas dy javësh, e ndoshta as pas dy muajsh në qoftë se nuk donim t'iu ngjanim dy donkishotëve të trishtë.

Dhe kështu iu shtruam punës për t'u përgatitur vërtet.

*N. Y. prill*

Vazhdon kohë e bukur. Por ne s'duam t'ia dimë ç'ndodh përjashta. Arsyeva? Merret me mend.

Mësimi i shqipes OK. I stenografisë gjithashtu.

Gjetëm më në fund një botim të fundit pothuajse të plotë të eposit shqiptar. Me emrat e rapsodëve prej nga janë mbledhur këngët. Sipas shënimave del se shumica e rapsodëve janë ende gjallë. Fantastike! Pra botimi është një ndër qindra botimet e mundshme. Nga të tjerë rapsodë mund të sajohen botime të tjera. Eposi shfaqet kështu në një mijë fytyra. Si rishfaqja e qenieve në metempsikozë.

Duhet ngutur.

*N. Y. mesi i prillit*

Neve nuk na intereson eposi shqiptar në vetvete sesa teknologjia e prodhimit të tij, po të përdorim një term të kohës. Prej saj ne do të përpinqemi të nxjerrim një të vërtetë universale: si lind ky lloj eposi. Rrjedhimisht: enigma homerike.

Krahasimi mbetet një ndër kyçet e punës sonë. Por jo vetëm krahasimi midis rapsodëve.

Madje më i rëndësishëm se ky është krahasi-mi brenda për brenda një rapsodi. Domethënë si e këndon sot epin, dhe si e këndon të njëjtin ep pas njëfarë kohe. Pas një muaji. Pas tre muajsh. Sepse, siç e pohojnë të gjithë hulumtuesit, asnjë rapsod, sado kujtesë të shkëlqyeshme të ketë, nuk mund ta këndoja epin njëlloj.

Me sa duket këtu nuk është vetëm çështje kujtese. Kjo lidhet me një element bazë të epos-it gojor: mekanizmin e harresës. E cila gjithash tu s'është thjesht harresë, por diçka më e ndërlikuar. Mund të jetë harresë padashur, por mund të jetë edhe harresë e ndërgjegjshme. Një gjoja harresë që përligj ndërhyrjen.

E gjithë kjo të kujton botimin, ose më saktë ribotimin në kohën tonë. Por ribotimi i një vepre të cilën s'e mbron kush. Veç një shije publike. Rapsodi është pjesë e makinës së eposit. Ai është edhe botues, edhe librar, edhe bibliotekar, e ndërkaq ai është më shumë se kaq, ai është njëkohësisht bashkautor i vonë, që ka të drejtë të ndryshojë tekstin. Kjo është e ligjshme. S'ia mohon kush. Veç ndoshta ndërgjegjes së vet.

Tani për ne është e qarët se pyetjen, që na dukej dikur themelore, për shpjegimin e enigmës homerike: sa vargje është në gjendje të mbajë mend një rapsod (disa thonë gjashtë mijë, disa tetë e disa dymbëdhjetë mijë vargje), duhet ta plotësojmë me pyetjen: sa dë-

shiron të harrojë një rapsod? Ose më mirë: a mund të ketë një rapsod *pa harresë?*

Me këtë rast duhet shënuar se ne ende dimë pak për botën e rapsodëve. Si janë ata vetë, si u spikat dhuntia, kur afirmohet prej publikut, nga varet fama ose rënia e saj? Si janë garat midis tyre, stilet, shkollat, zilitë, luftërat, skartimi i mediokrititetit, seleksionimi i vlerave?

Ne s'dimë pothuajse asgjë nga të gjitha këto. Ne do ta hetojmë gjithçka atje në vend. Dhe në qoftë se do të kemi fat, do të depërtojmë në atë univers. Të kuptojmë si gjellon brurri i vjetër në ato anë. Si ka gjelluar gjithmonë. Qysh nga koha e *atij*, H.

N. Y., prill

E dyta herë gjatë javës që pata një shqetësim në sy. Herën e parë vështrimi m'u vesh si me mjegull. Thashë me vete se e kisha nga leximi i dendur dhe nuk i dhashë rëndësi. Sot m'u përsërit, por pak ndryshe: hapësira m'u bë si qelq i krisur që lodronte dridhshëm pa u futur në fokus. Pata ndjesinë se ajo dridhje po ma plagos retinën. Pastaj vështrimi m'u mjegullua një copë herë të gjatë.

Duhet të shkoj patjetër tek okulisti.

*N. Y., maj, java e parë*

Gjetëm materiale të reja të shkencëtarëve gjermanë. Janë të parët që e kanë studiuar eposin. Sidomos motivet e përbashkëta greke e shqiptare. Shtegtimet nga njëra mitologji te tjetra. Kryqëzimet. Shtresimet e ndërsjella.

Njëri prej tyre shkruante se procesi i krimimit të eposit ishte mbyllur në Shqipëri prej vitesh, gjë që na dëshpëroi ca ditë. Ndërkaq gjetëm pohime të kundërta: që procesi vazhdon. Ka edhe një tezë të mesme që ngulmon se koha e eposit në Shqipëri vërtet ka kaluar, por aty-këtu, si një zjarr që po fikej, ai jepte ende ndonjë shkëndijim të fundit. Gjithmonë sipas kësaj teze, edhe në qoftë se prodhimë epik është në shterim e sipër, punishtja, sadc e vjetër, është ende në këmbë.

Kuptohet gjendja jonë shpirtërore pas kësaj. Të ngutemi, Të shpejtojmë sa pa u fikur zjarri. Dhe sa pa u rrëzuar punishtja.

*N. Y., maj*

Si hyn materia e gjallë e jetës, materia bruto po të shprehemi me një term banal, si hyn pra kjo materie në makinën e eposit për të dalë që andej e kthyer në art?

Një kapitull tjetër ky, po aq magjepsës sa edhe harresa.

Gjermanët ngulin këmbë se ka ende rapsodë shqiptarë që kthejnë në epos (homerizojnë) ngjarje bashkëkohore. Do të ishim me të vërtetë me fat të rrallë sikur një mrekulli e tillë të ndodhte në sytë tanë. Atëherë, po, mund të themi se do të gjendemi vërtet pranë enigmës.

Ditët e fundit jemi marrë kryesisht me këtë gjë. Sa herë që bie fjala për të, padashur më vjen ndër mend një fabrikë e vjetër për regjje lëkurësh pranë lagjes sime, në rrithinat e Dublinit, e braktisur prej kohësh tashmë. Ja kështu më përfytyrohet punishtja e vjetër homrike.

Si përpunohej ngjarja kur *hynte* në ato rrotëza, dhëmbëza, enë plot lëng të errët misterioz? Si merrnin pjesë në proces mushkëritë e rapsodëve, truri i tyre, fantazmat, pasionet, raca?

E gjithë kjo i ngjante procesit të balsamosjes. Veç jo të një kufome, por të një cope jete, një ngjarjeje, më tepër mynxyre.

Në fund të fundit, eposi vetë, i marrë përgjithësisht, s'është veç një lloj morgu. Një frigorifer, siç quhen tani ca dollapë ngrirës, që porsa janë shpikur. S'është e rastit që klima që përshkruhet në të është gjithmonë e ftohtë, tepër e ftohtë. Temperaturat janë përherë nën

zero. Dhe veç kësaj si një formulë e përhershme përsëritet refreni: «Shum' po shndrit nj'ai diell e pak po nxeh».

*N. Y., mesnati*

Më ka dalë gjumi. Jashtë regëtijnë zbehtë dritëzat e rrokaqiejve. Të rralluara edhe ato, si të huajtura nga vëtmia e galaktikës.

Midis tyre spikatin reklamat për ca salca dhe ca vitamina për forcimin e të parit. Më duket se njëra prej tyre është tamam ajo që më ka shkruar në recetë okulist i im.

E përfytyrova emrin e Homerit së bashku me emrat tanë, Vili Norton dhe Maks Roth (për perëndi, krejt pamje e dy njerëzve që shoqërojnë një të verbër), midis titujve të gazetave dhe shkronjave me drita të lajmeve.

Nuk e fsheh që ngazëllimi ishte dehës njëlloj si ditën e parë. Tani që gjatë intervistimeve në radio është e modës t'u bëhen personaliteve pyetje të tilla si p.sh. ç'libër do të merrni me vete po të jeni i detyruar të veçoheni përgjithmonë në një ishull, ose akoma më keq, po të detyroheni ta braktisni planetin tonë etj, etj., ne me Maksin kishim të drejtë të krenohejshim ngaqë vërtet po merremi me një punë tepër të fisme. Po të hamendësonim (gjithmonë sipas stilit të këtyre intervistave) se do të ishte

e detyrueshme që historia e planetit tonë të kumtohej diku me njëzet a tridhjetë rreshta, jo më shumë, mund të thoshim pa frikë se edhe në këtë rast emri i Homerit do të kishte vend në atë kumtim. Mjafton kjo që të na jepte zemër në çastet e ligështimit.

*N. Y., maj, dita e fundit*

Ditë e mrekullueshme. E surprizës. E shansit tonë.

Do të besoja vërtet në një ndërhyrje hyjnish. Jo më kot edhe fjalët *magnet* dhe *toni*, sidomos kjo e fundit, vinin që andej larg, nga bota antike.

Sepse ishin këto dy fjalë, ose më saktë një fjalë e krijuar prej të dyjave, një fjalë e panojohur gjer dje, por që qysh sot ishte bërë për ne magjike, fjala *magnetofon* që e mrekulloi gjithçka: ditën e sotme, shtegtimin e ardhshëm, gjithë punën tonë.

Gëzimi e pengonte Maksin të ma shpjegoente qartë në telefon. Ngutej, belbëzonte si i marrë, për njëfarë aparati që porsa ishte shpikur, për një mrekulli që dukej si e krijuar enkas për ne. Në dreq të vejë mësimi i stenografisë, më dëgjon, ulërinte ai. S'kemi nevojë për të, më kupton?

Mezi arrita më në fund të marr vesh diçka.

Ishte fjala për një aparat që regjistronte zërat njerëzorë. Që mund të mbartej me vete kudo. Që jo vetëm regjistronte, por edhe i riprodhon-te zërat sa herë që të doje. Është tamam për ne, më kuption, vazhdonte të ulërinte ai. O zot, sa i trashë që je.

Ai priste që unë të brohoritja si ai, por isha kaq i hutuar, saqë nuk shqiptova asgjë, madje dhe kur hapa gojën, thashë një gjë që s'e kisha menduar: «A je i sigurt?»

Ai më shau në telefon. Pastaj, duke më quajtur, nuk e di pse, të pabesë, judë Iskariot dhe pede, më tha se kishte në duar reklamën e prerë nga gazeta bashkë me adresën e dyqanit, madje dhe çmimin.

Në drekë u takuam dhe gjithë pasditen e kaluam si të dehur. Aparati ishte vërtet si i dërguar nga providenca për punën tonë. Një mrekulli nga çdo pikëpamje. Vetëm çmimin e kishte të shtrenjtë. Jashtëzakonisht.

*N. Y., 8 qershor*

Skeda. Skeda. Skeda. Puna po na shkon mirë.

Midis të tjerash u njohëm diçka me Shqipërinë. Vend i vogël. Popull i moçëm. Histori tragjike. Në fillim vend evropian. Pastaj sundim aziatik. Në shekullin XX i rikthehet Evropës.

Gjysma e kombit jashtë kufijve shtetërorë.

Përveç eposit, që, për mendimin tonë, është pasuria kryesore e vendit, ka gjithashtu krom dhe naftë. Ka dhe një mbret me emër shpendi, Zog I. Bird I.

Dje bëra një vizitë tjetër tek okulisti. Më dha të njëjtën recetë.

Maksi ka pasur probleme me gruan.

Po përpinqemi të sigurojmë sa më shpejt shumën e nevojshme për blerjen e aparatit.

Gjithë idetë tona po i rishikojmë tanë në raport me të. Për çudi, futja e tij në punën tonë s'krijon asnjë bezdi. Është aq harmonike, saqë duket sikur ne e kemi menduar këtë punë sikur ta dinim që ai qe shpikur ndërkaq. E kishim siç duket brenda nesh.

### *N. Y., mbarim qershori*

Sapo u kthyem nga Uashingtoni ku bëmë kërkesën për udhëtimin në Shqipëri. Nuk e fsheh se jemi pak të zhgënjiyer nga pritja në Ambasadën Shqiptare. Asnjë entuziazëm. Përkundrazi dyshim dhe mosbesim.

Ambasadori që na priti vetë na la me gojë hapët. Ishte i zgjuar, tinëzar dhe ironik. I dërguari i Mbretërisë së vogël gjysmarkaike-gjysmëgrotëske, njihte shkëlqyeshëm letërsinë botërore, fliste gjithë gjuhët kryesore evropiane,

duke përfshirë edhe suedishten, kishte qenë mik; madje mecenat i Apolinerit, tallej me çdo gjë, sidomos me vendin dhe popullin e vet. Kur ne, duke u përpjekur ta mjegullonim sa më tepër motivin e udhëtimit, kishim përmendur me gjithatë Homerin, ai kishte thënë: e dinë se thonë që në vargun e parë të Iliadës, Menin aeide thes Peleiadeos Ahilaios, Mëninë këndo hyjneshë të Akil Peleut, fjala Menin, siç e shihni, është fjala shqipe mëni? Kështu që ndër tri-katër fjalët e para të letërsisë botërore, e para dhe, për fat të keq, më e hidhura është një fjalë shqipe, ha-ha. Dhe kishte filluar prapë të ironizonte me Shqipërinë aq mizorisht, saqë Maksi i kishte thënë: «Nuk ju kuptoj, shkëlqesi, kur flisni me tallje është kur seriozisht. Për shembull, ajo puna e fjalës *mëni* te Homeri, për ju është një teprim, apo një...» Sytë e ambasadorit kishin xixëlluar frikshëm nga një përzierje zgjuarsie, cinizmi, pikëllimi dhe ligësie bashkë. «Ajo puna e fjalës mëni besoj se është ashtu siç ju thashë, por...»

Fjala i mbeti në gojë, vështrimi iu ngrys edhe më, vetëm anëve shkëndijonte edhe tallja, por në mesin e tij ai vështrim që i tmerrshëm. Pas «por-it» pasoi një heshtje e gjatë e gjatë, që ia rriste edhe më peshën atij «por-i», e bënte edhe më të rëndë, saqë për të dytën herë, duke mos e duruar atë heshtje, Maksi kishte ndërhyrë: «Por, shkëlqesi?».

Por shqiptarët e sotëm s'janë ashtu siç mund të kujtoni ju, kishte thënë më në fund ambasadori. Ne ende s'po kuptojmë asgjë, ndërhyra unë. Ju jeni shqiptari i parë që ne po njo-him dhe nuk e fsheh që jemi të... të... mahnitur.

Ambasadori kishte qeshur prapë, ndërsa konsulli, që ishte bashkë me të dhe që gjatë kohës së takimit nuk e kishte hapur gojën, na vështronë tani me një dyshim prej guhaku. Zot i madh, e tregon qartë që dyshon se jemi spiunë, mendova, kur konsulli vështroi me bisht të syrit hartat që Maksi nxori nga çanta përt'ia treguar ambasadorit.

Konsulli na mori për spiunë, i thashë Mak-sit kur po largoheshim. E vura re dhe unë, m'u përgjigj ai. Si t'u duk ambasadori?, më pyeti. I çuditshëm, i thashë. I çuditshëm, hm, ia bëri Maksi. Është pak të thuash.

N. Y., shtator

Përgatitjet e fundit. Para dy javësh e blëmë më në fund magnetofonin. Net pa gjumë. Prova regjistrimi (Maksi një natë u përpoq të këndonte si rapsod). Është i mrekullueshëm. Vëtëm se është pak i rëndë. Dhe do të zgjojë me siguri kureshtje në të gjitha doganat.

Përsëri pata veshje sysh. Me siguri nga le-

ximi i shumtë. Maksi ka pasur prapë acarim me të shoqen. Nuk i pëlqen kjo që po bëjmë. Maksi tha dje: në djall të vejë në qoftë se nuk i pëlqen.

Presim përgjigjen për vizë nga Uashingtontoni.

Këtu mbaronin shënimet. Nënprefekti fërkoi sytë. Dreq, o punë, tha me vete. E ndiente veten fare bosh.

Diçka i tërroqi vëmendjen te dritarja. Ish-te shiu që përplasej herë-herë prej erës. Sapo kishte zbardhur një nga ato mëngjeset e pistë që, fill pas zgjimit, s'të sjellin asgjë të mirë ndërmend, veç borxhit që duhet të lash javën që vjen ose dyshimin për kancer, që ende s'ia ke treguar kujt.

«Konsulli na mori për spiunë, i thashë Maksit...» Nënprefekti i lexoi e i rilexoi këto fjalë dhe tundi kokën. Të poshtër, murmuriti. Kujtojnë se i kanë dalë së keqes përpara duke e përmendur vetë fjalën «spiun». Kush ka mizën nën kësulë... Demek ne që s'e kemi mizën nën kësulë s'kemi frikë nga fjalë të tillë... Po atij s'ia hidhnin dot. Spiunë e më keq duhet të ishin. Gjithë ato dokrra për gjoja Homerin e rapsodët s'ishin veçse maskim për punën e tyre të mbrapshtë. Enkas i kishin shkruar dhe këto shënimë

dhe enkas i kishin lënë në valixhe që ai idioti Pjetër Prenushi t'i gjente sa më lehtë.

Hajvan, shfryu me vete nënprefekti. Mendjefyçkë. Ia kishte zgjatur zarfin gjithë ngrefosje, si për t'i thënë: e sheh sa i zoti jam?

Eh, tarallak i shkretë. Të kanë gënjer, o krap, janë tallur me ty. Veç mua s'ma hedhin dot me këto letra. Të gjitha ato janë kallpe. Të shohim ç'do të na thotë Dullë Baxhaja.

Si pérherë kujtimi i Dullë Baxhasë ia uli acarimin. Jo më kot i pëlqente të thoshte se ai ishte balsami, gjumi i tij i qetë. Sa herë që e kapte ndonjë ankth i papritur, ato ankthe pa shkak që janë edhe më sfilitëset, e përfytyronte të kacavarur diku, nëpër oxhakë, në trarë të nxirë dhe qetësohej në çast. Ai dëgjon, thoshte me vete, ai e përgjon të keqen...

Kurse ty të gënjen, o buf, nisi të shfrynte përsëri. Të vunë përpara hundës ca letra dhe ta morën mendjen. Spiunët e poshtër... kurvarët...

Një mllef i verbër, nga ato që ngjiten nga gropë shumë të thella të qenies, e përshkonte herë-herë.

Iu duk se kërcitën prapë kanatet e drirates, por ishte dera. Ai u habit kur te pragu i saj pa Dezin.

E ngrohtë ende nga shtrati, me këmishën e natës të tejdukshme, ajo i qe afruar heshturazi. Zot, sa e ëmbël ishte. Nuk i thoshte më kot

se pagjumësia i shkonte më mirë se çdo lloj tualeti...

— Ç'bën këtu? — tha ajo me zë të ulët.

Padashur ai mbuloi me dorë letrat, por systë e saj ishin ende të turbullt për të dalluar ç'kishte në to.

— Si e sheh, punë...

— Më trembe. Ka ndodhur ndonjë gjë?

Ai i përkëdheli flokët.

— Fli ti, fli akoma. Është herët.

Në dritare era cijaste ultazi. Ndërsa ajo dilte, tek ndiqte me sy format e bukura të vtheve të saj, vështrimi i tij u pre nga një dritë e ftohtë.

Në ato letra ishte shkruar diçka për pjetorinë, për mbarsjen sa s'ishte vonë. Madje përmendej edhe sperma homerike...

Ai i shfletoi letrat me egërsi. E gjeti vendin. Ishte tamam ashtu, me përjashtim të fjalës «spermë» që ishte shkruar «palcë». Por kjo ishte pothuajse e njëjta gjë.

Tani e kuptoi nga i erdhi ai duf i shurdhër. Sa herë që dikush përmendte mospjelljen apo mbarsjen, i dukej se e kishte fjalën për gruan e tij. Madje edhe më keq: i dukej se e lakmonin, se mezi çprisinin të lëshonin spermën e tyre brenda saj. Që të pillte... sa s'ishte vonë... sa pa ardhur menopauza... dhe muzgu...

Gjatë darkës, njëri prej tyre i hidhët asaj shikime të ëmbla. Natyrisht... përsëriti me ve-

te. Tani ishte gati të besonte se enkas kishin ardhur që nga fundi i botës që të flinin me të.

Ndjenja e xhelozisë përzihej me një lloj të veçantë epshi, djegës gjer në marramendje.

Që larg tingujt e kampanës së kishës frangëskane vinin të trishtë, sikur midis shiut kërkonin ndjesë për diçka. E përfytyroi fratin Zef tek kryente shërbesën fetare, me sytë ende të fryrë nga nata pa gjumë, dhe mendimi se ndoshta flinte me ndonjë murgeshë i vtoi zbehtë. Ndryshe s'kishte si t'i përkthente me aq zell fjalët gjithë epsh të irlandezit.

Mendimet i shkuan prapë te trupi i bardhë i Dezit. Ishte e qartë që ia lakmonin. Endërro-nin të flinin me të, ta linin shtatzënë...

Turbullira epshore e ndryshme nga herët e tjera e përshkoi prapë të tërin. U ngrit, doli nga studioja dhe kujdeshshëm hyri në dhomën e gjumit.

E pa tek flinte e qetë dhe, ndonëse iu duk më e dëshirueshme se kurrë, nuk guxoi ta zgjonte.

Dezi nuk flinte. Sa dëgjoi derën e dhomës që krisi, i mbylli sytë dhe ngadalësoi frysë-marrjen. Ndaj të gdhirë, duhej të kishte parë ëndrra erotike, sepse ndihej krejt e molisur.

Jashtë mëngjesi kishte gdhirë i zymtë. Edhe

kambana e kishës së fretërve françeskanë, ash-tu i lëshonte tingujt, të mekur.

Ajo deshi të bënte kryq, por ngrohtësia e shtratit ia kishte hequr dëshirën për çdo lloj lë-vizjeje. Në vend të kryqit dora e saj lëvizi përtueshëm mbi gjinjtë, pastaj mbi barkun e saj, ndërsa i vinte të qante.

Treqind hapa më tutje, kryqin e bëri Vili Norton. Ishte ende gjysmë i fjetur, megjithatë, ndonëse mezi e ndjeu kambanën, dora i lëvizi mekanikisht mbi gjoks.

Nata kishte qenë vërtet e skëterrshme. Vetëm ndaj të gdhirë makthi, që s'kishte lënë skutë të trurit të tij pa trazuar, e kishte lënë më në fund të qetë. Në dritën e agut, mbulesa metalike bojë hiri e aparatit të regjistrimit, spikaste dobët. Aty je, bablok, mendoi ai me një gjësim të qetë. Ndihej fashitja që sillte afrimi i mëngjesit. Madje edhe kafshimi i çimkave e kishte humbur forcën, thua se edhe ato ishin përgjumur.

Ndryshe i bien këtu edhe kambanës, arriti të mendonte, para se ta zinte gjumi përsëri. Por edhe në gjumë vazhdonte t'i ndiente tingujt, humbëtarë e të pikëllueshëm si rrallëkund.

## IV

Përpara hotel «Globit» një grumbull i vogël kureshtarësh pritnin daljen e dy irlandezëve, apo më mirë të bagazheve të tyre, për të cilat hamalli Cute Arapi kishte bërë be e rrufe se do të shkaktonin të papritura gjatë ngarkimit në karrocë, të papritura që mund të shkonin nga marrja e këmbëve, rrëzimi dhe gjyntimi i shërb~~yesve~~ të hotelit, që do të merreshin me to (më kot Cute Arapi kishte pritur që hotelieri të thërriste atë për këtë punë), gjer te krisja e karrocës dhe, pse jo, rrrokullisja e saj në hendekan e rrugës. Sepse, veç peshës së frikshme të bagazheve të nëmura, Cute Arapi fliste tani edhe për njëfarë turbullire shkaktuar me siguri nga valixhet e të huajve. Dhe, kur truri i njeriut e kishte pësuar një mpirje të ti-

llë, merreni me mend se ç'mund të pësonte truri i kuajve, kishte thënë hamalli duke lënë të nënkuptohej se më e pakta gjë që mund të ndodhte ishte tërbimi i kafshëve dhe shkatërrimi i karrocës bashkë me karrocier e udhëtarë.

Karocieri Lym, që i kishte dëgjuar të gjitha këto, ishte paraqitur me gjithatë në orën e caktuar përpara hotel «Globit», duke treguar me këtë se nuk ua vinte veshin parathënieve ogurzeza të hamallit. Kuajt e mi janë më të mençur se Cuto Arapi, thuhej se kishte thënë ai, kur dikush i kishte çuar mendimin e Cutës në lidhje me krahasimin e trurit njerëzor me atë të kuajve. Megjithatë grupei i kureshtarëve, që prej më shumë se një orë priste si do të mbaronte kjo ngjarje, vuri re njëfarë shqetësimi në ftyrën dhe lëvizjet e kamxhikut të tij në kohën kur nga dera e hotelit dolën të huajt.

Binte një shi me pika të rralla, me gjithatë të huajt nuk hipën në karrocë përpara se të vendoseshin në të bagazhet. Gjatë sjelljes së bagazheve gjer te karroca, pati vërtet marrje këmbësh nga ana e shërbëtorëve të hotelit, të sportelistit që qe bashkuar me ta; dhe sidomos të vetë hotelierit që ndihmonte tërë grupin, por marrja e këmbëve, me gjithëse pati çaste që u shtua tepër, nuk kaloi asnjëherë në rrëzim të ndonjërit, e aq më pak të krejt grupit (Do të palosen mbi njëri-tjetrin, për perëndi,

kishte thënë Cute Arapi.) Ndodhi vetëm diçka që nuk e kishte parashikuar as Cutja e askush tjetër: njëri nga të huajt, duke ngritur kokën me shqetësim drejt qiellit, diçka i tha tjetrit, pastaj të dy u matën t'i thoshin diçka shërbyesit që mbante njérën nga arkat, po, ndërkaq, : pari, duke hequr me shpejtësi mushamanë, ia hodhi sipër arkës, gjë që e bëri tjetrin të tundte kokën, si të donte të thoshte: shumë mirë e bëre.

— Aha, atë arkë siç duket e ruajtkan nga shiu, — tha dikush. — Atje e paskan gjithë... gjithë...

— Çfarë? — pyeti një zë.

Tjetri s'u përgjigj.

— Çfarë mendoni se kanë në atë arkë? — pyeti prapë zëri.

Njeriu e vështroi me ca sy të shqyer jashtë mase.

— Shko pyeti, po deshe, — hungërroi ai.

Ai që kishte pyetur ngriti supet.

Ndërkaq karroca u nis, duke shkaktuar një lëvizje në qafat e njerëzve sikur të ishte e lidhur me ca penjë të padukshëm me të.

Pas një çerek ore ajo e la pas qytethin dhe po ecte e vetme në rrugën automobilistike. Udhëtarët, secili nga dritarja e vet, vështronin fushën, që dukej e pikëlluar sidomos në skajet e saj.

Vili Nortoni fërkoi sytë me shputat e duarve.

— A ka mjegull në fushë apo më bëhet mua ashtu? — pyeti ai.

— Ka mjegull posa, — u përgjigj Maksi.

Vili mori frymë i lehtësuar. Duhet ta heq mendjen nga kjo, mendoi. Qyshse kishte daië nga qyteti, i qe dukur se sytë po ia vishte prapë një perde e hollë. Mirëpo ajo paskësh qenë në fushë dhe jo në retinën e tij. I gjallëruar ai nisi të vërshëllejë lehtë.

— Bukur, ë? — tha pas pak. — Më duket se sot po i hyjmë tamam aventurës.

Maksi tundi kokën gëzueshëm.

Mbi ca mullarë të lagur të përgjysmuar vërtiteshin zogj të zinj, me krahët që u duke-shin të rënduar nga pikëzat e shiut.

— Sa më larg të jetë hani, aq më mirë është, — tha Vili. — Do të punojmë të qetë. Përndryshe do të na duhet të shpenzojmë pjesë të kohës me ata që quhen elitë e qytetit.

— Kam frikë se do të na gjejnë gjer atje.

— A thua? Atëherë do të na duhet të bëhem pak të pasjellshëm.

— Një fjalë goje, — tha Maksi. — Përku-ndrazi, mendoj se duhet të jemi tepër të kuj-desshëm me ta. Mund të na sjellin vështirësi.

— Ndoshta do të na duhet t'ua shpjegojmë disi më hollësishëm punën që kemi, në mënyrë që të na lënë të qetë, — tha Vili. — Në fund

të fundit, është diçka në interes të vendit të tyre.

— A thua se e çajnë kokën fort për të?

— Eh, si të thuash. Ndoshta ke të drejtë!... Çdo vend, kur e shikon nga larg, duket sikur gjithë vendësit bëhen copë për të, por, kur afrohesh... Te ne, më duket se ndodh e njëjta gjë. Ja, prapë mullarë.

— Hm, s'kam parë ndonjëherë mullarë që t'u ngjajnë varfanjakëve, — tha Maksi.

— Ndoshta ngaqë janë të përgjysmuar. Është fundi i dimrit. Ku e kishim fjalën?

— Tek elita e qytetit.

— Ah, po. Po u përziem me ta, qaje punën. Më duket se dëgjova të pëshpëritet fjala «ballo».

— Vërtet?

— Maksi qeshi me zë. Një copë herë bënë shaka duke përfytyruar veten në ballo provinciale, pastaj Maksi e ngacmoi shokun përgruan e nënprefektit.

— Më duket se të shikonte me ca sy të émbël.

— A thua? — ia bëri Vili, pa e ndërprerë të qeshurën.

Rrashti i Buallit, Rrashti i Buallit, përsë-riste me vete nën ritmin e zhurmës së rrotave.

Emër i vërtetë hani të vjetër mesjetar. Sa më shumë që zgjaste rruga, aq më tepër ai kishte ndjesinë se po ikte larg rrezikut të brixhit e të ballove. Gropat e udhës, prej të cilave karroca troshitej e gjitha, ndoshta ishin një tjetër mbrojtje prej lojtarëve të provincës. Megjithatë, do të na gjejnë dreqërit, thoshte me vete. Kishte dëgjuar se lojtarët e brixhit, kur u hipte dalldia, bënин me kënaqësi dhjetëra kilometra për të gjetur partnerët.

Karroca po ngadalësonte ecjen dhe ai dëgjoi zërin e Maksit:

— Këtë herë më duket se mbërritëm vërtet.

Hani ishte mu në rrugë. Pa ndaluar mirë karroca, ata panë pullazin e tij të mbuluar me rrasha guri, një si hajat të nxirë veshur me dru dhe portën me kanatet e shkalafitura nga era. Një njeri, me siguri bujtinari, rrinte në këmbë përpara saj.

— Mirë se vini, — përshëndeti. — A jeni për në bujtinë?

— Po, zotni, — iu përgjigj Maksi. — Lajm ju kemi çuar, a e dini?

— Po, po, — tha njeriu. — Ju jeni të huaj, apo jo? Ej, Martin, — thirri ai, duke kthyer kokën prapa. — Eja shpejt e ndihmo zotnijtë.

Një djale i gjatë, nofullan, me ca nallane druri dhe me duar të skuqura, të lagëta, u afrua me një çapitje që zhurma e nallaneve e

bënte të dukej më e shpejtë se ç'ishte në të vërtetë.

— Unë jam bujtinari, — tha njeriu që i kishte pritur. — Shtjefën quhem. Gëzohem që në hanin tim po bujtin mysafirë kaq të rrallë.

— Dukej vërtet i gëzuar, ndërsa cepat e mustaqeve i vareshin si të fyera nga diçka.

— Faleminderit, — thanë gati me një gojë irlandezët. — Kujdes, — ia bëri Maksi duke bërë një hap drejt njeriut me nallane që po bëhej gati të ngrinte njérën nga arkat. — Është e rëndë.

— Hani i Rrafshit të Buallit, — lexoi me zë Vili Nortoni tabelën e llamarinës të mbërthyer shtrembtazi te njëra nga kanatet. — Emër i vjetër fort, zotni, apo jo?

— I vjetër besa, — tha bujtinari. — Kësh-tu mbahet mend brez pas brezi. Thonë se ka gati një mijë vjet që ngrihet këtu.

Maksi lëshoi një vërvhëllimë habie, ndërsa vështronte hatullat e nxira sipër kokave të tyre.

— Dhoma për ju është lart, — vazhdoi buj-tinari. — Besoj se do të jeni të qetë aty për punën tuaj.

Njëri pas tjetrit ata u ngjitën nëpër një shkallë druri që kërciste trembshëm. I zoti i hanit shtyu derën e njërsës prej dy dhomave të vetme të katit.

— Ja, kjo është dhoma për ju, zotërinj.

Mbulesat e shtretërve janë të pastra. Po të döni, mund të ndizni oxhakun.

— Ah, oxhak, okej, — ia bëri Maksi.

— Natën fryn shumë, por, po t'i mbyllni kanatet e drunjta, s'do të ndieni asgjë. Janë prej druri bungu të trashë, s'i shpon as plumbi. Kurse këtu keni kandilet për natën. — Sytë e bujtinarit u kthjellën edhe më, pastaj u rrudhën mendueshëm. — E çuditshme është, por para dy javësh kam parë në ëndërr sikur më erdhën në han dy mysafirë të ndryshëm nga gjithë bujtësit. Ishin hipur mbi kuaj që në vend të jeleve u vareshin në qafë fenerë të shuar... Hair e bëftë zoti, thashë me vete. Dhe ja më lajmëruan se do të vinit ju.

— A bujtin rapsodë në hanin tuaj? — pyeti Vili.

— Rapsodë? — tha bujtinari. — Hm. Sigurisht që po. Megjithëse...

— Çfarë, zotni?

Butjinari hapi krahët me një gjest keqardhjeje.

— Më parë bujtnin më shpesh, tani rrallë e më rrallë.

— Ashtu? — tha Maksi. — Neve ndryshtë na thanë. Në hanin tuaj krejt udhët e rapsodëve kryqëzohen. Kështu na thanë.

— Pikërisht, zotni, — tha bujtinari. — Më bëhet qejfi që e dini. Është tamam ashtu. Ndo-

shta u nguta që fola, veç desha të them se më parë më shumë lahutarë ka pasur.

— Natyrisht, — thanë ata në një gojë.

— E pra. Veç një gjë duhet të dini, zotërinj, — vazhdoi bujtinari me buzëqeshje. — Në qoftë se doni të shihni të atillë, s'ka han tjetër në Shqipëri, veç ndoshta Hani i Dy Robertëve, por që është tepër larg që këndej, ku bujtin ende lahutarët.

— Për këtë punë ne prapë do bisedojmë, — tha Maksi. — Me ta ne punë do të kemi.

— Kur të dëshironi, zotni, — tha bujtinari, duke u hapur vend *njerëzvë që* do sillnin bagazhet.

Në mbarim të asaj dite në zyrën e tij, nën-prefekti, që ishte duke hartuar një relacion për ministrin e Brendshëm, i hidhte herë pas here sytë raportit të spiunit Dullë Baxhaja, lidhur me ditën e parë të dy të huajve në Hanin e Rashtit të Buallit.

Shkruan bukur, qerratai, tha me vete. Spiun, përgjues i thjeshtë është, por shkruan më mirë se reporterët e revistës «Përpjekja shqiptare». Prej kohësh fshehtazi ia kishte zili stilin e të shkruarit Dullë Baxhasë, sidomos fraza të tillë si «pavarësisht se kjo nuk hynte në detyrat e raportuesit» apo fillimet e frazave me

«ndërkaq». Atij vetë «ndërkaq-i» i futej atje ku s'duhej dhe gjithmonë detyrohej ta shuanë më pas gjatë redaktimit të tekstit.

«Me të mbërritur në Hanin e Rrashtbuallit dhe pasi këmbyen disa fjalë me bujtinarin (këtu, megjithëse kjo del jashtë nga detyrat e raportuesit, ai është i detyruar të shënojë se një pjesë e bisedës së bujtinarit dhe pikërisht ajo ku ai i njoftoi ardhësit se i kishte parë nëën-dërr, iu duk hartuesit të këtyre radhëve jo vetëm e pakuptimtë, po krejt e pavend në gojën e një nënshtetasi të mbretërisë sonë që flet më tē huajt), pra, pasi këmbyen fjalët e mësipërmë, tē huajt mbetën më në fund vetëm në dhomën e tyre.»

Nënprefekti i kaloi sytë më poshtë, aty ku Dullë Baxhaja raportonte për hapjen e valixheve dhe sidomos të arkave misterioze ku ishte mbyllur aparati, si dhe qindra, për të mës thënë mijëra skedave, që ata i nxorën me kujdes prej dosjeve. E vërteta është, shkruante më poshtë spiuni, se nuk treguan ndonjë kujdes apo shqetësim për fshehjen e tyre, përkundrazi, një pjesë, kryesisht hartat, i ngjitën nëpër mure me gozhdë, kështu që, pas një çerek ore, krejt muret dhe jo vetëm muret, por edhe ana e prapme e derës u mbuluan prej tyre.

Nënprefekti e kaloi pjesën ku spiuni përshkruante me saktësi provën e aparatit, zërin e të cilit spiuni e dëgjonte për herë të parë në

jetën e tij. Sipas tij, në aparat ata kishin regjistruar zërat e tyre, megjithëse ata dëgjoeshin krejt ndryshe nga zëri natyror i njeriut. Me gjithë këtë ndryshim, vazhdonte Dullë Baxhaja, përvoja e gjatë bëri që raportuesi për asnjë çast të mos dyshonte se ata ishin zërat e tyre dhe të askujt tjetër, sepse, të krahasuar me zërat e tyre natyrorë, ata pësonin pikërisht atë ndryshim që pëson zëri i dikujt kur dëgjohet (përgjohet) prapa një flete llamarine, një zgavre oxhaku apo një muri me qerpiç të pashuvatuar prej kohësh.

Dreq, tha me vete nënprefekti. Dreqi vetë, për nder.

Pjesa e raportit ku spiuni kthehej prapë te hartat e mbërthyera në mure iu duk edhe më e vlefshmja për ta përdorur në relacionin që po i bënte ministrit. «Raportuesi, pasi bëri zhvendosjet e duhura në tavan, — shkruante Dullë Baxhaja, — arriti të shikonte më qartë dhe nga kënde të ndryshme hartat me shënimet e tyre përsipër.»

Nënprefekti iu kthye e iu rikthye disa herë pjesës ku spiuni përshkruante hartat. Sipas Dullë Baxhasë ato u ngjanin hartave të buletineve meteorologjike, ashtu siç i kishte parë dikur ai gjatë së vetmes herë që kishte qenë në aeroport të Tiranës, atëherë, kur, siç mund ta kujtonte zoti nënprefekt, kishte shkuar për të përgjuar nisjen në Maltë të zonjës Maria M. që

dyshohej se kishte vjedhur bashkë me dy ikona të vjetra të Kishës së Madhe të Shkodrës edhe një letër sekrete të monsinjorit S.

I di të gjitha, tha me vete nënprefekti gati me admirim. S'ka gjë që t'i shpëtojë, mjafton ta shikojë vetëm një herë, pale pastaj sikur ta dëgjojë. Atëherë mbaroi, njëqind vjet, dyqind vjet, po të vazhdontejeta njerëzore, Dullë Baxhaja do të kishte gjithçka në kujtesë. Arkiv e shkuar arkivist. Bibliotekë. British Muze apo ç'janë ato të tjerat.

Pra, hartat, sipas përshkrimit të hollësi-shëm të Dullës, kishin mjaft shigjetë, disa në forma rrethore, të tjerat gjysmë të lakuara dhe disa të drejta, tamam si ato që shënojnë shirat dhe erërat në meteorologji. Midis shigjetave, sipër tyre apo poshtë kishte shkronja, shifra apo shkronja dhe shifra bashkë: A. CRB, A4. Në disa nga hartat qenë shënuar vija të tjera që tregonin rrugët dhe qendrat e banuara. Madje në dy prej tyre ishte shënuar kufiri me Jugosllavinë.

Hm, qenka serioze puna, tha me vete nënprefekti. Pëllumbat siç duket nuk po ruhen fare. Ose vazhdojnë të na marrin krejt për budallenj, ose... ose... këtu ka diçka më të thellë.

Më poshtë Dullë Baxhaja jepte të dhëna edhe më interesante. Sipas tij disa nga hartat kishin rrathë të mëdhenj, brenda të cilëve qe

shkruar «Zonë epike A» ose thjesht «Zonë epike» ose «Zonë epike e mirëfilltë», madje kishte dhe «Nënzonë epike» apo «Zonë gjysmepike».

Kjo ishte me të vërtetë kulmi. Nënprefektit i erdhi ta kopjonte krejt atë pjesë të rapportit, por diçka e mbajti. S'ishte vetëm puna e sedrës, në fund të fundit askush s'do ta merrte vesh se ai, nënprefekti i plotfuqishëm i N., po vidhte raportin e një spiuni të thjeshtë, por diçka tjetër, kishte frikë mos bënte ndonjë gafë. Si shumë të hapura ishin faktet, sikur të ishin lënë me qëllim që të binin në sy. Veç në mos ishte prapë kjo, një mënyrë për të hequr dyshimet...

Hm, ia bëri prapë nënprefekti. Një copë herë qëndroi në mëdyshje, me lapsin në dorë. S'do të ishte keq që në relacionin për ministrin të mbante një qëndrim të tillë që, sido që të vinte puna, të mos akuzohej se qe treguar sylesh ndaj të huajve, por as të mos e tepronate me zellin dyshimtar.

Nënprefekti nisi prapë të shkruante dhe, ndërsa shkaraviste mbi frazat e lëna përgjysmë, ndiente prapë ta shponte zilia për Dullë Baxhanë. Sa më shumë që mendohej, aq më tepër zemërohej me vete. Tri herë u përpoq më kot të fuste fjalëzën «ndërkaq», por ajo s'futej që s'futej, rrinte midis të tjera si mish i huaj, gjithsesi e papranueshme, gati qesharake, dhe ai i ra për të tretën herë me laps, thua se po e

kamxhikonte. Eh, murmuriste me vete, një copë spiun dhe të shkruajë më mirë se unë. Po nejse, ngushëlllohej, s'thoshin kot se lulja nganjëherë mbinte mu mbi pleh.

Pas shumë mundimesh arriti më në fund të shkruante një paragraf, ku i shfaqte mendimin ministrit se, duke u nisur nga hartat, nga shigjetat sipër tyre dhe ndërkaq nga interesimi i të huajve për lëvizjen e rapsodëve në krejt Shqipërinë Veriore, mund të dyshohej se të huajt merreshin me veprimitari zbulimi. Se si mendonin të shfrytëzonin rapsodët për këtë (duke çuar apo duke marrë me anë të tyre lajme apo kode të shifruara), kjo mbetej ende për t'u zbërthyer. Tani për tani, sipas udhëzimeve të shkëlqesisë së tij, nënprefekti i kishte mbajtur ata në vëzhgim të paprerë, por (këtu ai i kërkonte falje zotit ministër për ringritjen e këtij problemi) ishte i detyruar të theksonte se përgjimi i tyre s'ishte në të vërtetë veçse një përgjim memec.

Nënprefekti e krahasoi frazën e fundit me tekstin e spiunit dhe gjëzimi i atypëratyshëm që kishte arritur ta hartonte atë shpejt iu zbeh në çast. Fraza me përjashtim të fjalëve «zoti ministër», që në tekstin e spiunit ishin «zoti nënprefekt» ishte krejt e njëllojtë me të. Nënprefekti e kuptoi se përfundimisht ishte bërë rob i stilit të Dullë Baxhasë. Eh, e mori dregi këtë punë, tha me vete i lodhur. Tani e kishte

mendjen në tjetër gjë, t'ia ngrinte edhe një herë ministrit kërkesën për një përgjues që të dinte anglisht, apo të mos e bezdiste më pér këtë? Dy javë më parë në një nga letrat e tij, kur, midis të tjera sh, ai e kishte paraqitur edhe këtë çështje, nga sekretari i ministrit i kishte ardhur një përgjigje e prerë: përgjues me anglisht kishte vetëm dy në kryeqytet, prej të cilëve vetëm njëri mezi i dilte të përgjonte ambasadën angleze, sepse tjetri praktikisht kishte dalë tani pér tani jashtë përdorimit, ngaqë i kishte mbledhur veshi. Në kushte të tilla zoti nënprefekt duhej ta kuptonte se, sado i rëndësishëm të ishte dëgjimi i dy të huajve të tij, nuk mund të dërgohej pér këtë përgjuesi i vetëm me anglisht i kryeqytetit. Sekretari do të përpinqej të gjente një të tillë në ndonjë skaj tjetër të mbretërisë, por ai ishte i detyruar ta informonte qysh tani zotin nënprefekt se kjo nuk ishte një punë e lehtë, ngaqë kohët e fundit qe vështirësuar në përgjithësi puna e përgjuesve, dhe pikërisht pas kontrollit të fundit mjekësor, kontroll që tregoi se një pjesë e tyre prej kohësh nuk dëgjonin mirë, megjithëse e fshihnin këtë gjë.

Nënprefekti vendosi të mos e bezdiste ministrin me këmbënguljen e tij. Dullë Baxhaja do të bënte si të bënte edhe pa gjuhë. Në të vërtetë, po ta kishin lajmëruar disa muaj më parë pér ardhjen e irlandezëve, ai do t'ia kishte

vënë për detyrë Dullës të mësonte pak anglisht, kështu që s'do të detyrohej të lypte përgjues tjetër andej-këtej. Ishte i sigurt se Dulla, i aftë siç qe për çdo gjë, do t'ia dilte mbanë. A nuk kishte arritur ai, për një kohë të shkurtër, të mësonte pakëz latinisht, aq sa i nevojitej për të kuptuar fillimet e bisedës, në kohën që iu desh të përgjonte takimet e ipeshkvit të Shkodrës me famullitarët e nënprefekturës? Dhe fill pas kësaj, a nuk kishte mësuar pothuajse krejt gjuhën e arixhinjve, kur kërkohej një nga kuajt e vjedhur të stallës së mbretit?

Nejse, ia bëri me vete. Ndoshta duhej që atij vetë, prefektit, t'i kishte shkuar ndër mend një gjë e tillë. Megjithëse, ku mund ta dijë njeriu se nga mund t'i vijë i huaji, e ngushëlloi veten pas pak. Ti përgatitesh për anglishten dhe ja, një mëngjes ia mbërrin turku apo japozezi, apo djalli e di kush. Eh, punë e pamundur, besa.

Sytë i shkuan prapë te raporti i Dullë Baxhasë. Fundi i tij qe me të vërtetë një kryeve-për dhe atij po i vinte keq që s'mund ta përdorte dot në relacionin e tij për ministrin. Lidhet me anglishten, dreqi e mori, tha me vete. Megjithatë, sikur të provonte... Sikur, pa e ngritur drejtpërdrejt çështjen e përgjuesit që të dinte anglisht, ta mbyllte relacionin me vështirësitë që paraqiste megjithatë përgjimi shurdhmemec i viktimave, domethënë përgjimi

me sy. Dhe këtu ishte tamam vendi që të kopjonte krejtësisht përsiatjet filozofike të Dullë Baxhasë lidhur me raportin në mes syrit dhe veshit në punën e përgjuesit.

Para se të rimerrte në dorë lapsin, nënprefekti nisi ta lexonte edhe një herë tekstin. Mjeshtër, për nder, mendonte midis frazave, Shekspir, Dante Aligeri. Sepse, siç mund ta dinte zoti nënprefekt, shkruante Dullë Baxhaja, përgjimi është kryesisht arti i veshit. Ndihma që të jep syri në të s'është veçse e dorës së dytë, për të mos thënë e panevojshme. Madje përgjuesit e mëdhenj sytë zakonisht i kanë të dobët, për të mos përmendur rastet kur s'kanë fare.

Djall, murmuriti me vete nënprefekti, djall me brirë. Dhe u vu ta kopjonte.

## V

Ku jam kështu, mendoi. Pse ndodhem këtu? Ca qime e prekën te mjekra, pastaj te hunda, ai hapi sytë i llahtarisor dhe gati klithi tek i pa ashtu të gjata, të kuqërremta, ujk apo ari i fëmijërisë mu pranë fytyrës së tij, por aty për aty erdhi në vete dhe s'bëri tjetër veç shtyu me dorë cepin e flokëses, që gjatë natës i kishte rrëshqitur sipër.

Po gdhinte. Prej njërsës nga dritaret e vogla, kanati i së cilës kishte mbetur gjysmë i hapur, hynte ndriçimi i ditës. Xhami kishte zënë avull dhe, për shkak të tij, irnosja e mëngjesit dukej më e zbutur. Ktheu kokën nga shtrati i Maksit dhe pa se ai po flinte i qetë.

Rrashti i Buallit, mendoi. Ishin vërtet atje, në hanin legjendar të mbuluar me flokëset ball-

kanase, në mëngjesin e hirtë të dimrit. Aventura kishte filluar tamam. Tani edhe po të donin se ndërprisnin dot. Brr, sa ftohtë që bënte! Një ndjenjë hareje, e atij lloji që duket se nxiton edhe më prej së ftohtës, e kapulloi të tërin. Ngadalë, duke u përpjekur të mos bënte zhurmë, u ngrit dhe, duke shkelur kujdeshëm mbi dërrasat që kërcisin, iu afrua dritäres. Një qìell bojë hiri, në mesin e të cilit dukej sikur porsa kishte ndodhur një katastrofë, e mbajti për një kohë të gjatë shikimin e tij.

Nga poshtë vinte një erë kafeje të pjekur. Tamam mëngjes, mendoi ai.

— Mirëmëngjes, — e përshëndeti bujtinari, që i doli papritur përpara. — A fjetët mirë. zotni?

— Mirëmëngjes, — u përgjigj Vili. — Mirë fort kam fjetur, faleminderit.

Duke dalë, Vili pa djathtas tij një kthinë të madhe me shumë shtretër druri, pothuajse ngjitur me njëri-tjetrin. Shumica ishin bosh, veç në dy-tre prej tyre dukeshin bujtësit të mbledhur me velenxa.

— Është kthina e bujtësve, zotni, — i shpjegoi i zoti i hanit. — Kështu janë hanet, kthinën kryesore e kanë të përbashkët, veç një ose dy dhoma të veçanta kanë, për raste të rralla, si juaji. Njerëzit janë të varfër, zotni.

— Ah, po, kuptoj.

Pas disa minutash ndodhej krejt i vetëm

në rrugën përmes fushës. Kaçubat nga të dy anët e saj ishin të mbuluara me brymë. Ca gjerdhe, që i përkisnin ndoshta truallit të hanit, mbetën pas edhe ato, për ta lënë fare të qetë në atë vetmi. Një qetësi e tillë, mendoi ai. Ishte pak të thoshe ashtu. Nuk ishte thjesht qetësi. Bryma kishte një kërcitje të tillë, që e theksonte edhe më shumë heshtjen. Dhe nuk ishte thjesht prej hapave të tij. Do të besoje më tepër se ishte një lëvizje e padukshme, që e shkaktonin, ndoshta, ca personazhe ëndrrash të njerëzve të fjetur të ndryshëm, që kushedi pse kishin zgjedhur atë fushëtirë për bëmat e tyre të palidhura.

Vili Norton iu duk befas e mundshme në atë çast mëngjesi. Atij iu duk e mundshme të merrte pjesë në punët e mëdha të botës, në riprojektimin e ditëve, në korrigjimin e stinëve, madje të ndreqte diçka në rrotullimin e globit tokësor. Ai do ta zbulonte patjetër misterin e poemave homerike.

Nuk e kuptoi sa eci ashtu. Kur ktheu kokën, ndërtesa e hanit mezi dallohej larg. Maksi do të jetë zgjuar, mendoi. Kur mbërriti në han, Maksi qe zgjuar vërtet dhe po pinte kafe me bujtinarin.

Pasi hëngrën mëngjesin, dolën të dy në po atë drejtim nga kishte shëtitur Vili. Ishte po

ajo qetësi si një orë më parë, por Vili e ndiente se përndezja e pakmëparshme brenda tij kish-te rënë. Skajet e fushës ishin mbytur në mje-gull. Prej saj, si prej një bote tjeter, dilnin herë pas here ca zogj të zez, që, pasi fluturonin ulët mbi fushë, treteshin prapë si shpirtra. Dy-tri herë iu duk se dalluan Bjeshkët e Nemuna prapa mjegullës, por nuk ishin të sigurt.

— Ato duhet të duken që këndej në një ditë të zakonshme, — tha Maksi.

Kishin biseduar kaq herë për to në Nju-Jork, pastaj gjatë rrugës dhe tanë nuk u duro-hej sa t'i shihnin. Në projektet e tyre të para kishin menduar që ta nisnin punën drejtpërdrejt me shtegtimin nëpër to, por pastaj, pasi kishin marrë të dhëna për dimrin e ashpër, rru-gët e pakalueshme dhe kushtet e tjera të vë-shtira, kishin ndërruar mendim. Ndoshta në mes të verës do të mundnin të bënin ndonjë udhëtim, në qoftë se një gjë e tillë do të ishte e nevojshme. Por të gjithë ata që kishin njojur pak a shumë Shqipërinë Veriore kishin ngulur këmbë se ata do të mundnin të takonin më te-për rapsodë në një kryqëzim udhësh, siç qe Hanni i Rrashtbuallit, sesa në ato pak katunde që do t'u rastisnin udhës gjatë shtegtimit të tyre.

Një natë më parë bujtinari i kishte sigu-ruar se së paku dy herë në muajin në hanin e tij bujtnin lahutarë. Më parë ishte ndryshe, kish-te psherëtirë ai. I kishte këtu pothuajse për-

natë, por me sa dukej ajo kohë s'kthehej më. Por ata s'duhej të mërziteshin. Do të takonin syresh gjithsesi.

Ndonëse kishin vendosur ta ruanin gjer në fund sekretin, ata e kuptuan se ishte e pamundur që të mos i hapeshin bujtinarit. Veç kësaj, edhe sikur ajo që po bënин të merrej vesh anembanë tani, ishte e pamundur që rivalët e tyre të mundshëm t'i ndiqnin pas. Ata ishin së paku gjashtë muaj vonë.

Pa e zgjatur më qenë përpjekur t'ia shpjegonin sa më qartë bujtinarit gjithçka.

Ju kuptova, zotërinj, thoshte Shtjefni, duke tundur kokën me po atë mënyrë siç bënte kur ata porositnin një kafe. Ju kuptova krejt, zotërinj. Hani im qenkësh si i krijuar enkas për një gjë të tillë. Sidomos për atë punën e dëgjimit dy herë të të njëjtit rapsod. Një lahutar që bujt sonte këtu, do të bujtë prapë pas një javë, e shumta dy, kur të kthehet nga dasma, nga morti apo nga vrasja që porsa ka kryer. Udhë tjetër për t'u kthyer në Rrafsh nuk ka. Veç në fluturoftë. Por në dimër as zogjtë s'fluturojnë dot mbi Bjeshkët e Nemuna.

I vetmi shqetësim që kishte shprehur bujtinari ishte nëse rapsodët do të pranonin të këndonin përpara aparatit. U kishte shpjeguar se asnjë lahutar nuk këndonte pa njëfarë ceremoniali dhe pa një grumbull dëgjuesish. Por ata s'duhej të mërziteshin as për këtë. Qëllonte

që në hanin e tij sidomos gjatë mbrëmjeve të dimrit krijohej një atmosferë e vërtetë kremtare. Ai do të bënte çmos për këtë. Do të ndizte në kthinën e përbashkët oxhakun e madh, do t'i gostiste bujtësit me nga një gotë raki. Sa për aparatin e regjistrimit, do të shihnin e do të bënин. Ndoshta mund t'ua shpjegonin lahutarëve si qe puna, e ndoshta mund të gjenin rrugën më të thjeshtë: ta mbulonin me një lëkurë deleje që të mos dukej. Për perëndi, gjithçka do të vejë si jo më mirë.

Ndërsa ecnin, ata i risillnin ndër mend të gjitha këto. Në të vërtetë as që mund të ëndërronin të ndeshnin në një bujtinar më të përshtatshëm. Ishte i pasionuar pas lahutarëve dhe i njihte mirë të gjitha zakonet, trillet dhe lëvizjet e tyre. Ishte tamam një enciklopedi e tyre. Veç kësaj fliste për ta me një lloj admirimi përzier me mallëngjim. Kur vinte fjala përrallimin e tyre edhe më të madh në ndonjë stinë të vitit apo shpeshimin e përkohshëm në një stinë tjetër, e folura e tij i ngjante asaj të njeriut që flet për shtegtimin e zogjve. Madje dhe fjalët që zgjidhët ashtu ishin, të brishta, plot prapashtesa përkëdhelëse, në fund të të cilave kishe dëshirë të psherëtije. Kishin pasur në të vërtetë fat që kishin rënë në një bujtinar të tillë.

Ndërsa bisedonin, ata ngrinin kokën herë pas here, sikur të kishin shpresë se bjeshkët do

të shfaqeshin më në fund në horizont, por mjegulla, njëlloj si më parë, mbulonte anët e rrafshnaltës. Megjithatë ndihej prapa saj pesha e rrafshit të madh, që niste diku, aty pranë. Ajo ishte zona e madhe epike, për hir të së cilës ata kishin kapërcyer oqeanin. Prapa mjegullës duhej të ishte fshehur misteri homerik, të cilin ata do të rrihnin ta zbulonin. Ndryshe nga një orë më parë, tanë Vili nuk besonte aq shumë më në atë zbulim. Të vegjël e të pafuqishëm do të vërtiteshin ndoshta në tangenten e asaj mbretërie fantazmash, pa depërtuar dot në të. Me zor ai mbyti një psherëtimë.

— Shiko aty, — tha papritur Maksi, — janë njerëz apo më bëjnë sytë?

— Mua më pyet? — tha Vili. — Ti e di që unë...

Maksi vuri dorën në ballë për të parë më mirë.

— Njerëz, — tha. — Është gjëja më e natyrshme, megjithatë s'di si m'u duk.

Vili mendoi se siç dukej as ai s'e priste që nga kjo mjegull përpërëse të mundte të dilte diçka. Megjithatë, pikat e vogla të zeza, që kishin kapërcyer kufijtë e dy realiteteve, po aviteshin vërtet drejt tyre. Nga tronditja që ndienin, ata e kuptuan papritur e pa e ditur as vetë, sepse kishin dyshuar se në ato bjeshkë kishte ende njerëz, e aq më pak epe që këndoheshin ende si dikur. Edhe në qoftë se kishte, ishin me

siguri gjysmë tē ngrirë, tē ftohtë si njeriu që po jep shpirt, dhe çdo dimër mund tē ishte i fundit pér ta dhe ata duhej tē shpejtonin, tē shpejtonin pér tē arritur me kohë, që, së paku, nè grahmën e fundit t'u shkëputnin enigmën.

Ia kishin fshehur njëri-tjetrit dyshimet pér tē mos e ligështuar shoku-shokun nè çastet e dëshpërimit, kur pengesat grumbulloheshin njëra pas tjetrës sikur ta kishin bërë me fjalë që kurrsesi tē mos i linin tē niseshin pér nè Shqipëri. Por ata e kishin kapërcyer ligështimin dhe ja tani, si shpërblim pér durimin e tyre, bjeshka u kishte nxjerrë ato krijesa tē gjalla që po ecnin drejt tyre. Pothuajse nuk këmbyen fjalë me njëri-tjetrin, gjersa malësorët u afroan. Ishte hera e parë që takonin malësorë tē zonës së mirëfilltë epike. Veshjet ishin po ato, siç pëershkrueshin nè eposin e lashtë, dhe ata gati sa s'thirrën: është vallë e mundur që ata tē mos kishin ndryshuar pas një mijë vjetësh? Xhoket e zeza kishin te supet ca si flatra tē prera, apo tē parritura, që tē rrëqethnin. Ishte atje kufiri midis njeriut dhe hyjit, ndarja apo pikëtakimi tragjik, këtë mund ta merrje si tē doje. Në epos flitej pér ta, madje ishte dhe fjala e vjetër shqipe «hyjanjeri», ndoshta e pagjendur nè gjuhë tjetër, në mos nè greqishten e lashtë. Nën xhoken e zezë tirqet e malësorëve ishin ngjyrë qumështi, me një vijë tē zezë midis që i ngjante shenjës së rrezikut nga ko-

rrrenti. Ishte një veshje që atyre iu duk e pa-njashme me asgjë, ku takohej kostumi i balle-rinit që parandien në skenë të keqen, me murgun e kushedi ç'urdhri mesjetar. Kishte në të një ndriçim ilir, përzier me një zi ballkanase dhe diçka tjetër, që atyre iu duk si prej malë-sorësh keltë, apo banorë malesh prej akujsh që s'gjenden në asnjë hartë të globit.

— Druvarë, — tha me zë të ulët Maksi, kur pas shpinës së malësorëve u dukën tehet e së-patave.

Ishin pa dyshim druvarë, aq më tepër që ata e dinin tashmë se për shkak të kanunit që lejonte vetëm vrasjen me armë zjarri, shqiptarët nuk përdornin armët e ftohta. Pa dyshim, druvarë, përsëriti me vete Vili Norton. Megji-thatë, ndihej se ato tehe sëpatash mund të përgjakeshin lehtë prej gjaku të çngjyrosur krimesh të vjetra.

Malësorët po afroheshin. Në siluetat e tyre kishte diçka nga vizatimet e vazove antike. Dhe e papritura dhe nyjat tragjike të fatit që mbli-dhen befas dhe ai peng që shkakton te njeriu vonesa që u bë, dhe që do të shmangete goditjen fatale, ose shpejtimi i kotë që çoi në humbje, të gjitha këto spikatnë në atë ecje që ndoshta rregullat e kanunit e kishin stilizuar, duke e bërë disi të ndryshme nga ecja normale.

— Mirëdita, — përshëndeti malësori i parë. Kaq e papritur që kjo, sa ata e humbën.

Vili murmuriti diçka midis «Morning» dhe «Mreditës», kurse Maksi përshëndeti me dorë.

Pas një copë here, kur kthyen kokën, panë se ishin larguar aq shumë, saqë hani nuk dukej më. Gjatë udhës së kthimit dy-tri herë thanë se duhej të nisnin sa më parë nga puna. Qysh të nesërmen, në qoftë se do të shfaqej ndonjë rapsod, madje qysh atë mbrëmje.

Në han ishte qetësi. Ata u ngjitën në dhomë dhe hapën prapë arkat për të nxjerrë që andej skeda dhe harta të tjera. Kishte mbetur një vend sipër oxhakut ku mund t'i ngjitnin, po ashtu midis dy dritareve.

— Ka minj këtu? — tha papritur Maksi, duke ngritur kokën drejt tavanit.

Vili, që ishte duke ngjitur një hartë të Gadhullit Ballkanik mbi oxhak, ngriti dhe ai kokën.

— S'e besoj.

Ai vazhdonte të vështronte hartën ku vargmalet u ngjanin brinjëve të kuajve të rrëzuar në drejtime të ndryshme në sheshin e një thoreje. Sipër tyre ishin shkronjat «Shqipëria Veriore», «Rrafshi», «Kosova», «Serbia e vjetër».

Gjatë më shumë se një mijë vjetëve shqiptarë e sillavë ishin përgjakur këtu pambarimi. Ndesheshin për gjithçka; për tokat, për kufijtë, për livadhet, ujvarat, s'do të ishte çudi që edhe për ylberet në qiell. E, si të mos mjaf-

tonte kjo, grindeshin edhe për epòsin e lashtë, që, si për ta plotësuar fatalitetin e gjëravë, ekzistonte në të dy gjuhët: shqip dhe serbo-kroatish. Dhe secili popull ngulte këmbë që krijuesi i eposit ishte ai, kështu që tjetrit s'i mbetëj veç të ishte grabitësi ose, në rastin më të mirë, imituesi i tij.

— Të ka shkuar ndër mend se, duke u marrë me Homerin, ne jemi futur padashur në këtë sherr? — tha Vili, pa i hequr sytë nga harta.

— A thuá?

— Është pothuajse e pashmangshme. Brumi homerik i eposit të tyre, që ne po përpinqemi ta vërtetojmë, lidhet vetveti me vjetërsinë e shqiptarëve në gadishull. Mirëpo është pikërisht kjo vjetërsi që shkakton xhelozinë e serbëve.

— Hm, xhelazi, — murmuriti Maksi. Ske-nat e fundit me gruan në Nju-Jork kishin qenë me të vërtetë sfilitëse. Ik, thyej qafën me ndonjë dashnore ku të duash. Iknitë dy bashkë me atë kurvarin, Vili Nortonin, veç mos shpikni gjithfarë studimesh homerike e dokrra të tillë. Nuk e kuptioni që jeni bërë qesharakë që të dy?

— Ti më dëgjon? — tha Vili.

— Pa dyshim. E kishe fjalën te xhelozia!

— Pikërisht. Për serbët është e padurueshme të pranojnë se shqiptarët kanë qenë këtu përpara tyre. Mirëpo kjo gjë, nga një çështje

grenarie kombëtare që duhet thënë se te të gjithë ballkanasit merr njyri me më të sëmurat e grotesket, shndërrohet në një problem konkret politik kur vjen puna për Kosovën.

— E qartë, — e ndërpren Maksi, që përpinqej vërtet ta hiqte nga grindja me të shoqen.  
— Shqiptarët u thonë serbëve: ne kemi qenë këtu gjithmonë. Serbët përgjigjen: ju keni ardhur pas nesh.

— Pikërisht, — tha Vili. — Po ka një pyetje të shqiptarëve që është e vështirë të kundërshtohet: në qoftë se në Kosovë nuk kemi qenë ne, atëherë kush ka qenë? Fantazmat?

— Hm, — ia bëri Maksi. — Më duket se janë gjetur të tilla. S'më kujtohet ku, por kam lexuar për ca avarë, ostrogotë, madje keltë që kanë qenë këtu.

— Ata mund të kenë kaluar, — tha Vili,  
— pak lëvizje popujsh e hordhish ka pasur në këto anë?

— Sidoqoftë ti ke të drejtë, — tha Maksi.  
— Ne iemi futur tashmë në sherr.

Ai u përpoq të queshte.

Vili vazhdonte të qëndronte përpara hartës. Vështrimin e kishte të turbullt.

— Një mijë vjet luftë, — tha mendueshëm.  
— Tepër gjatë, apo jo?

— Tepër. Veç ajo e polli edhe eposin e tyre, — tha Maksi duke kthyer kokën nga arkat metalike. — Ai kullon gjak.

Ata i mbajtën sytë një grimë mbi rrëzë-limin e ftohtë të metalit bojë hiri. Gjithë atë epos të shpërndarë nëpër hapësirën e Rrafshit ata do të përpinqeshin ta mbledhnin në ato arka metalike.

— Gjermanët e kanë quajtur luftë racash,  
— tha Maksi. — Madje kanë përcaktuar edhe racën superiore, që, sipas tyre, është ajo shqiptare.

— Që ka qenë një ndeshje e lemerishme, e pranoj, — tha Vili. — Por, kur dëgjoj që përmenden fjalët racë, e sidomos racë superiore e inferiore, më kap dëshpërimi. Mban erë nazizëm.

— Një shpjegim i tillë është i modës tani.  
Pasoi një heshtje e gjatë.

— Eposin kanë dashur t'ua vjedhin, — tha Vili, duke i kthyer krahët hartës.

— Natyrisht, — tha Maksi, — shtëpia vidxhet me gjithë brilantë.

— Kullon vërtet gjak ai epos, — tha Vili, pa i hequr sytë nga arkat, sikur eposi të ishte ndërkaq aty dhe nga çasti në çast gjaku mund të pikonte jashtë si nga ena e mbushur.

— Ftohtë, — tha Maksi duke hukatur duart. Ai i la skedat dhe hodhi krahëve velen-xën. Pas pak edhe Vili bëri të njëjtën gjë. Nga e ftohta ndienin t'u afrohej dremitja.

Mbështetur përgjysmë te nënkesa, Vili përpiquej të përfytyronte ardhjen e parë të slla-

vëve në Ballkan. Në epos flitej herë pas here për këtë, si ata dyndeshin të panumërt nga verilindja, nga lindja dhe si nën shytjen e tyre popujt e moçëm të gadishullit tërhiqeshin nga dalë kilometër pas kilometri. Vala sllave dukej e pafundme dhe ndryshe nga pushtimi romak, ajo dyndje ishte pa ushtri, traktate, flamurë. Ishte një lëvizje e pambarim grash, fëmijësh, belbëzimesh, pa urdhra, monumente, më tepër e ngjashme me një fatkeqësi natyrore, sesa me një pushtim. Kjo duhej të ishte trauma më e madhe për ballkanasit e moçëm, sidomos për shqiptarët. Përpara tyre ishte tani oqeani sllav, i cili, i pafund siç qe, i hirtë euroaziatik dhe anonim, rrezikonte ta shpëlante truallin më artistik të botës. Atëherë ndodhi ajo që duhej të ndodhë: vendësit këmbyen armët duke përgjakur skajet e oqeanit. Dyndja qe ndërprerë pikërisht diku pranë Kosovës.

Te dera e dhomës trokitën.

— Hyr! — tha Maksi.

Ishte Shtjefni me një krah dru në duar.

— Doni t'ju ndez oxhakun? — pyeti ai. —

Sot është shumë ftohtë.

— O, faleminderit, faleminderit. Përurrejtjen flisnim serb-shqiptarë. Është aq siç thonë vërtet?

— Oh, ndoshta më tepër, — tha Shtjefni, duke hedhur drutë në vatër. — E dini ç'ka

shkruar një poet shqiptar? «N'mëni të sho-shoqit kemi le.»

— Një poet ka shkruar kështu?

— Po, zotni, — u përgjigj bujtinari.

— «N'mëni të sho-shoqit kemi le», — përsëriti Vili. — Prapë fjala «mëni» si te fillimi i Iliadës.

Ata kujtuan një copë herë ambasadorin shqiptar në Uashington.

— Ka minj këtu? — pyeti papritur Maksi.

— Dy herë m'u duk ashtu.

Bujtinari bëri «jo» me kokë.

— Krejt hanin e kam dezinfektuar enkas për ju, zotérinj, — tha ai.

Zjarri u ndez shpejt. Shtjefni doli dhe ata vazhduan bisedën, herë duke ecur nëpër dhomë e herë duke qëndruar të dy në këmbë përpëra oxhakut me pëllëmbët e duarve të zgjatura drejt tij.

Gjithë pasdreken u morën me sistemimin e skedave. Përjashta drita e ditës firohej me shpejtësi dhe erdhi një çast kur fjalët u rraluan dhe ata e ndien veten krejt të vetmuar në pasditen e dimrit, në hanin e harruar midis shurdhimit. Kështu do të rridhnin vallë ditët e tyre?

Maksi, i pari, duke u shkundur nga mpirja, u kujtua të ndizte llambën me vajguri, drita e së cilës e shtyu përjashta dhomës atë hirnosje muzgu që, si një maskë mortare, kishte veshur botën.

## VI

Rapsodi i parë bujti nē han pas katër ditësh. Ishte kohë e keqe, era e përzier me shi i bënte tē kërcitnin monotonisht kanatet e drunjta, saqë edhe trokitjen e Shtjefnit ata e morën për goditje tē saj.

Kur ai u shfaq te pragu, nga ftyra e tij e kuptuan se ajo që prisnin kishte ndodhur.

— Eshtë poshtë, — thoshte Shtjefni me zë tē ulët, sikur tē tregonte një tē fshehtë, — dhe, veç kësaj, bisedova me tē. Eshtë tip i vështirë, si gjithë lahutarët, megjithatë kam shpresë se do tē pranojë, veç do tē ishte mirë ta takoni edhe ju.

Ata u ngritën nē çast dhe, ende pa e marrë veten, ashtu, tē hutuar siç ishin nga lajmi, nisën tē zbritnin shkallët pas bujtinarit Shtjef-

ni kthente kokën herë pas here për t'u dhënë ndonjë shpjegim. Rapsodi udhëtonte për punë të veta në një krahinë tjetër. Ai do të kthehej po nga kjo udhë pas dy javësh. Kështu që ishte tamam rasti që donin ata, në qoftë se ai i kishte kuptuar drejt, pra, tamam rasti për ta regjistruar dy herë të njëjtin lahutar. Ata pohonin me kokë, herë njëri, herë tjetri, pa u përendruar në fjalët e tij. Natyrish që ishte ashtu, një rast i mrekullueshëm vërtet. Po, mbi të gjitha, kryesorja ishte që ai kishte pranuar. Apo ende lëkundej?

— Eh, ashtu, kishte ndër mend të nisej, por ia mbusha mendjen të rrjë, — shpjegoi Shtjefni. — Kohë e keqe, i thashë, vonë është, më beso, s'e bëj për ndonjë fitim, besa të mbaj në han pa pare, veç një lutje kam, dhe i fola për ju.

— Ashtu... Dhe pranoi?

— Pothuajse. Ja tani do ta shohim.

Në kthinën e përbashkët të katit përdhes kishte disa malësorë të lagur. Përpara se të kuptionin cili prej tyre qe rapsodi, ata panë lahutën të mbështetur te muri. Pastaj Shtjefni preku te supi (tamam te rrëza e flatrës së prerë të xhokes) njërin prej malësorëve, që u kthye drejt tyre. Marrëveshja u bë në këmbë shpejt e shpejt. Rapsodi i vështroi të huajt një copë herë të gjatë, sikur të donte të bindej përdicë. Ata rrallë kishin ndeshur sy të tillë, ngjy-

ra e çelët e të cilëve, me një plasaritje si ajo e qelqit që ka marrë krismë, ia dyfishonte fuqinë zhbiruese. Bujtinari vazhdonte ende t'i shpjegonte diçka, por që rapsodi s'e dëgjonte. Ai uli papritur kokën për të thënë «po». Sipas zakonit të lashtë, nuk pranoi shpërblim, u la vetëm të nënkuptohej se ai nuk do të paguante atë natë fjetjen në han. Irlandezët ishin të lumtur. Ata ishin gati për shumë më tepër, por Shtjefni u bëri shenjë me sy të mos e zgjatnin për të mos e prishur punën krejt.

Menjëherë u ngjitën lart të tre, bashkë me Martinin, për të zbritur aparatin. Sipas zakonit rapsodi do të këndonte në kthinën e madhe, në prani të gjithë bujtësve. Ndërsa hipën në dhomë, Vili vuri re se dera e dhomës tjetër, që ishte hapur pak, u mbyll ngadalë.

— Ka bujtës këtu? — pyeti ai. — S'e kemi parë kurrë.

— Hm, — ia bëri Shtjefni duke ulur zërin, — është një bujtës pak i çuditshëm. Rri mbyllur brenda gjithë ditën, edhe ushqimin e kërkon aty.

— Çfarë? — pyeti Maksi.

— Asgjë, — tha Vili, — gjëra pa rëndësi. Në hotelet tonë ka plot të tillë, — i tha ai Shtjefnit.

Zbritja e apparatit, ashtu si ngjitja, u bë gjithë zhurmë. Në katin përdhes malësorët vështronin gjithë kureshtje arkat metalike.

— Kujdes, — thoshte herë pas herë Martini duke vënë duart sipër aparatit, — mos e prekni. Madje mos u afroni fare. I keni rrobat të lagura dhe lagështira atij i bën dëm.

Me faqe ende të skuqura nga mundi i zbritjes, dukej menjëherë që ishte krenar që i besonin aparatin.

Ishte ngrysur dhe Shtjefni kishte ndezur llambën e madhe me vajguri, atë që e përdorte në raste të rralla si ky. Në han ishte kriuar një atmosferë e veçantë si prej të kremteje. Vetëm rapsodi, i ndërgjegjshëm për rolin e tij të veçantë, rrinte mënjanë duke kundruar qetësisht aparatin. Vili, që e përvidhë herë pas here me sy, përpiquej të merrte me mend se ç'ndjenja mund të zgjonte aparati modern te rapsodi, hutim, frikë. apo ndjesi mëkatë ndaj paraardhësve të tij, lahutarëve të mëçëm. Dhe në të vërtetë. mendoi ai, prapa pamjes së qetë të rapsodit duhej të kishte një trazim të madh. Ishte hera e parë që zëri i tij e i lahutës nuk do të shpérndaheshin në pafundësi, siç kishte ndodhur në shekuj, por do të mblidheshin në atë arkë metalike, ashtu siç mblidhet ujet në bucelë, si... Papritur ai pati frikë se mos rapsodit i kthehej mendja.

— Të fillojmë, — i pëshpëriti Maksit, — s'ka pse ta zgjatim më.

Maksi bëri «po» me kokë, pastaj me buzëqeshje e ftoi rapsodin të afrohej. Veprimet

e tjera, provat për rrrotullimin e bobinës, sidomos vendosja e mikrofonit përparrë lahatarit, u bënë midis heshtjes së plotë të të pranishmëve. Ata kishin zënë vend në formë gjysmërrethi, shumica të ulur drejt e në dysheme dhe vazhdonin të ishin aq të heshtur, saqë, kur Vili tha «qetësi, ju lutem», e kuptoi se ato fjalë ishin të tepërtë.

— Filloni, — i tha Maksi rapsodit duke i buzëqeshur.

Më në fund tingulli i lahatës e mbuloi zhurmën e lehtë të aparatit. Ai tingull kishte një monotonji të tillë sikur të ftonte në një ëndërr kapitëse për të mos të lënë të dilje më. Vili me Maksin vështruan njëri-tjetrin. Lahutari nisi të këndonte me një zë që s'kishte asgjë të përbashkët me zërin me të cilin gjer atëherë kishte folur. Ishte një zë i panatyrshëm, me një lëmim të ftohtë, që të fuste ankthin, si i ardhur nga një tjetër botë. Vilit iu rrëqeth shtati. Disa herë ai u përpoq të merrte vesh tekstin, por lëmimi i zërit të lahatarit s'e linte. Vili ndiente një zgavrim brenda tij. Kishte ndjesinë se diçka po i hiqej, i hiqej pa pushim prej vetes, sikur të ishte një lëmsh që i nduknin fijen. Zëri i lahatarit kishte aftësinë të të zbrazte. Edhe pak dhe gjithë ai grumbull njërezish do të mund të fikoj mu përparrë syvetë njëri-tjetrit. Por lahatari ndaloi përparrë shuarjet.

Në heshtjen që u krijuar befas u dëgjua prapë zhurma e lehtë e aparatit dhe Maksi u kujtua i pari të shtypte njërën nga sustat.

Atëherë gjithë ai grumbull njerëzish u gjallërua papritur si i çmagjepsur. Nga të gjitha anët i vinin urime lahutarit. Vili me Makzin thanë dhe ata «faleminderit» e tyre, por ai tingëlloi i dobët dhe pa forcë midis urimeve që ishin të gjitha formulime të vjetra, të ngjashme me frazat e shenja.

Kur Maksi ktheu bobinat mbrapsht, bujtinari, që, siç duket, kujtoi se ai po e mbyllte aparatin, i tha te supi:

— Ai do të këndojë prapë.

Maksi i bëri shenjë me kokë se e kuptoi.

— Do të provoj regjistrimin, — tha.

Ai shtypi disa herë butonat dhe befas nga aparati u dëgjua prapë, pak më gjëmueshëm se më parë, zëri i rapsodit. Të gjithë përreth mbetën të ngrirë. Njeriu ishte aty, me gojë të mbyllur, bashkë me lahutën e heshtur, kurse zëri i tij dhe tingulli i saj vazhdonin të dëgjo-heshin prapë. Ishte vërtet i pabesueshëm ky dyzim. Kishte diçka tronditëse në shkëputjen e një pjese të njeriut dhe në daljen e saj prej tij, për të gjalluar vecmas, në mënyrë të pavarur.

Qenë grumbulluar të gjithë rreth aparatit dhe vështronin habitshëm rrötullimin e dy rrathëve metalikë që u ngjanin mokrave të vogla. Sytë e tyre ishin plot pyetje, që ata s'guxonin

t'i bënin. Pra, zëri ishte mbyllur tashmë në arkë, por në ç'formë kishte zënë vend aty brenda?

Pas një pushimi të shkurtër rapsodi këndoi epin e dytë.

— A nuk përzihen aty? — pyeti më në fund njëri nga bujtësit, duke treguar me dorë aparatin.

Vili mezi e mbajti të qeshurën.

Ishte vonë kur ata e mbyllën magnetofonin dhe e falënderuan lahutarin.

— Pas dy javësh, — i përsëriste Shtjefni rapsodit, — kur të kalosh këndeja, a do të këndosh prapë të njëjtat epe? Siç të thashë, kështu e kanë punën ata, duan të bëjnë krahasime e ku di unë çfarë. Po ti më ke dhënë fjalën, o burrë, mos më korit.

— S'të koris, jo, — tha i ngrysur rapsodi.

Vili me Maksin dëgjonin në këmbë me një buzëqeshje të mbetur në fytyrë. Kishin një sindjenjë faji dhe do të donin të jepnin një shpjegim tjeter, por e kishin të vështirë.

— Po zëri rri aty dy javë? — pyeti një malësor i ri. — Nuk prishet?

— Jo, — u përgjigj Vili. — Mund të rrrijë me muaj, me vite.

Me vështrim të ngulët lahutari shikonte arkën e aparatit. Vilit iu duk se pa një dritë të turbullt në sytë e tij. Po sikur të pendohet, mendoi me frikë. Sikur t'i dukej si shenjë e

keqe që po e linte zërin e tij të zënë si në grackë në atë kuti?

Të huajt u thanë natën e mirë të gjithëve dhe u ngjitën lart. Shtjefni e shoi llambën e vajgurit dhe kthina e madhe e përbashkët u zhyt në terr. Në shtratin e tij Vilit i dukej se e ndiente të ngjitej që poshtë shqetësimin e gjumit të mundimshëm të bujtësve. Nesër, tha ai me vete, si të donte edhe vetë të sillte ndër mend diçka më të logjikshme e më me dritë për të kundërshtuar një dritë primitive që s'dinte as vetë nga i vinte. Nesër do të kemi aq punë, o perëndi, psherëtiu duke u mbështjellë me velenxë.

Vili disa herë u zgjua duke kujtar se kishte gdhirë, por mëngjesi, në vend që të afrohej, dukej sikur largohej më tej. Kur i doli gjumi për herë të fundit, ai pa se ishte vonë. E kishte vënë re se kështu i ndodhët gjithmonë, sa herë që priste me padurim mëngjesin. Mak-sit, që u zgjua fill pas tij, i kishte ndodhur e njëjtë gjë.

Kur zbritën poshtë, për habinë e tyre, kthina e madhe e hanit qe e boshatisur.

— Kanë ikur, — tha Shtjefni, që e kuptoi habinë e tyre. — Malësorët çohen herët. — Nga dera gjysmë e hapur dukej qielli i nxirë i

rënduar nga shiu. — Dhe ta mendosh, në një kohë të tillë, — vazhdoi ai.

U dëgjua zhurma e nallaneve të Martinit, pastaj nga dera e prapme hyri ai vetë me dy kova me ujë në duar.

— Mirëmëngjesi, — tha.

— Mirëmëngjesi, Martin, si fjete? — tha Maksi.

— Hm, disi. Kisha merak atë, ap... apartin...

— E pse? — pyeti Vili.

— Eh, si ta them, — belbëzoi Martini. — Çdo gjë mund të ndodhë, zotni.

Në sytë e tij ndihej një frikë e turbullt dhe Vilit iu kujtua nata që porsa kishin kaluar, me ankthin që dukej sikur ngjitej që poshtë si nga një mijëvjeçar tjetër.

### 27 *shkurt, bujtina «Rrashti i buallit»*

Sot ishte dita e parë e punës sonë të vërtetë për enigmën homerike.

Dëgjuam disa herë rresht të dy epet e dëgjuara nga rapsodi. Janë afërsisht nga një mijë vargje secili.

Njëri prej tyre gjendet i botuar në «Visaret e kombit». Bëmë krahasime me të. Ka mjaft ndryshime.

Ai është epi i pabesisë së Ajkunës, gruas së kreshnikut Mujs. Prej gjermanëve është quajtur një lloj Helene e Trojës e eposit shqiptar. Veç historia e saj këtu të ngjeth mishtë.

Tjetri duhet të jetë një motërzim i epit për Zukun Flamurtar. Ngjarje më e zymtë është vështirë të përfytyrohet. Motra kërkon nëpër bjeshkë vëllanë e plagosur pér vdekje prej armiqve, si e gjen më në fund të mbytur në gjak; si kërkon ujë i plagosuri, por burimet janë larg dhe ajo ka frikë se, po të shkojë, do të humbasë rrugën e kthimit, si pastaj ai i thotë të njomë një leckë me gjakun e tij dhe ta shtrydhë pikë-pikë udhës që të mundë t'ia gjejë gjurmët në kthim; si ajo bëri ashtu siç i tha i vëllai, por rrugës së kthimit fillon shiu dhe i lan gjurmët e gjakut; si ajo humbet kështu rrugën dhe vërtitet verbtazi nëpër bjeshkë gjersa i dalin përpara një korb e një ari; si korbi i thotë se porsa i ka ngrënë sytë një të plagosuri dhe ariu e ka një pjesë të kokës së tij në bark, si ajo ikën më në fund me ulërimë nëpër bjeshkën plot mjegull.

— Ç'tmerr, — tha Maksi pasi shkelin susten e ndalimit.

Pjesën tjetër të ditës si dhe ditët më pas i kaluam me zbardhjen e epit të dytë.

*Fund i shkurtit, bujtina «Rrashti  
i buallit»*

Presim me padurim, për të mos thënë më një ankth të vërtetë, kthimin e lahutarit.

Ndërkaq vazhdojmë punën tonë. Skeda të pafundme me gjithfarë shënimesh e idesh. Krahasime motërzimesh. Pikëpyetje që kërkojnë përgjigje. Hamendje të gjithfarshme.

Nganjëherë na kap shqetësimi se mos po humbim në universin e eposit, duke harruar qëllimin kryesor për të cilin kemi ardhur këtu. Ne jemi homeristë. E përsëritim çdo diië këtë si për t'i kujtuar vetes se ne nuk kemi ardhur këtu për të studiuar eposin e shqiptarëve, por për enigmën homerike.

Mirëpo, është një fjalë goje të thuash. Eposi të thith, padashur. Veç kësaj çështjet janë të pleksura nganjëherë më keq se rrënjet nën tokë. Ja për shembull, për aventurën e Ajkunës, gruas së Mujsit, kemi gjetur edhe dy motërzime të tjera. Në secilën prej tyre historia e saj shpjegohet në mënyra të ndryshme. E njëjta gjë duhet të ketë ndodhur me rrëmbimin e Helenës në poemat parahomerike, gjersa Homeri vendosi të zgjidhte njérën nga motërzimet.

Që ka pasur më parë disa shpjegime të sjelljes së Helenës, kjo dukej qartë edhe nga

varianti homerik. E gjithë ngjarja e mbretëreshës së rrëmbyer është plot ekuivoke. Shkoi vetë ajo me Paridin apo u rrëmbye me forcë dhe pastaj u dashurua pas tij. Apo ndoshta as më parë as më vonë nuk e deshi rrëmbyesin, por ishte thjesht skllave e princit. Apo përkunddrazi u magjeps në fillim prej tij, pastaj u zhgënje dhe u ftoh, ose e kundërta, ishte ai që, pasi u dashurua në fillim pas saj, u ftoh, gjë e natyrshme në këso rastesh?

Për të gjitha këto mund të dyshoje nga leximi i Homerit. As gjatë Luftës së Trojës, as pas mbarimit të saj, atëherë kur enigma e ikjes së saj duhej të sqarohej, nuk u jepet përgjigje këtyre pyetjeve. Jepej vetëm njëfarë pendimi i saj për ato që ndodhën, por edhe ai ishte tepër i mjegullt. Kurse qëndrimi i saj ndaj burrit të ligjshëm, Menelaut, ishte gjithashtu i paqartë: kishte urrejtje për të, kishte përbuzje apo dashuri?

Motërzimet e ndryshme të eposit shqiptar, duke dhënë secili shpjegime të ndryshme të sjelljes së Ajkunës, janë të qarta e të prera brenda vvetveta. Kishte një variant ku Ajkuna, pasi rrëmbehej me forcë nga rivali sllav i Muisit. Kthehej në robinë dhe si çdo robinë priste çastin e çlirimt. Po ka një tjetër variant ku rrëmbyesi kaq shumë magjepsej prej saj saqë e bënte princeshë, duke lënë për hir të saj gruan e vet, madje e detyronte këtë t'u bënte

dritë, duke mbajtur një pishë ndër dhëmbë gjatë netëve të para të dashurisë. Në këtë variant qëndrimi i brendshëm i Ajkunës nuk jepej. Por kishte dy motërzime të tjera ku ai jepej qartë: në njërin, megjithëse princeshë, ajo mbetej besnike e burrit të parë, në tjetrën, fill pas rrëmbimit, dashurohej pas rrëmbyesit të saj dhe jo vetëm kaq, por, kur Mujsi vjen përtat çiruar, ajo e tradhton mizorisht të shoqin. Ishte pikërisht ky variant që këndoi rapsodi dhe ku Mujsi i tradhtuar e i lidhur me zinxhirë në fund të shtratit të dashnorëve, me një pishë të ndezur të futur me forcë midis dhëmbëve, ndriçon lojën e tyre të dashurisë.

Ishte e qartë se në këto katër Ajkunat ishte shpërndarë figura e Helenës ose më saktë Helena ishte një përzierje e të katrave. Si e tillë ajo ka mjaft mjegull dhe po aq e mjegullt është sjellja e Menelaut ndaj saj.

### *1 mars, bujtina «Rrashti i Buallit»*

Shum po ndrit nj'ai diell e pak po nxeh.

Bën ftohtë. Por ne jemi të lumtur. Kemi rënë më në fund në platformën e një parauniversi të përbashkët greko-iliro-shqiptar. Poetët mesjetarë shqiptarë prej vitesh ngulnin këmbë përkëtë, por, siç ndodh shpesh me poetët, dëgjohen tepër vonë.

Përpinqemi tē vihemë nën lëkurën e Home-rit pér tē kuptuar se ç'tirani duhet pér ta vënë nën fre gjithë atë shkumëzim tē tërbuar artistësh.

Shqetësimi i vjetër ngre krye herë pas here: mos po humbasim në këtë kaos? Dhe shqetësimi tjetër, konkret: do tē kthehet vallë lahutari i parë?

Druhemë t'ia shfaqim Shtjefnit dyshimet tona, kaq i sigurt është në kthimin e tij. Kurse ne s'jemi aspak tē qetë.

### *1 mars, bujtinë*

Ndërsa numëronim orët në pritje tē lahutarit, në han bujtën papritur dy rapsodë. Jemi me tē vërtetë me fat, tha Shtjefni, asnëjëherë s'kanë qenë kaq tē shpeshtë. Ndërsa njëri nga rapsodët ishte i qetë e fjalëpak si gjithë maliësorët, tjetri qe gjithë lëvizje dhe nerva, ngrihej e ulej vazhdimisht, shkonte te dera, vështronte udhën sikur priste prej andej diçka, një lajm tē mirë apo një fatkeqësi. Pér çudi, prej tē dyve ishte ai që, pas një bisede kokë më kokë me Shtjefnin, pranoi tē këndonte.

Ndryshe nga ç'e prisnin, ai tha se do tē këndonte pa lahutë. Nuk dha shpjegime përsë, ndoshta teli i saj i qe këputur, apo dora e tij kishte pësuar diçka. Përreth u bë qetësi, ashtu

si edhe herën tjetër, por, kur rapsodi, përpara se të niste këngën, ngriti krahun e djathtë dhe, duke hapur pëllëmbën e dorës, e vendosi atë midis pjesës së sipërme të faqes dhe veshit, ndërsa gishtérinjtë e hapur dilnin sipër qafës së kreshtë, ne të dy, gati në një gojë, pëshpëritëm «majekrah»! Ishte gjesti i moçëm që përmendej në të gjitha studimet me këtë fjale shqipe të papërkthyeshme, dhe që ne po e shikonim më në fund të gjallë.

Kaloi njëfarë kohe gjersa rapsodi të niste të këndonte. Qysh në fillim të epit, kur ai tha me vargjet:

*«Un', do t'marr, eh, sot një gjak të vjetër,*

*Kurr'ksi gjaku kujt s'i ra me marrë»,*  
unë dhe Maksi thirrëm me një gojë.

— Rapsodia e Zukut Flamurtar.

Ishte vërtet ajo, këtë herë e plotë dhe e mahnitshme. Qyshse ishim njojur me eposin, ka qenë një nga èndrrat tonë për ta dëgjuar. Gjermanët nuk e kishin quajtur më kot «Orestiada» shqiptare. Janë aty të gjitha si dikur: dhe tradhtia e së ëmës së Zukut, dhe motra që e shtyn vëllanë në mëmëvrasje, dhe furitë dhe ndëshkimi.

Në fund i kërkuam rapsodit të na thoshte se kur do të kthehej, por, për habinë tonë dhe sidomos të Shtjefnit, ai tha se nuk do të kthehej më në Rrafsh.

Shtjefni kishte mbetur me gojë të hapët.

Një malësor që ikën nga Rrafshi është për të më tepër se diçka e pabesueshme. Është para së gjithash një shenjë e keqe, si ato që paralajmërojnë mynxyrat.

Kur u bind se malësori nuk bënte shaka, Shtjefni u nxi nga dëshpërimi. Kuptohej që i vinte zor nga ne.

Ne u mërzitëm gjithashtu, por, për hir të tij, e mbajtëm veten. Arsyen për t'u mërzitur kishim: thelbi i punës sonë mbështetet tek ajo që e kemi quajtur mekanizmi i harresës. Mirëpo hetimi i tij as që mund të kuptohet pa regjistimet e përsëritura.

Rapsodi nuk kishte dhënë asnje shpjegim për moskthimin e tij. Ç'nuq na shkoi në mendje: i ikte ndonjë gjakmarrjeje, ndonjë pasioni, shkonte për studime, për të zëvendësuar dikë në burg (ligjet shqiptare e lejojnë këtë) apo thjesht për të bërë gjënë më të papërfytyrueshme për një malësor: për t'u kthyer në qytetar?

Kanë ardhur kohë të mbrapshta, tha Shtjefni. Gjithfarë marrëzish mund të presësh prej njerëzve.

*Mars*

Bujtina është bosh. Ne vazhdojmë punën, por herë pas here diçka na zgavrohet në gjoks: rapsodi i parë që ende s'po kthehet.

Pritja e tij na është kthyer në një lloj fataliteti. Jemi të sigurt se do të regjistrojmë e do të riregjistrojmë të tjerë rapsodë, por, në qoftë se s'na kthehet më ai, do të na mbetet një brengë në shpirt. Është njëfarë lloj dashurie e parë.

Shtjefni na vështron me një ndjenjë faji. Ndihet që vuan më shumë se ne nga kjo vonesë. Nganjéherë del te porta e hanit dhe vështron rrugën që tretet në mjegull. Ajo ngjan e pashpresë, sidomos në shi.

Dje, ndërsa pinim kafenë e mëngjesit, dëgjuam një zhurmë jo të zakonshme. Një shunllimë që vinte nga larg. Dolëm jashtë për të parë.

— Është një aeroplan pasagjerësh që shkon dy herë në javë këndeja, — tha Shtjefni, që kishte ngritur kokën gjithashtu drejt qiellit.

— Një avion pasagjerësh?

Ne i ngulëm sytë njëri-tjetrit. Shtjefnit, që nuk i shpëtoi ky vështrim dyshues, na u afrua.

— Po ju mos u mërzitni, — tha me zë të ulët, duke bërë një shenjë me kokë andej nga vinte zhurma. Në Rrafshin Verior s'ka asnje aeroport, por, edhe sikur të kishte, asnje mësor s'do të udhëtonte kurrë me aeroplan.

— Ah, — ia bëri Maksi kushedi pse.

— Ka shumë arsyë për këtë, më besoni, — vazhdoi Shtjefni. — Por mjafton t'ju thosha njérën prej tyre: për të blerë biletën e avio-

nit, malësorit do t'i duheshin së paku të ardhurat e dy ose tre vjetëve.

Ne tundnim kokat për t'i thënë se e kuptonim plotësisht.

— Kështu që ai do të vijë se s'bën, — tha Shtjefni duke i shqiptuar fjalët tepër ngadalë.

— Veç në mos pastë vdekur, — shtoi me zë të shuar.

Rapsodi, ashtu siç e kishte parashikuar bujtinari, u kthye vërtet. Ishte një ditë e shurdhët, qelli bunacë, dhe do të mendoje se çdo gjë kishte ngrirë dhe këngët ishin harruar përgjithmonë. Ai dukej i prishur në fytyrë saqë ata menduan se diçka i kishte ndodhur, por nuk guxuan ta pyesnin. S'kishte asnjë shpresë se do të këndonte, madje i thanë bujtinarit të mos ia përmendte fare premtimin, por Shtjefni tun-di kokën: do të këndoje patjetër, ka dhënë fjalën. Dhe vërtet ashtu ndodhi, pa folur pothuajse fare, sikur të kryente një detyrim, lahitari u ul në stolin e drunjtë përpara mikrofonit dhe i këndoi njërin pas tjeterit të dy epët.

Fill pas ikjes së tij, gjer natën vonë dhe pastaj të nesërmen ata krahasuan regjistrimin e ri me tekstin e regjistrimit të parë. Kishin kujtuar se me atë fytyrë të vrerosur lahitari do t'i bënte ndryshime të mëdha tekstit. Madje, në hyrje Maksi kishte regjistruar fjalët e veta në anglisht: «Ep i kënduar pas dy javësh prej një rapsodi që me sa duket ka kaluar një

tronditje, dëshpërim të thellë apo fatkeqësi.»

Mirëpo, për habinë e tyre, tekstet nuk kishin pothuajse asnjë ndryshim. Nga rreth një mijë vargje mungonin vetëm dy, kurse te ske-na e Muisit të lidhur, vargu:

«Shkrumb i pishës n'mjekër t'Muisit nxinte»  
ishte bërë:

«Shkrumb i zi i pishës n'jargë përzihej».

Ata e diskutuan gjatë me njëri-tjetrin shkakun e këtij ndryshimi dhe herë u dukej se ai ndryshim si edhe mungesa e dy rreshtave, ishin në të vërtetë firoja më e vogël që mund të pritej në këto një mijë vargje, herë e shpjetgonin si të shkaktuar prej gjendjes së keqe shpirtërore të lahutarit, gjendjes që kishte rritur dozën e hidhërimit në këngën e tij.

Më vonë e lanë mënjanë këtë si diçka të dorës së dytë dhe, të mrekulluar, vështronin vargun e nënvizuar në tekst. Ja më në fund ku kishin përparrë ndryshimin e parë të ëndërruar prej kohësh. Ishte atje, jo më pjellë e teorisë, por e gjallë, e vërtetë. Dhe ajo mungesë tjetër prej dy vargjesh, ajo gropë e vogël, harresa e parë që kishin kapur, ishte aty. Të dyja bashkë, edhe ndryshimin, edhe harresën, vazhdonin t'i shikonin të magjepsur dhe tani gjithçka u dukej prapë e mundshme. Kishin kapur një nga fijet kryesore të enigmës homeriike, njësinë më të vogël të ndryshimit dhe të harresës: atë që ndodhë tek i njëjtë lahutar brenda dy javësh.

Por brenda disa viteve ç'harresa ndodhnin, po brenda një shekulli, një gjysmëvjeçari dhe jo më te një lahutar, por në një varg lahutarësh, në një brez të tërë, në disa breza rresht, brez pas brezi, siç thuhej? Mekanizmi i harresës merrte papritur përmasa të frikshme dhe ata ndienin tëmthat që t'u rrithnin me forcë ngaqë mendja, me sa dukej, e kishte të vështirë të punonte me përmasa të tilla.

Ishin kështu krejt të përpirë nga puna kur u erdhi ftesa për ballo e nënprefektit dhe e gruas së tij. Në fillim mezi e kuptuan ç'qe, kaq e papritur, e pavend, e largët, e kotë e absurde iu duk një gjë e tillë. Thanë me një gojë «jo», ndërsa me vete mendoheshin: ç'punë kemi ne aty, është pa dyshim një keqkuptim, dhe, ngaqë ende s'pajtoheshin dot me mendimin se mund të ftoheshin në një ballo, ishin të bindur se që vërtet një keqkuptim dhe se ajo ftesë dhe ai korrier duhej të ishin për tjetërkënd. Mirëpo në ftesë, me shkrim të kujdeshshëm, qenë shkruar emrat e tyre dhe, veç kësaj, përpara hanit kishte ndaluar vetura e zezë, me turinj të gjatë e nënprefektit. Pra, si të mos mjaftonte ftesa, ai kishte dërguar dhe makinën për t'i marrë. Ata u bënë gati të thonë prapë fjalën «jo», por turbull u kujtuan se për ballon ishte bërë fjalë qysh natën e mbërritjes së tyre, dhe, veç kësaj, e gjithë kjo zonë ishte nën urdhrat e nënpre-

fektit, duke përfshirë ndoshta edhe hanet, dhe një pjesë të rapsodëve shtegtues...

Pas gjysmë ore, të veshur me kostumet e zeza, në veturën e modelit të vjetër, ata udhëtonin përmes fushës, që tani në muzgun e ftohtë dukej plot mister. Façatazma mullarësh u shmangeshin aty-këtu dritave të makinës, dhe dy-tri herë Vili psherëtiu me vete: O perëndi, ku po shkojmë kështu? I duheshin disa sekonda sa të vinte në vete e të kujtohej se po shkonte në ballon provinciale, mirëpo aty për aty mendimi i terratisej prapë dhe i dukej se udhëtonin përmes rreziqesh të fjetur, të ngrirë prej kohësh, që ata po i zgjonin pa kurrfarë nevoje, për të keqen e tyre.

— Një muzg i tillë, — tha Maksi me zë të ulët te supi i tij, — s'kam parë kurrë të tillë muzg.

Ishte vërtet ashtu, një ajër i zi, prej të cilit si me pompë qe thithur çdo gjurmë yjesh, regëtimë tjetër drite apo butësie. Një muzg përrëmbime grash, mendoi Vili. Gruaja e nënprefektit, pisha në dhëmbët e nënprefektit, pastaj në dhëmbët e tij (sipas varianteve të ndryshme të lahutarëve), uh, sa torturuese ishin të gjitha këto!

Vili mori frysë i lehtësuar, kur që larg u dukën drizëzat e qytetit. Te porta e shtëpisë së nënprefektit ishin ndezur fenerët. Në sallonin e madh, përveç të ftuarve të herës tjetër,

ata panë fytyra të reja. Duhej të ishte një pjesë e elitës së qytetit N.

— Jemi shumë të gjëzuar që po ju shohim prapë midis nesh, — tha nënprefekti, ndërsa vazhdonte t'i njihte me të ftuarit. — Mjeku gjinekolog i qytetit. Avokati. E shoqja. Me zotin Rrok, njiheni tashmë. Me drejtorin e postës gjithashtu. Është vërtet e këndshme t'ju kemi midis nesh. Shefi i rekrutimit të qytetit. Ja dhë gruaja.

Pas një ore ata të dy ishin aty po aq të huaj si në fillim. Kishin nga një gotë në duar si të gjithë, bisedonin, madje një herë vallëzuan, por prapë nuk mësosheshin dot me asgjë. Gjithçka përreth u dukej si prej letre, e pavërtetë dhe qesharake. E ndienin se nuk shkëputeshin dot nga bota e eposit, për të qenë të natyrshëm në këtë ballo. Sjellja e tyre si prej tutkunësh, me siguri kishte rënë në sy, por atyre aq u bënte. Ja, zonjat çu-çu-çu nëpër qoshe, duke i përvjetdhur me sy, me siguri hidhnin thumba për ta, por atyre aq u bënte. Ata ishin larg, atje te hani, ku njerëzit ishin ndryshe, ku edhe veshjet, edhe gjestet dhe kodet, në bazë të të cilave vepronin, ishin të tjera.

Mbështetur te mermeri i oxhakut, Vili solli ndër mend bujtësit e hanit me ato veshjet që kishin përsipër motive bore e bryme dhe që dukej se ishin qepur nga një makinë qepëse që përdorte gjatjanë vetëtimash.

Ai e vështroi gjatë. Ishte pa dyshim një marrëzi që t'i fliste kështu, e aq më tepër asaj, gruas së nënprefektit, first lady të N.

Mendimin ia tha Malësit porsa hipën në veturën që do t'i conte në han, në kohën që të gjithë të ftuarit, ndërsa kthehet nëpër shtëpi, i përgojonin me siguri duke i quajtur të pashoqërueshëm, hutaqë, mendjemëdhenj ose të çmendur.

— Hm, — ia bëri Maksi përmes gogësimës.  
— Ti thua se si është e mundur që një popull me përmasa të tillë të administrohet në kohën e sotme nga një regjim qesharak, madje është pak ta quash kështu. . . Në të vërtetë ke të drejtë. Në një familje malësorësh do të gjesh ndoshta më shumë seriozitet se në parlamentin e tyre.

— Atëherë si shpjegohet? — tha Vili.

— Si shpjegohet? Natyrisht s'është e lehtë t'i japësh një shpjegim. Kjo ndoshta vjen ngaqë popuj të tillë si shqiptarët, me fantazma dhe delire të mëdha, ashtu të fantaksur e me kokën në re, sic janë, kur është fjala për formën e regjimit apo të qeverisjes së brendshme, mund të kapen lehtë në befasi, si njeriu që kapet në gjumë.

— A thua? Kurse mua më duket se punët janë ndoshta më të ndërlikuara se ç'duken.

Ndërsa fliste Vili nuk i hiqte sytë nga një dritëz e humbët që regëtinte në largësi, duke e

bërë më të frikshëm e më të pashpresë terrin.

— Të kujtohet polemika që gjetëm pak kohë më parë në shtypin e tyre, ku përmendej nganjëherë edhe eposi? Të kujtohet se si një grup shkrimtarësh të majtë akuzonin kolegët e tyre të djathjtë për krenari idioteske kombëtare, hymnizim traditash, studim të eposit etj. etj., me qëllim, sipas tyre, që të tërhiqnin vëmendjen nga plagët shoqërore të vendit? Kurse këta të fundit, i akuzonin të majtët për ide socialiste, madje komuniste, për antikombëtarizëm të shitur te sllavët etj.?

— Ah, po, — tha Maksi me zë të përgjumur. — Më kujtohet që s’ë gjenim dot se cila palë kishte të drejtë. Njëra, tjetra, të dyja, apo asnjëra.

— E pra, punët janë vërtet të ndërlikuara po t’i shikosh nga afër, — tha Vili pas pak. — Sidoqoftë, pas përpjekjesh titanike për të fituar lirinë, të përfundosh në një regjim të tillë, o zot, në një shtet të tillë të pabesë dhe idiot; kjo është një hata.

Zëri i tij ishte i ulët e monoton, si të fliste me vete. Ai priti një copë herë që Maksi t’i përgjigjej, i munduar nga frika se mos ai i thoshte frazën «çdo popull meriton regjimin që ka», që ai e urrente.

Mirëpo tjetri nuk tha asgjë, ngaqë, me sa dukej, kishte nisur të dremiste.

## VII

*14 mars, bujtina «Rrashti  
i Buallit»*

Tamam kur pritej që tē zbutej pak, moti shtrëngoi përsëri. Rrotull bujtinës pellgjet kanë ngrirë krejt. Krongjij akulli kudo.

Për fat e ftohta s'na ka penguar tē bëjmë regjistrime tē reja. Disa pér herë tē dytë, ç'ka e quajmë suksesin tonë kryesor.

Po vërtetohet ajo ç'kemi hulumtuar pér harresën: nga tē gjitha regjistrimet e dyta asnjë nuk është i barabartë me tē parin.

Pra, duke u rikënduar së paku pas një javë (s'kemi mundur tē bëjmë prova në njësi më tē shkurtër), çdo ep e ka brenda vulën e parë tē harresës.

Është kjo vulë shenja e vdekjes së ardh-

shme të tij, mikrobi, sëmundja që do ta shuajë më pas, apo përkundrazi është vaksina mbrojtëse nëpër shekuj? Me sa duket është më tepër kjo e fundit.

Po vërtetohet kështu ajo që kemi dyshuar qysh në Nju-Jork:

Harresa në rastin e eposit oral nuk ka të bëjë me mundësitë e kufizuara të kujtesës njërezoze.

Ajo është pjesë përbërëse e laboratorit.

Shkurt ashtu si në procesin e metabolizmit të qenieve të gjalla ajo është një vdekje që siguron vazhdueshmërinë e jetës.

Pyetja që kemi bërë dikur: harresë me dashje apo pa dashje tanë na duket disi naive. Asnjë rapsod gjer tanë nuk i është përgjigjur asaj, madje jo vetëm s'i është përgjigjur, por as që e ka kuptuar. Me sa duket janë të dy ligjet e harresave, por në një raport të tillë me njëra-tjetrën që për ne ende mbetet misterioz.

Këtu duhet shtuar se harresa është vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër, e lidhur ngushtë me të, janë shtesat. Lahutarët, ashtu siç heqin dicka, edhe shtojnë dicka.

Pas gjithë këtyre vijmë te pyetja që dukest fatale: sa për qind është firoja për një njësi kohë të caktuar: dhjetë javë, dhjetë vjet, një çerek mijëvjeçari, një mijëvjeçar?

Në pamjen e parë krijohet përshtypja se në trupin e eposit vazhdimisht shpërbëhet dic-

ka, mirëpo mosha tepër e lashtë e tij bie në kundërshtim me këtë.

Bëmë një llogari të thjeshtë që na la më gojë hapët:

Në epin për pabesinë e gruas së Mujsit, ndryshimi brenda dy javësh kapte gati një të mijëtën e tekstit. Sipas kësaj llogarie, pas dy mijë javësh, pra afërsisht pas dyzet vjetësh epi duhej të shpërbëhej krejtësisht. Mirëpo kjo s'kishte ndodhur.

Atëherë ç'ka ndodhur?

E kemi vrarë mendjen shumë për këtë dhe kemi ardhur në përfundimin se pjesa më e madhe e harresave dhe e shtesave nuk janë në të vërtetë të tilla, madje do të ishte më e drejtë të quhen *gjojashtesa* dhe *gjojaharresa*.

Me fjalë të tjera pjesa më e madhe e shtesave s'janë veçse harresa të mëparshme, të korriguara tashmë prej rapsodit, ashtu sikurse harresat, s'janë veçse shtesa të përkohshme, që rapsodi, për arsy që ndoshta s'i di as vetë, vendos t'i lërë prapë jashtë tekstit, e kështu me radhë e kështu pafundësisht.

Kur të bëjmë dhjetëra e dhjetëra regjistrime të tjera, do të jemi ndoshta në gjendje të hetojmë më mirë këtë qarkullim vërtet të çuditshëm nga kujtesa në harresë dhe e kundërtat. Atëherë vërtet mund të dallohen harresat dhe shtesat e vërteta nga të pavërtetat.

Por kjo s'është aspak e thjeshtë. Kush

mund ta dijë se për ç'arsye dhe në ç'rrugë misterioze një harresë e zhytur në terr për vite me radhë mund të ngjitet prapë në sipërfaqe? Vec kësaj ajo vërtet mund të shfaqet tek i njëjtë rapsod, por, ashtu si në lëvizjen e ujërave të nëndheshme, fare mirë mund të dalë te një tjetër që është larg të parit në hapësirë e në kohë. Madje që nga varri ku prej vitesh mund të jetë tretur rapsodi, copëza e harruar e epit mund të shpërthejë baltën e të dalë përsëri e pandryshuar aspak prej vdekjes.

### *Mesi i marsit, bujtinë*

Shënimë të shkurtra për rolin e veshit në poezinë orale. Raportet vesh-sy. «*Majekrahu*».

Duke përshkruar gjestin e lashtë të majekrahut, të shoqëruar madje me një vizatim, gjermanët kanë hedhur idenë se ndoshta ai diktohet nga një nevojë fiziologjike. Kaq.

Mendojmë se duhet zhbiruar më tej. Pyetjes sonë se ç'kuptim kishte ky gjest, nëse lidhej me ndonjë rit të lashtë apo kishte një domethënie simbolike, bujtinari i dha një përgjigje të turbullt, që përkonte pak a shumë me gjermanët. Me sa duket nevoja që kanë rapsodët për të mbyllur njërin vesh gjatë këndimit lidhet me shndërrimin e zërit të tyre nga zë gjoksi në zë koke, si edhe me mbajtjen e drejt-

peshimit të kokës gjatë maramendjes që kri-jonte kënga.

Fjalë të bujtinarit: «Ju nuk mund ta merrni me mend se sa e vështirë është të këndosh këngë kreshnikësh. Dikur e kam provuar vetë, por pa ia dalë dot. Koka të gjëmon sikur të kesh brenda orteqe. Po të mos jesh i mësuar, mund të çmendesh.»

S'ka dyshim se epika orale është në radhë të parë arti i veshit. Syri, pa të cilin s'mund të kuptohet shkrimtari i sotëm, s'lozte ndonjë rol kushedi çfarë në kohën homerike. Veç në pëngonte. Jo më këtë Homeri ashtu edhe përfytyrohej, pa sy.

Rapsodët sytë duhet t'i kenë përgjithësisht të dobët. Me siguri duhet të kenë përbuzje për ta. I lënë vetë ndoshta të prishen me mënyra aë i dinë vetëm ata (A nuk thuhet se Demokrati u verbua me dashje ngaqë sytë e pengonin të thellohej në përsiatjet e tij?).

Përfytyrimi i rapsodëve si të verbër mund të jetë ndoshta njëfarë kredo, njëfarë manifesti për distancimin e artit nga realiteti. Për të ardhur te puna jonë konkrete, mos vallë verbimi, ose së paku dobësimi i syve të rapsodit, është pjesë përbërëse e teknologjisë së kësaj lloji epike? Me fjalë të tjera: mos vallë ajo është e nevojshme për mbajtjen mend sa më saktë të repertorit?

Të gjitha këto ide janë tërheqëse, por së

pari ne duhet të provojmë nëse lahutarët e sotëm i kanë vërtet sytë të dobët. Këtë mund ta bëjmë me anë të tabelave të ngjashme me ato të okulistëve.

Gjer tani nuk kemi takuar ndonjë rapsod të verbër. Thënë se në qytete ka plot të tillë. Por rapsodët e qyteteve s'janë të mirëfilltë, gjersa këndojnë për të marrë lëmoshë. Kjo gjë na ngatërron fund e krye.

Por kjo s'e pengon Maksin që në krye të një faqeje të fletores së tij të shkruajë me germana kapitale këtë frazë në formë titulli të një dizertacioni: «3000 vjet evolucion nga verbimi i plotë homerik te humbja e një përqindjeje (Sa?) të shikimit të rapsodit të sotëm shqiptar.»

*21 mars, bujtina «Rrashti  
i Buallit»*

Mrekulli. Regjistrime të njëpasnjëshme. Një pjesë të përsëritura.

Po nisim të hulumtojmë sistemin e kalimit gojë më gojë, huazimet dhe ndikimet e rapsodëve nga njëri-tjetri. Për këtë na duhet të krijojmë një sfond regjistrimesh për të krahasuar p.sh. epin e kënduar nga rapsodi A., me variantin e rapsodit B., i cili nuk e kishte atë në repertor, por e futi pasi e dëgjoi prej të parit.

Kjo s'është e lehtë. Sidomos po të kihet

parasysh natyra e sertë e lahutarëve.

Qarkullimi gojor i epeve duhet të ketë ligjësitë e tij, tepër të ndryshme nga qarkullimi i botimeve në kohët moderne. Megjithatë edhe ky qarkullim duhet të ketë suksesin e ditës, dështimet dhe bestsellerët e vet.

Por ky është vetëm hapi i parë. Nuk mjaf-ton vetëm të hetohet se ç'pëson epi kur kalon nga një këngëtar te tjetri. Duhet zbuluar se ç'ndodh kur ky kalim bëhet midis dy brezash lahutarësh. Si merret në dorëzim epi në humnerën që ndan dy kohë; madje dy epoka. Ç'ndodh më tutje.

Por ka edhe më. Meqenëse eposi ndodhet në dy gjuhë, problemi ndërlikohet krejt. Dygjuhësia e tij u jep të gjitha çështjeve një përmasë të re gjiganteske, të cilën s'jemi në gjendje ta përballojmë tani për tani. Kalimi nga njëra gjuhë te tjetra, nga njëri komb te tjetri duhet të jetë i dhimbshëm. Ky është, me sa diktet, i vetmi krijim artistik në botë që ekziston i dyzuar. Dhe është pak të thuash i dyzuar në dy gjuhë. Ai është në dy gjuhë të dy kombeve ndërluftuese. E përdorin njëlloj të dyja palët, shqiptarë e serbë, ashtu siç do të përdorej e njëjta armë në një dyluftim *sui generis*, kobzi.

Varianti i njërsës gjuhë i krahasuar me variantin e tjetrës është si i kthyer kokëposhtë. Ngjan si një pasqyrë magjike, ku heronjtë e njërit variant janë antiheronj te tjetri, e bar-

dha është e zezë, gjëzimi helm, fitorja disfatë e kështu me radhë gjithçka mbrapsht.

Është naive të besohet se eposi ka lindur në mënyrë të pavarur te të dy popujt. Dikush duhet të jetë autori e dikush imituesi. Ne kemi një bindje të brendshme se shqiptarët, si banorët më të lashtë të gadishullit, e kanë krijuar të parët (Fakti që motërzimi i tyre është shumë më afër brumit homerik e vërteton këtë). Por ne nuk do të merremi me këtë politikë ashtu siç nuk do të merremi me gjithçka që na largon nga qëllimi kryesor: zbulimit të teknologjisë homerike. Do të merremi me dyzimin aq sa ai lidhet me makinën e harresës, të ndryshimit të formulave dhe të mekanizmit të transmetimit, por kurrsesi më tepër.

Fjalët: «Ne jemi para së gjithash homeristë» të shkruara me shkronja të kuqe në një shirit letre Maksi i ka ngjitur mbi oxhak.

### *Mars, bujtinë*

Kthimi i një ngjarjeje në epos. Me fjalë të tjera «homerizimi» i saj.

Është një nga çështjet ku kthehem i përherë e më shpesh. Pyetjet janë të shumta: ç'kritere ka përdorur eposi për të zgjedhur midis ngjarjeve të shumta prenë e vet? Nga filonte procesi i balsamimit të ngjarjes për ta

përgatitur për pavdekësinë? C'pjesë të buta, hollesira e fakte i hiqeshin dhe ç'formula e stampa të moçme poetike loznin rolin e lëngut bal-samues?

Për të bërë krahasimin e ngjarjes së gjallë me variantin e homerizuar të saj kérkuam një ndodhi sa më të afërt të kenduar në epos. **Nuk gjetëm vec dymbëdhjetë vargje, jo më shumë**, për Kongresin e Berlinit më 1878. Si një përbindësh dimri që rri në mjegull, pa guxuar të afrohet më këndeja në kohë, eposi që ndalur tek ai vit. **Pse vallë? C'e pengonte, c'e trembte?**

Me sa dukej rrallë e më rrallë ai i afrohej kësaj bote që ishte e huaj për të.

E skeduam me hollësi krejt Kongresin e Berlinit: procesverbalet, deklaratat e qeverive pjesëmarrëse, qëndrimin e secilës fuqi ndaj Perandorisë Osmane dhe Shqipërisë, vendimet që u morën atje deri te prapaskenat. E krahasuar me përshkrimin e saj në ep. **ngjarja i ngjante** një kufome të freskët shtrirë përbri mumjes së vet.

Po kérkojmë më kot një ngjarje më të afërt. Na habit fakti se për vitin 1913, vitin e mbapshtë të copëtimit të Shqipërisë, eposi mezi ka dhënë disa vargje. Kurse ai duhej të sokellinte. Kjo tregon se ai ndodhet vërtet në prag të ngrirjes.

*Mars, bujtinë*

C'lëviz dhe ç'nuk lëviz në epos? A ka një bërthamë të qëndrueshme që siguron unitetin e tij gjatë shekujve?

Më parë ishim të bindur se rolin e kësaj bërthame e lozin formulat poetike, stampat, kli-  
shetë, me një fjalë kallëpet bazë në të cilat der-  
dhet brumi poetik.

Ishim të bindur pra se ishin pikërisht këto enë të laboratorit të vjetër që, duke mos ndry-  
shuar vetë, siguronin njëjtësimin e prodhimit poetik.

Tani, sa më shumë që thellohem i në studim, po bindemi se edhe formulat e stampat, pra vetë laboratori ndryshon, veçse ky ndryshim, duke qenë tepër i ngadalshëm, është po aq i pavërejtshëm për syrin njerëzor sa ç'është vjetrimi i yjeve...

Të lodhur nga përmasat e padurueshme që merrte herë pas here studimi i tyre, ata kthe-  
heshin prapë në çështje më të thjeshta dhe kon-  
krete, siç ishte ndikimi që duhej të luante jetë private e rapsodit në shkurtimet a zgjatjet që ai i bënte epit. Kështu p.sh., në qoftë se lahu-  
tari dendësonte edhe më ngjyrat në motivin e xhelozisë te rrëmbimi i gruas së Muisit, duhej

gërmuar në jetën e tij intime për të gjetur atje një shpjegim për këtë. E mrekullueshme do të ishte, në qoftë se ata do të kishin mundësi të bënин një anketë të hollësishme, por kjo ishte një shpresë e kotë, sepse, me sa kishin kuptuar, malësorët nuk pranonin të intervistoheshin për gjëra intime. Kurse ata do të donin të bënин zbirime për gjithçka. Edhe për një episod të tillë si ngurosja e krushqve gjatë një shtegtimi nëpër bjaxhkë, do të ishte e dëshirueshme të hetoheshin hollësira, nga dita e dasmës së la-hutarit, rreziqet, ankthet e mundshme etj. Kra-hasimi i gjithë këtyre në lahutarë të ndryshëm do t'u jepte të dhëna me vlerë të veçantë për studimin. Në pamundësi të intervistimit të la-hutarëve mund të mësonin diçka prej të tjera, por kjo përveç që do të ishte e pasigurt, do të ishte dhe e zbehtë. Më i sakta do të ishte shfry-tëzimi i fishave sekrete të policisë, në qoftë se ato do të ekzistonin për lahutarët, por edhe për këtë pak mund të shpressohej.

Oh, vështirë, gjithmonë e më vështirë po bëhet, përsëritnin ata, por pa dëshpërim. Në të vërtetë ishin të gëzuar që pavarësisht nga vësh-tirësitë, koka e tyre që plot me ide të reja. Mendonin se jo vetëm jeta intime e rapsodëve kishte një raport me eposin, por vetveti një raport i tillë krijohej, sado e çuditshme të du-kej kjo, edhe midis eposit dhe vetë jetës së tyre intime. Në fund të fundit, megjithëse ishin

irlandezë, duke qenë studiues të eposit, a nuk ishin në njëfarë mënyre ata redaktorë të tij? Homeri (në qoftë se vërtetohej teza se ishte një redaktor) përpara se të merrte përsipër unifikimin e materialit epik, e kishte studiuar atë me siguri. Pra dhe ata ishin pakëz në rolin e Homerit dhe si të tillë jeta e tyre intime, traumat, kujtimet e forta, xhelozitë, në mënyrë të pandërgjegjshme, duhej të loznin një rol në forcimin apo dobësimin e vëmendjes së tyre ndaj pjesëve të ndryshme të eposit.

Herë me shaka, herë seriozisht nisën të sillnin nëpër kujtesë skena të jetës së tyre të përditshme; një pjesë në shtëpitë e tyre në Irlandë, të tjera skena në kabinet telefonike ose në baret e Jork Aveniusë, itinerarin e taksisë ditën e dasmës së Maksit, dyshimet e tij në uik end të verës së fundit, kur gruaja i kishte lënë një pusullë se po shkonte te prindërit, kurse ai dyshonte për një lidhje të saj të vjetër. Vilit nga ana e tij iu kujtua martesa e dytë e nënës, brenga e së cilës edhe tani, pas pesëmbëdhjetë vjetësh, e gërvishitte. Dalëngadalë e gjithë jeta e tyre u shpështoll pjesë-pjesë përpara titanit të frikshëm oral dhe shpesh në orën para muzgut peizazhet irlandeze dhe rrokaqiejt e Manhattanit qëllonte që përziheshin me pamjen e Bjeshkëve të Nemuna, që ata, megjithëse ende s'i kishin shkelur, i njihnin tani aq mirë.

A binte prapë dëborë apo sytë i bënин ashtu?

Vili afroi ballin te qelqi i ngrirë. Binte vërtet një borë e rrallë, mospërfillëse. Maksi po merrej me magnetofonin.

Qysh ditën që Shtjefni u kishte thënë se kishin nisur të pëshpërisnin gjithfarë gjérash për aparatin e tyre, përpinqeshin të punonin me zë të ulët. Një ditë, me sa dukej dikush kishte dëgjuar që nga poshtë kthimin mbrapsht me shpejtësi të dyfishuar të bobinës dhe qe llahtarisur. Kishte nisur të thërriste: po ia spërdredhin fytin dikujt atje, për perëndi, po e mbysin.

Më kot bujtinari qe përpjekur ta qetësonte duke ia shpjeguar punën. Ai qe tërbuar më keq: domethënë të tilla lemerira bëkan ata më zërat e lahutarëve. Ata janë zëra djalli e jo njeriu. Dhe ti lejon që kjo hata të bëhet mu në bujtinën tënde. Turp për ty, Shtjefën.

Që nga rruga, ai i kishte thirrur edhe një herë. Ruhu, Shtjefën! Ke futur djallin në bujtinë, më dëgjon?

Ndonëse bujtinari nuk u tregoi veçse një pjesë të bisedës, ata u mërzitën. Pastaj e qetësuan veten se në fund të fundit një mosmiratim i tillë i punës së tyre ishte i natyrshëm. Regjistrimi i epeve ashtu si edhe botimi i tyre vite më parë s'kishte qenë veçse një kambanë vdekjeje për rapsodët. Sa vinte ata po bëheshin

më të panevojshëm. Dhe kështu do të pakësos heshin çdo ditë e më shumë këta hamej të këngës, gjersa një ditë të zhdukeshin, siç zhduken vërtet hamejtë prej konkurrimit të makinave.

Ishin duke folur pikërisht për këtë, madje Vili po thoshte se shpikja «hamej të epikës», ndonëse ngjante e bukur, nuk ishte e plotë, sepse rapsodët ishin më shumë se kaq dhe rrallimi i tyre lidhej me vjetrimin dhe ndryshkjen e gjithë makinës së lashtë, kur te dera e dhomës u ndie trokitja e bujtinarit që ata e njihnin tashmë. Ndërprerjet e kaltra në skajet e zarfeve që ai mbante në dorë e dhanë vetëtimthi dhe hareshëm idenë e postës, përpara se ata të bëhen në tashmë se ajo kishte mbërritur.

Ishte posta vërtet. Nuk i kishin harruar, i kishte gjetur gjer në fund të botës. Të paduruar ia rrëmbyen bujtinarit nga duart dhe filluan t'i hapnin zarfat pa parë mirë se kujt i përkitnin. Ishin aty disa letra dhe kartolina që ata, nga padurimi për të parë se nga kush vinnin, u shikonin vetëm fundin.

— Maks, shiko, — tha befas Vili duke nxjerrë nga zarfi më i madh ca copa të prera gazetash.

— Vili bëri «po» me kokë.

Ata i lanë në çast letrat dhe, duke qëndruar kokë më kokë, nisen të përpinin me sy në

fillim titujt e pastaj tekstet e artikujve. «I erdhi vallë fundi enigmës homerike?» Kishte copa nga «Nju-Jork Taimsi», nga «Uashington Posti». «Një aventurë e çuditshme në tokën që besohet se është djepi i fundit i poezisë homerike.» Ja edhe dy gazeta të Bostonit dhe «Monitor» e Çikagos: «Dy shkencëtarë të rinj irlandezë atakojnë prapë problemin homerik në një mënyrë krejt origjinale. Është fjala për zotërinjtë Maks Roth e Vili Norton që, ndryshe nga tradita shekulllore, kanë shkuar të vërtetojnë çështjen në vend. I papritur është në këtë rast fakti që kërkimet nuk kryhen në atdheun e Homerit, por në Shqipërinë fqinje, ku thuhet se teknika e poezisë epike është ende e gjallë ashtu si tri mijë vjet më parë.»

— Kjo punë tani ka marrë dhenë, — tha Vili, pa ngritur kokën nga leximi.

— Punë e madhe. Një ditë do të merrej që do të merrej vesh. Ndoshta më mirë që ndodhjë kështu.

— Shiko këtu, — e ndërpreu Vili.

Ishte një copë nga gazeta «Herald tribjun». Në një shkrim të shkurtër me inicialet H. E. përshkruhej ikja e tyre nga Nju-Jorku fshehu-razi si e dy dedektivëve. Njëra nga gazetat e Bostonit shkruante për ta plot ironi dhe mosbesim, tjetra përkundrazi e quante nismën e tyre të lavdërueshme, madje u uronte edhe punë të

mbarë. Në një shkrim tjetër flitej më shumë për magnetofonin, sesa për ta.

Gjithë atë ditë ata e kaluan nën përshtypjen e copave të gazetave. I lexuan e i rilexuan disa herë dhe menduan t'i bënin menjëherë një telegram falënderimi kunatit të Maksit, që kishte pasur idenë e mrekullueshme t'ua dërgonte. Shtjefni u tha se brenda katër ditëve, e shumta një javë, telegrami mbërrinte me siguri në Nju-Jork.

Hani kishte jetën e tij, e cila, ngaqë vërehej prej tyre në një mënyrë krejt të ndërprerë. Në orët e pakta të pushimit, u dukej edhe e huaj dhe e pakuptueshme. Ngjarjet që ndodhën poshtë në kthinën e madhe të përbashkët ishin përherë disi të mbytura më tepër me murmurima dhe përherë të mbuluara me një tis misteri. Malësorët shqiptarë ishin seriozë, e kishin përturp të flisin shumë dhe nuk dukezin. Në mëngjes treteshin të gjithë si hije, saqë atyre s'u besohej se natën kthina mund të kishte qenë plot.

Martini u tregonte herë pas here ato që ndodhnin. Një natë bujtën një grumbull i zyntë burrash, që dukej se ndiqnin dikë. Pas këtyre ia behën xhandarët e mbretit dhe fill pas tyre i ndjekuri. Ishte e pamundur të kuptohej ç'ndo-

dhte. Një ditë tjetër bujtën malësorët nga Lugjet e Žeza që çonin një të sëmurë në kryeqytet. Në mëngjes, kur ata zbritën për të pirë kafenë, i sëmuri qe ende atje, i shtrirë mbi një vig. Fytyra i dukej si maskë. Ata pyetën se ç'kishte dhe Martini u tha se nuk ishte sëmundje ngjittëse.

— Dyshohet se i kanë muruar hijen, — shpjegoi Martini. — Në qoftë kështu, kot që e çojnë gjer në kryeqytet. Nga vdekja s'shpëton dot.

— Ç'është kjo sëmundje? — pyeti Maksi.  
— Ç'do të thotë «i kanë muruar hijen»?

Martini nuk e pati lehtë t'uа shpjegonte. Kjo ishte një lëngatë, nga e cila nuk shpëtoje dot. Viktima kishte qenë murator dhe me sa duket gjatë ndërtimit të një kulle, dikush nga shokët e tij, me dashje ose pa dashje, i kishte muruar hijen, domethënë kishte hedhur gurë dhe llaç mbi hijen e tij që binte mbi murin që ndërtohej. Zakonisht malësorët muratorë ru-heshin nga murimi i hijes si nga djalli, sepse dihej që, po t'u murua hija, t'i mbetesh rob i murit, pra, do të vdesësh. Mirëpo, me sa dukej, ky malësor ka qenë tepër i ri në punë dhe pa përvojë. Kështu që, me dashje ose pa dashje, ia kanë bërë kobil. Eh, të dhimbset, për zotin, as njëzet vjet s'i ka.

Irlandezët vështruan njëri-tjetrin.

— Po ndoshta s'është kjo arsyefa? — tha

Vili. — Ti the vetë se veç dyshim qe ky.

— Sigurisht që s'është veçse dyshim, — u përgjigj Martini, — përndryshe ata as që do të merrnin mundimin ta çonin gjer në kryeqytet.

— E çuditshme, — tha Vili kur u ngjitten lart. — Sëmundje të vjetra apo më mirë shpjegime të vjetra sëmundjesh, që të ngjethin mishtë.

Nën ndriçimin e fundit të pasdites syprina metalike e aparatit rrëzëllinte frikshëm. Sytë e tyre përpinqeshin t'i shmangeshin atij, por, ndonëse nuk e thoshin, e ndienin se shqetësimi që ndienin thellë qenies së tyre, ai trazim i turbullt, i errët, i pashpjegueshëm nga fjalët dhe nga logjika, lidhej kryesisht me të.

Një të shtunë, kur porsa ishin kthyer nga shëtitja e mëngjesit, Martini që po mprehte një kalë në oborr, u tha se brenda po i priste një i panjohur.

Ishët një njeri shtatmadh, me veshje gjysmëmurgu dhe me fytyrë të rrumbullakët, të kuqe prej fshatari. Do të dukej si një baba-xhan sikur tek ajo pjesë e buzëqeshjes që realizohej prej syve të mos kishte një ndriçim të rrezikshëm. Fliste anglisht, shqip dhe serbisht.

— Isha duke kaluar këndeje, kur dëgjova për ju dhe për punën që po bëni, — tha ai duke i buzëqeshur herë njërit, herë tjetrit. — Punë e mrekullueshme për besë. Pata një dëshirë të madhe t'ju takoj. Unë vetë jam serb, në mitropolinë e Pejës, larg këndeje. Po udhëtoja me shërbim për në Shkodër. Punë murgjësh.

— Aha, — ia bëri Maksi me mospërfillje.

— Ja kështu, — vazhdoi tjetri. — Unë gjithashtu jam marrë pakëz me mbledhje epesh të vjetra. Me aq sa më jepet dhe kur gjej pak kohë të lirë. Ne famullitarët merremi nganjëherë me këso gjërash. Natyrisht, si amatorë, as që bëhet fjalë për një punë shkencore. Eh, ç'mund të presësh nga një murg i humbur. Megjithatë, diçka kam mundur të mbledh, me shpresë se kushedi dikujt mund t'i hyjë në punë.

— Ashtu? — ia bëri Maksi me njëfarë interesimi.

Murgu e ripërtériu buzëqeshjen që edhe ashtu nuk i ikte nga fytyra.

— Kur dëgjova për ju, ndjeva vërtet një gëzim. Më kuptoni, s'di si t'jua shpjegoj, si ai mbledhësi i provincës së thellë që është marrë vite me radhë me punën e tij naive, befas dëgjon se ia mbërriti nga bota e madhe mjeshtri. Ne famullitarëve na ndodh kjo. Të shkëputur nga bota, në vetmi, ja kështu... Të them

të drejtën, kam ëndërruar të takoj njerëz si ju. Të bisedojmë për epet e vjetra. Ndoshta ju jeni të zënë dhe kohën e keni të çmuar.

— Pse jo? — tha Vili. — Për ne gjithashtu është kënaqësi të bisedojmë për to. Ne kemi bërë mijëra kilometra pikërisht për këtë gjë.

— Është e dobishme, — tha Maksi duke e ftuar të ulej. Ndihej menjëherë keqardhja për mospërfilljen e pakmëparshme. — Doni të merrni diçka?

— Ju faleminderit, por do të doja unë t'ju gostisja diçka. Pavarësisht se s'jam vendës, por fqinj i tyre jam, këndeje pranë.

— Peja është në Kosovë, në Jugosllavi, apo jo? — pyeti Vili.

— Po, zotni. Megjithatë, në krahasim me ju, në njëfarë mënyre unë jam këtu si vendës. Prandaj ma jepni këtë kënaqësi.

Ata porositën nga një gotë raki që Shtjefni ua solli duke vështruar vjedhurazi të ardhurin.

Pas pak biseda u dendësua dhe u bë e ngrohtë, si midis miqsh. Dalëngadalë ata nisën t'i shpjegonin gjithë strukturën e punës së tyre, ndërsa ai tundte kokën me admirim dhe habi, duke thënë herë pas here: «Eh, ç'është shkenca. I kemi këto gjëra përparrë syve, mu në turi dhe s'dimë t'i vërejmë. Famullitarë të humbur që jemi, injorantë. Medet, medet.»

Dy-tri herë që ata deshën t'i merrnin ndonjë mendim për diçka, ai tundte kokën plot dyshim.

— Unë s'marr vesh nga teoria, zotërinj. Kuturu e kam bërë punën. Nga një murg i paditur, q'mund të presësh?

Pas gotës së dytë të rakisë, sytë e tij u bënë më të vegjël, por më zhbirues.

— Po ju vetëm me rapsoditë shqipe merrni? Ky epos, besoj se e dini më mirë se unë, është edhe në një gjuhë tjetër, serbokroatisht.

— Ah, po, — tha Maksi. — Natyrisht që ne e dimë se eposi gjendet në dy gjuhë. Por tani për tani ne do të merremi me motërzimin e këtushëm.

Buzëqeshja në faqet e murgut, të skuqura edhe më shumë nga rakia, dukej se vazhdonte për inerci.

— E përse, marr lejen t'ju pyes?

Irlandezët këmbyen një shikim të shkurtër.

— Arsyeba është e thjeshtë, — tha Vili. — Ndoshata juve si sllav nuk do t'ju vijë mirë, më falni, por... ne mendojmë se motërzimi shqiptar është më i vjetër, rrjedhimisht lidhet më shumë me atë punë që merremi ne.

Buzëqeshja nisi të shformohej në fytyrën e murgut, por pa u zhdukur prej saj. Ata nuk kishin parë ndonjëherë që një buzëqeshje të kthehej në të kundërtën e saj, duke ruajtur

megjithatë formën e saj prej buzëqeshjeje. Kështu, në atë formë që nuk i shkonte, ajo dukej edhe më e helmët.

— E përse, në qoftë se më lejoni t'ju pyes, mendoni kështu? — tha ai.

Irlandezët i kishin ftyrat të ngrysura, thua se zymtia që murgu duhej ta kishte, u shtohej atyre. Biseda ishte bërë në të vërtetë e pakëndshme dhe, po të mos ishte inercia e mirësjelljes së pakmëparshme, ajo do të ishte ndërprerë.

— Fare thjesht, — u përgjigj këtë herë Vili. — Një epos si ky s'mund të lindë njëkohësisht në dy popuj. Dikush e krijon i pari dhe tjetri e merr ose e përkthen prej tij. Në këtë rast shqiptarët si popull më i vjetër, autokton....

— Është ky një argument? — e ndërpren murgu.

— Prisni, nuk mbarova. Në epos gjenden me shumicë elemente mitologjike të përbashkëta iliro-shqiptaro-greke. Sllavët, — ai deshi të thoshte ju, por në çastin e fundit e shmangu fjalëzën, — nuk kishin të tilla kur erdhën në gadishull.

— E pastaj? — tha murgu. — Ndoshta pikërisht ngaqë erdhën më vonë u befasuan më shumë prej tyre dhe u frymëzuan për të krijuar atë thesar.

— Mos u ngutni, — e ndërpren Vili. — E keqja është se në motërzimin sllav, me aq sa e

njohim ne, elementet mitologjike janë tejet të varfra. Kurse në këtë lloj poezie ato janë vendimtare për të përcaktuar vjetërsinë e saj. Mirëpo vjetërsia në këtë rast nuk është barazi autorësi. Besoj se jeni në mendje me mua, apo jo? Më falni edhe një herë.

— O, s'ka gjë, s'ka gjë, — ia bëri murgu. Nuk u deshën veçse pak çaste që ai të arrinte ta rindërtonte buzëqeshjen në ftyrën e tij. Ajo u bë prapë babaxhane si edhe më parë. — S'ka gjë, zotërinj. Ju më bëtë një nder kaq të madh që pranuat të këmbeni mendime me mua, një murg të paditur. Edhe një herë ju lutem të ma falni këtë, si ta them, pasionin tim. Por ju kuptioni, besoj, unë jam serb dhe si i tillë do të mbroj kombin tim. Kjo është diçka e pa-shmangshme, sidomos këtu në Ballkan. Ju lutem, mos ma merrni për të keq.

— O, asgjë, asgjë, — thanë ata në një gojë. — Janë gjëra krejtësisht të kuptueshme dhe jo vetëm në Ballkan.

U bë një heshtje e shkurtër që kishte benda ngutin për t'u mbushur.

— Ju, me sa kuptova, me anë të këtij eposi do të përpiqeni të gjeni ç'ka qenë Homeri.

Maksi pohoi me kokë.

— Nder të madh do t'i bëni tërthorazi eposi shqiptar dhe në përgjithësi shqiptarëve, apo jo?

— Pa dyshim.

Murgu e zgjeroi buzëqeshjen edhe më. Fytyra e tij ishte tani e një njeriu krejtësisht të mirë, buçkaran.

— Nuk e fsheh që bëhem xheloz. Do të doja që ky ndër t'i përkiste kombit tim. Po s'ke ç'i bën.

— S'ke ç'i bën, — e përsëritën irlandezët njëri pas tjetrit.

Murgu nxori një orë nga xhepi i rrobës së tij.

— Oh, shiko shiko, ora paska ecur pa kuptuar. Ika, zotërinj. Ju ndjefsha të mirën.

Nxitueshëm ai doli nga dera dhe, kur ata u ngjitën lart, e panë nga dritarja që po i hip te një kali të zi, që u nis sakaq me një ecje, që nga larg u duk e rëndë plumb.

## VIII

Kishte ditë që dukej se e zotëronin gjithë atë masë të pafundme poetike, se kapnin madje dhe horizontet e saj gjer në largësitë e thella, por shpejt e kuptonin se ky nuk ishte veçse një iluzion. Vinte dita tjetër dhe konturen e eposit, mjegulloheshin prapë, lëkundeshin, treteshin; në fillim skajet, pastaj pjesët e tjera, duke arritur gjer te qendra. Atëherë u dukej krejt i pamundur zotërimi i tij. Ishte njëlloj si të përpinqeshe të zotëroje një kaos, ku ngjarjet, personazhet, mynxyrat shfaqeshin në variante të ndryshme si në një ankth.

Eposi i madh ngjante si pas një katastrofe. Të çara të hatashme e përshkonin kryq e tërthor, pjesë të tëra ishin të thërrmuara si pas një përplasjeje. Midis pluhurit të rrënojave

heronjtë e tij shfaqeshin të përgjakur në ato variantet e tyre që të kallnin datën.

Kur kishte ndodhur vallë kjo gjëmë? E kishte humbur unitetin e tij nga goditja, apo kështu kishte qenë pérherë, një nebulozë poetike që pret kohën e vet pér t'u shformuar? Këto pyetje, që ata i bënin e i ribënin me dhjetëra herë, kishin lidhje tanë me krijimin e poemave homerike. Në qoftë se edhe ato kishtë qenë të tilla më parë, një lloj materieje poetike në gjendje të papërpunuar, atëherë kuptohej tërë madhështia e punës së Homerit që kishte arritur t'i sistemonte dhe t'i disiplinonte. Më kot kujtonin disa se, duke i hequr Homerit autorësinë, i bënin ndonjëfarë dëmi. Në të vërtetë lavdia e tij si redaktor do të ishte ndoshta më e madhe se ajo e rapsodit.

Duke menduar kështu, ata prapë përpiqeshin të vinin veten e tyre në rolin e tij, ashtu siç qe ai, pa libra, pa skeda, pa magnetofona dhe, sikur të mos mjaftonin të tjerat, pa sy. O zot, ia bënin ata, pa të gjitha këto, ai e mbildhët Iliadën, ose më mirë paraliadën, pér takthyer në Iliadë? Si mund të kishte ndodhur vallë kjo? Herë u dukej se i afroheshin së vërtetës, pastaj prapë e ndienin që ishin larg. Mendimi që pak më parë ishte qartësuar, vishej përsëri me mister, zhytej prapë në thellësi, ngjitej pastaj në kohën tonë si ai zhytësi

që kërkon të marrë fryshtë përpëra zhytjes së re, e kështu me radhë.

E gjithë kjo ishte e pandarë nga pyetja se ç'kishte qenë ai. Poet gjenial apo redaktor gjenial, zyrtar, kontestator apo ideolog? Ishte një lloj publishers i asaj kohe, kronist mondan i Olimpit, zëdhënës zyrtar (disa nga pjesët e Iliadës ngjanin me konferanca shtypi), apo shef dhe si çdo shef kishte ndihmësit e tij të shumtë. Apo s'ishte asnje nga këto, madje s'ishte fare person, por një institucion, dhe emri i tij, i përbërë prej iniciash, duhej shkruar jo Homer, por H. O. M. E. R.

Ata buzëqeshën me disa nga hamendjet, por kjo s'i ndalonte të kërkonin të tjera. Sado të çuditshme të ishin, ato qenë urnat ku qe shpërndarë hiri i së vërtetës së tij. Kishte pa dyshim një gjymtim të rëndë fizik, por më tepër se verbëri, kjo duhej të ishte shurdhëri. Shurdhëri e shkaktuar nga dëgjimi i dhjetëra mijëra hekzametrave. Në të vërtetë shurdhëria i shkonte Homerit. Verbëria ishte për kohët e mëvonshme kur shpikën librat. Megjithatë, ashtu përfytyrohej ai në skulpturë, i verbër. Po në qoftë se skulptori i gjetur përpëra kësaj vështirësie e zëvendësoi njërin gjymtim me tjetrin? Në fund të fundit, syri dhe veshi kanë pasur përherë njëfarë afërsie si gjymtyrët më tipike e të dukshme njerëzore.

— Kështu do të lajthitim ndonjë ditë edhe ne, — tha njëherë Vili.

Maksi e vështroi tinëz. Iu duk se në vend të fjalës «lajthitim» ai kishte menduar fjalën «verbohem». Në të vërtetë gjendja e syve të Vilit qe keqësuar dhe Maksi po mendonte që në rastin më të parë t'i kërkonte nënprefektit t'i ndihmonte për një mjek. Në N. s'kishte mjek për sytë dhe duhej shkuar ndoshta gjer në Tiranë. Nga të gjitha pandehmat për Homerin, Maksi qe përpjekur kohët e fundit t'i shmangej bisedës për verbimin e tij.

Ata nuk rreshtnin së kthyeri tek ideja se eposi duhej të kishte pasur një tjetër strukturë përpara katastrofës (Këtë fjalë ata e përdorin tanë si një term). Në qoftë se katastrofë kishte pasur, ajo kishte ndodhur me siguri në kohën e përplasjes me turqit. Ndeshja e Evropës së krishterë me botën islamike në Shqipëri u ndie më shumë se kudo. Çdo gjë u trand, u shemb, humbi drejtpeshimin. Eposi pësoi fatin e gjithë botës shqiptare. Pjesë të tëra të tij u mbuluan nga rrënojat, ai u ndalua, lahutarët që e bartnin duhej të strehoheshin maleve, ata humbën lidhjet, ruajtja e tij u bë e vështirë dhe si çdo gjë që kalon në ilegalitet ai duhej të ndryshonte. Kështu ndoshta shpjegohej thërrimi i tij dhe motërzimet e shumta që e jepnin atë pamje etheje.

Ata mendonin se, sikur Iliada, sipas Ho-

merit, të mos fiksohej më vonë në një botim, edhe ajo mund të rithërrmohej kështu për t'u dendësuar përsëri në një unitet të ri. Ciklet e formimit dhe shkatërrimit të eposeve të tillë duhej të kishin diçka të ngjashme me ciklet e krijimit, të thërrmimit dhe rikrijimit të botëve prej pluhurit kozmik.

Përherë e më tepër eposi u përfytyrohej si një lloj galaktike poetike, brenda së cilës vepronin forca misterioze. Ishin ndoshta ato mesazhe të fshehta që vinin nga qendra e saj, të cilave lahutarët u bindeshin për të kufizuar lirinë e tyre, dëshirën për ndryshime apo për rebelim. Ndaj, po t'i shikoje me këtë sy, duke-shin të gjithë të përhënur, në atë dritëz të largët në vështrim e me atë zë jonjerëzor, lëmmimi i të cilit mund të bëhej vetëm nga hapësirat ndëryjore.

Ngandonjëherë u dukej se eposi s'mund të ishte veçse kështu, i shpërndarë, dhe se ata po bënin diçka kundër natyrës që përpinqeshin ta mblidhnin me përdhunë. Atëherë u dukej që më tepër se një ansamlli poetik, ai i ngjante një urdhri mesjetar, anëtarët e të cilit, Iahutarët, duke e kthyer këndimin në rit, e shpërndanin atë anekënd sipas një ceremoniali dhe të një oborrësie të rreptë. Një testament i madh kombëtar s'mund të ishte veçse i tillë. Sepse në të gjitha mesazhet e vjetra, ai, duke parandier dhe paravajtuar ndarjen e Shqipërisë

më dysh, ishte pa dyshim testamenti numër një për shqiptarët. Kështu shpjegohej ai ankim i gjatë, i gjatë mijëvjeçar, ai paralajmërim në formë gulçi, monotoninë e të cilit e shkaktonte përsëritja gjer në lodhje e urdhrit arkaik.

Kaq shumë mendonin për të gjitha këto, saqë nganjëherë mendimi u vazhdonte edhe në tëndërr. Për çudi, nganjëherë u dukej se nuk kishte ndonjë ndryshim të madh midis asaj që u shfaqej në tëndërr dhe asaj që mendonin gjatë leximit apo dëgjimit. Hapësira atje shtrihet sipas një topografie delirante, kurse koha rridhete pas ligjeve të tjera. Veprimi zgjaste qindra vjet, heronjtë vdisnin ose magjepseshin, binin në gjumë të thellë, zgjoheshin prapë, vazhdonin luftën gjysmë të gjallë gjysmë të vdekur, martoheshin midis luftërave, pushonin ca kohë në varre (o perëndi, kishte thënë një herë Vili, thua se po shkojnë për në pushimet e verës), ngriheshin prapë për të rifilluar mynxyrat e kështu me radhë. Ishte tamam pasqyrimi i një konflikti mijëvjeçar, ku çdo gjë vërtitej si në vorbull. Shtatëqind vjet rreshth kam për të t'i vrarë fëmijët, e kërcënonte Mujsi vjehrrën e kundërshtarit të tij sllav. Nga ana tjetër, të shtatë bijtë e tij të gjithë me emrin Omer, ia ka vrarë serbi Rado, dhe të shtatë janë varrosur në Bjeshkët e Nemuna.

Nganjëherë koha rridhete rrufeshëm në

epos, brenda pak çastesh ndodhnin të gjitha ato që parashikoheshin në fundin e botës, por kjo nuk pengonte aspak që koha papritur të përgjumej, ecja e saj ngadalësohej, me dhjetëra vjet vazhdonte shërimi i një plage, apo krushqit që ishin nisur për dasmë dhe që orët i kishin ngrirë gjatë rrugës, çnguroseshin, pas ca kohësh vazhdonin udhën për dasmë, e cila, megjithëse kishin kaluar disa vjet, vazhdonte t'i priste si në ditën e parë të saj.

Asgjékundi në eposin evropian, madje as në sagat islandeze nuk kishin ndeshur në një përdorim të tillë të kohës.

Marsi po dilte, por ditët ishin ende të ngrysura si në shkurt. Ata prisnin me padurim ngrohjen e motit, megjithëse nganjëherë u dukej se ajo do t'i shkëpuste nga klima e eposit. Ajo, siç e kishin vënë re dhe më parë, ishte gjithmonë dimërore dhe në vështrimin e parë do të dukej e habitshme se si në një vend mesdhetar si Shqipëria mund të krijohej një peizazh i tillë plot erë, shkëlqim dëbore dhe krongjij akulli. Gjithë eposi dukej sikur kerciste nga ngrica. Ishte një erë e ftohtë luksoze, ku dëbora nuk shkrinte kurrë për të zbuluar baltën nën vete dhe nganjëherë atyre u dukej se një klimë e tillë ishte krijuar enkas

për të përligjur konservimin e gjatë të heronjve. ngrirjen, vdekjen e përkohshme dhe rizgjin min e tyre pastaj. Një herë u dukej se ishte e natyrshme që në një epos të krijuar në lartësinë rrëth dy mijë metra të zotëronte një klimë e tillë, por nga një shqyrtim i hollësishëm i tij u dukej që klima në të vërtetë ishte e një vendi më të lartë se dy mijë metra, madje mund të thuhej pa frikë se veprimi zhvillohej në një truall katër-pesë mijë metra mbi tokë, praktikisht gjysmë në dhe gjysmë në qiell.

Ata kishin bërë regjistrome të reja, një pjesë me shumë sukses dhe ishin prapë të gëzuar. Puna po u vente mbarë. Kishin mundur të plotësonin listën e përkimeve të motiveve shqiptare dhe greke të vjetra. Përveç familjes së Artridëve dhe të Ulisit kishin gjetur në epos motivin e Circesë, të Nausikës e të Medesë, si dhe Furitë dhe Eumenidet që te shqiptarët quheshin orë dhe zana. Kishin bërë hulumtime të reja për harresën duke u zhytur në hollësira të tilla si ushqimi i lahutarëve, sasia e fosforit që merrnin (për çudi, dilte se në ushqimin e malësorëve peshku pothuajse nuk njihej, pa përmendur pastaj stimulantë të kujtesës si fitina, që me siguri çdo rapsodi që mund t'i propozohej do t'i dukej njëlloj sikur t'i jepnin një bar shtrigash nga ato që e tërbonin ose zhduknin fare kujtesën). Përveç këtyre kishin arriut të regjistrin një lahutar që besohej se

para një javë kishte kryer një vrasje për gjakmarrje, mirëpo kurrsesi nuk arrinin të përcakttonin përqindjen e ndikimit të saj mbi tekstin e epit.

Me gjithë kaosin, që herë pas here i mundonte, ata e ndienin se eposi, sidoqoftë, pomblidhej dalëngadalë, bobinë pas bobine, në telat magnetikë të aparatit. Në mëngjes sa zgjoheshin, sytë u shkonin padashur në syprinën e tij që rrëzollente qetë. U pëlqente të përsëritnin se kishte qenë vërtet një mrekulli shpikja e atij aparati. Ishte e thënë, me sa dukej, që zbulimi i enigmës homerike të priste shpikjen e tij.

Ky mendim u shtonte atyre sigurinë dhe u hiqte gjithfarë dyshimesh. Sikur të mos e kishin atë, ishte e natyrshme që në çastet e ligështimit të mendonin se edhe paraardhësit e tyre homeristë, pasi ishin rrekur njëlloj si ata, për të zgjidhur të fshehtën, kishin hequr dorë prej saj, ishin tallur me entuziazmin e tyre të fillimit, kishin qeshur me ironi, ndoshta me cinizëm me veten dhe me të tjerët që do të përsëritnin gabimin e tyre. Mirëpo aparati e ndalonte talljen të vinte gjer tek ata. Tani atyre u pëlqente të mendonin se paraardhësit e tyre do ta kishin zgjidhur prej kohësh çështjen homerike, sikur të kishin pasur në dorë magnetofonin. Kështu që u dukej se ata kishin fatin që koha u kishte dhënë në duar çelësin e suk-

sesit dhe se ata s'bënин gjë tjetër veçse kryenin një urdhër të saj.

Një natë, kur kujtuan se magnetofoni u prish, u bënë si të marrë të dy. Ishin duke dëgjuar natën vonë, kur zëri i tij befas u trash, u zvarg si një masë brumi, krejt si zëri i njeriut kur i bie damllaja. Ata u zverdhën të dy në fytyrë. Po të shikonin një të afërt të tyre t'i binte hemorrhagja cerebrale, nuk do të tronditeshin më tepër. E humbën fare, vërtiteshin rrotull pa ditur q'të bënин, hapnin e rihapnin pasaportën e përdorimit, gjersa Maksit i rindër mend të kontrollonin bateritë. O perëndi, pshërethinë të lehtesuar të dy, kur panë se vërtet bateritë kishin rënë. I vunë bateri të reja dhe desh thërritën nga gëzimi, kur panë se aparatit nisi prapë të punonte.

Megjithatë brenga që u la në shpirt ai tingull i zvargur i aparatit nuk u shqitej kollaj. Kështu qe vjetruar krejt makina e eposit dhe zërat e tij s'ishin veç të mbytur si tinguj që nxirren gjatë agonisë. Ai kishte prodhuar me zor dymbëdhjetë vargje për vitin 1878, kurse për vitin 1913 mezi kishte nxjerrë katër-pesë vargje, edhe ato të mundimshme, si njeriu që përcartet në gjumë. Tani kishte rënë në komadhe vështirë se do të përmendej për të deliruar edhe një herë përpara se e ftohta e vdekjes ta ngrinte përgjithmonë.

Një natë regjistruan bubullimat që dëgjo-

heshin nga bjeshkët dhe një natë tjetër shaku-  
llimën e erës. Mendonin se mund t'u duheshin  
për të krijuar atmosferën, në netët e tyre të  
ardhshme të studimit, larg në Manhattan.

Një ditë Martini u tha se kishte parë pra-  
pë atë murgun serb që qe vërtitur andej, por  
ata mezi u kujtuan për kë ishte fjala.

Përpara se t'i njoftoj për përgjimin e rën-  
dësishëm që munda të kryej sot në Shpellën e  
Qyqes apo në Shpellën e Eremitit, siç quhet  
ndryshe, dëshiroj t'i tërheq vëmendjen zotit  
nënprefekt se në raportin tim të datës 1 shkurt,  
kam dhënë bisedën e dy irlandezëve me mur-  
gun serb, Dushanin, i cili qëndroi në atë kohë  
gati gjysmë dite në hanin «Rrashti i Buallit»  
gjatë rrugës së tij për në Shkodër. Mora guxi-  
min ta bezdiz zotin nënprefekt me këtë kujte-  
së, për arsyen e vetme se ndoshta biseda në  
Shpellën e Qyqes mund të kuptohet më qartë  
e ballafauar me bisedën e asaj dite. Nga  
ana tjetër, përpresa se të jap bisedën e fundit,  
dëshiroja ta paralajmëroja zotin nënprefekt dhe  
këtë aspak për të përligjur mungesat e mia si  
përgjues, as të metat e punës sime, por për hir  
të së vërtetës, pra dëshiroja ta paralajmëroja  
zotin nënprefekt se më tepër se bisedë midis  
njerëzish normalë, ajo i ngjante llomotitjes mi-

dis dy të çmendurve dhe në këtë rast zoti nën-prefekt do të merrte lehtë me mend vështirësitë e transmetimit të saj. E përsëris së kurre-sesi s'dua të përligj këtu...

Ah, djall, tha me vete nënprefekti duke ngritur filxhanin e kafesë, fundi i të cilit kish-te lënë një rrëth të ngjashëm me një vulë mu-mbi raportin e Dullë Baxhasë. Djall me brirë.

Më poshtë përgjuesi e siguronte zotin nën-prefekt se ai ka qenë gjithmonë i rregullt në kontrollin e veshëve (vizitën e fundit e kishin kryer sipas normave të vendosura, dy javë më parë, dhe siç dëshmohej edhe nga vërtetimet e mjekut, veshët e tij ishin në gjendje të kënaq-shme.) Përveç kësaj, ai për hir të ruajtjes së freskisë së kujtesës, u përmbahej në mënyrë të prerë të gjitha rregullave të ushqimit, nuk vinte në gojë pikë alkooli dhe se, pavarësisht se do të parapëlqente një ushqim të llojit tjeter, han-te rregullisht sasinë e peshkut që i nevojitej për të sigruuar fosforin e nevojshëm, përveç lëngut të shtogut që e merrte tri herë ditën, sipas këshillës së mjekut. Ai i kërkonte prapë ndjesë zotit nënprefekt për këtë parantezë të dytë, por këtë e bënte për të sigruuar besuesh-mërinë e informacionit të tij dhe këtë jo për arsyе karrierizmi, ngritje në rrogë etj., por vë-tëm për hir të punës, ngaqë e ndiente se dy-shimi më i vogël për vërtetësinë e raportit të

tij mund t'i sillte pikërisht dëm ndjekjes së më-tejshme të të dy të dyshimtëve.

Eh, ia bëri me vete nënprefekti duke rufitur prapë filxhanin, i cili kishte lënë një vulë të dytë mbi relacionin. E dinte se edhe sikur njëzet vjet të studionte retorikë a avokaturë apo ç'ishin ato të tjerat, s'do të mundte asnjëherë të përdorte lirishëm atë stil.

Po hë, se na plase, tha më në fund, gjoja i lodjur nga hyrja. Në të vërtetë përgjuesi i tij duhet ta kishte kuptuar se kënaqësia kryesore e nënprefektit kur merrte raportet e tij, ishin pikërisht këto hyrje. Ai tha: hë, se na plase, për të marrë vesh shpejt ç'raportonte spiuni, në mënyrë që pastaj të kthehej prapë për të lexuar edhe një herë më nge hyrjen.

Dullë Baxhaja njoftonte më tutje se në datën 5 mars, pasi e kishte parë përsëri murgun serb, Dushanin, të vërtitej rrëth hanit, qe habitur që murgu në fjalë s'kishte bërë asnje përpjekje për të takuar dy të huajt, madje mund të thuhej se i qe shmangur takimit me ta. Duke parë se murgu s'kishte bërë asnje nga ato gjëra që parashikonte përgjuesi, domethënë as kishte qëndruar të pushonte në han, as kishte vazhduar udhën që kishte nisur dhe as qe kthyer mbrapsht nga udha prej nga kishte ardhur, raportuesi kishte shtuar dyshimin dhe bashkë me dyshimin edhe vëmendjen për të. Kështu që, kur murgu Dushan, pas vërtitjeve të tij

të pakuptimta në oborrin e prapmë të hanit, qe nisur papritur dhe, gjëja më e habitshme, pa kalë, në një drejtim që dukej se s'çonte asgjë-kundi, domethënë në një drejtim pa drejtim, si njeriu që ecën kuturu midis fushës, shkruesi i këtyre radhëve kishte pasur ca çaste mëdyshje: ta ndiqte viktimen në ecjen e tij që e nxirrte atë jashtë truallit të përgjimit apo të priste kthimin e tij në han, dhe atje, sipas të gjitha rregullave, të kryente veprimet e tij mbi të? Këtu raportuesi dëshiron te t'i kujtonte zotit nënprefekt se kjo mëdyshje e tij nuk qe shkaktuar aspak nga motive vetjake dhe as tregonte se ai i lejonte vetes të kishte një mendim dhe aq më pak të bënte një zgjedhje të vetën, kur ishte fjala për rregullat dhe ligjet e shtetit, jo, kurrsesi jo. Mëdyshja e tij qe shkaktuar vetëm për faktin se kohë më parë në një mbledhje të përgjuesve qe diskutuar gjatë nëse përgjuesi i mirë, në rast zhvendosjeje të viktimes, duhet të dalë e ta ndjekë pas atë, apo, për hir të ruajtjes së fshehtësisë, të vazhdojë të rrrijë i ngulur në vendin e përgjimit për aq kohë sa qe parashikuar. Për fat të keq, në atë mbledhje nuk qe arritur në asnjë përfundim, duke u lënë çështja për më vonë, kështu që, siç mund ta merrte me mend zoti nënprefekt, mëdyshja e raportuesit nuk qe veçse pasqyrimi i asaj polemike, ose më saktë i mosarritjes së saj në një përfundim.

Dreq, ia bëri me vete nënprefekti duke i vënë një shenjë me thua anash gjithë paragrafit.

Dullë Baxhaja shkruante pastaj si e kishte ndjekur murgun midis fushës, natyrisht duke respektuar të gjitha rregullat përgjimore, dhe se si, për habinë e tij të madhe, e kishte parë më në fund të futej në Shpellën e Qyqes, ose në Shpellën e Eremitit, siç e quanin kohët e fundit për shkak se në të, siç mund të ishte në dijeni zoti nënprefekt, strehohej prej vitesh eremiti Frrok.

Nuk ishte e vështirë, vazhdonte përgjuesi, të kuptohej se midis të huajve, murgut serb, që vinte nga shteti jugosllav dhe eremitit Frrok, të kishte një lidhje, aq më tepër kur dihej këmbëngulja e të huajve për t'u vendosur pikërisht në atë vend. Duke përfituar nga fakti që raportuesi e njihet disi truallin dhe që dinte, për fat të mirë, midis të tjera, se Shpella e Qyqes ka një oxhak natyror ajrimi, ai i erdhë rrotull kodrinës ku ndodhej shpella dhe pa shumë vështirësi, në saje të përvojës së tij oxhakore (në rast se zoti nënprefekt do t'i lejonte përdorimin e një fjale të tillë), arriti të vendosej atje dhe të dëgjonte bisedën e viktimave.

Këtu raportuesi i kërkonte ndjesë zotit nënprefekt që po i kujtonte edhe njëherë rrëshqitazi çështjen e besueshmërisë së raportit të tij, domethënë të kontrollit të veshëve, të kuj-

tesës etj. I ndërgjegjshëm se mund të tërhiqte zemërimin e zotit nënprefekt me këto përsëritje, ai e bënte megjithatë këtë për hir të punës, ngaqë një pjesë e bisedës së dëgjuar në Shpellën e Qyqes dhe pikërisht pjesa e parë e saj ishte aq shumë e ngjashme me një llomotitje të çmendurish, siç u tha më lart, saqë me të drejtë mund të zgjonte dyshime nga më të pakëndshmet lidhur me mbledhësin e saj.

Shkruesi i këtyre radhëve, vazhdonte më tutje Dullë Baxhaja, mund të gjente një rrugë më të lehtë për shmangien e telasheve dhe keqkuptimeve të mundshme, duke e lënë jashtë në informacionin e tij pjesën e parë të bisedës si të pavlefshme, aq më tepër që ai kishte mbërritur me njëfarë vonese tek oxhaku i ajrimit, kështu që fillimi i saj ishte i paplotë. Ai mund ta bënte këtë për të lehtësuar veten, por ndërgjegjja profesionale nuk ia lejoi një gjë të tillë. Vërtet pjesa e parë e bisedës mund të ishte ashtu siç dukej në shikim (domethënë dëgjim) të parë, e shthurur, marroke, delir paranojakësh etj., po këtu dilte pyetja: po sikur të mos qe ashtu dhe kjo gjoja përqartje të qe në të vërtetë një kod i fshehtë, me anë të të cilit dy kriminelët komunikonin me njëri-tjetrin? Ky dyshim kishte mjaftuar që përpiluesi i këtyre radhëve ta regjistronte atë me atë përpikëri që mund të regjistrohet përqartja.

Kur përgjuesi ishte vendosur në gjendje

dëgjimi tek oxhaku i shpellës, dy viktimat ose më saktë eremiti Frrok, që fliste më shumë, po këmbenin mendime se ku mund të ndodhej syri i botës. Me sa kuptoi raportuesi, ata mendonin (ose më saktë eremiti Frrok që e tha këtë shprehimisht), se bota, domethënë planeti ynë, ashtu si shumica e gjallesave, ka dy sy, të cilët, sipas mendimit të tij, ndodhen njëri në oqeanin Atlantik, diku midis Groenlandës dhe Detit të Veriut dhe tjetri në ca stepa të Kashmirit. Njëri nga këta dy sy i është dobësuar tashmë, vazhdonte eremiti, dhe planeti sheh turbull me të, po ti mos kujto se syri i veshur është ai që ndodhet në stepa siç mund të kujtojë shumica e njerëzve. Në të vërtetë është e kundërta, syri i dobësuar është ai që ndodhet në oqean dhe i shëndoshi në stepat plot pluhur. Ja kështu, o murg.

Duhet thënë, vazhdonte Dullë Baxhaja, se murgu serb, megjithëse fliste rrallë, nuk i kundërshtonte fjalët e eremitit. Ai u gjallërua diçka më pas kur eremiti Frrok nisi të tregonte se kohët e fundit ai kishte arritur të dallonte vetëtimat e zakonshme nga ato që qielli i dëshmonte, ashtu si gratë që dështojnë fëmijët. Zakonisht në shtatë vetëtima ndodh një dështim, thoshte eremiti, por ka periudha kohe të shqetësuara kur dështimet shtohen.

Kështu kishte vazduar kjo pjesë e parë e bisedës, prej së cilës raportuesi nuk kishte

arritur të merrte vesh nëse murgu Dushan njihej më parë me eremitin apo kjo ishte vizita e parë në shpellën e tij. Dhe ja tani raportuesi po riprodhonte pjesën e dytë të bisedës, aspak të ngjashme me të parën, duke i kërkuar ndjesë zotit nënprefekt që po e jepte një pjesë të saj në formë pjese teatrale, formë që, sipas mendimit të tij, e ruante më mirë saktësinë e fjalëve.

Fillove me teatro tani, tha me vete nënprefekti. Mendjefemër, eh, mendjefemër që je.

Dullë Baxhaja shkruante se, ndërsa eremiti nisi të fliste prapë për sytë e botës. domethënë për dobësimin e njërit sy, i cili po shkonte pa dyshim drejt verbimit, duke kthyer kështu globin tonë në botë me një sy, për pasojat e kësaj në jetën e tokës, për të mos përmendur pastaj kohën kur edhe syri i vetëm do të fitoj një ditë, duke e kthyer planetin në një planet krejt të verbër, murgu serb e kishte ndërprerë eremitin.

**Murgu serb:** Ke dëgjuar për ata dy të huajt, irlandezë më duket se janë, që janë vendosur ca kohë më parë te hani «Rrashti i Buallit»?

**Eremiti:** As që dua ta di.

**Murgu serb:** Mirë e ke. Edhe unë në vendin tënd ashtu do të thosha për ata gjarpërinj. **Vëçse gjarpërinjtë kafshojnë.**

**Eremiti:** Gjarpërinq ata? Më vjen për të qeshur.

**Murgu serb:** Edhe mua puna e tyre ashtu m'u duk në fillim, për të qeshur, por, kur e mora vesh qëllimin e saj, m'u ngjeth mishtë. Gjarpërinq është pak t'i quash. Ata janë djalli, djalli vetë.

**Eremiti:** E ç'është ajo punë që bëjnë? Dëgjova që kanë një si arkë ku mbledhin zërin e njeriut si litarin në çikrik për ta lëshuar prapë.

**Murgu serb:** Pikërisht kjo është vegla e satanait, me anë të së cilës po e kryejnë kobil mu në sytë e të gjithëve, dhe të gjithë rrinë e gajasen e bëjnë sehir, sepse askush nuk e sheh me sy zezonën. Ti the arkë, po unë do ta quaja atë arkivol, madje pak është t'i thuash ashtu. Është më keq, shumë më keq. Kosa e mortjes do të dukej lule para saj, vëlla Frrok.

**Eremiti:** E, pra, thanë se një copë arkë është.

**Murgu serb:** Një copë arkë, hë? Më mirë të kishin sjellë murtajën, të kishin ngritur trekëmbëshin apo karamanjollën, sesa atë mynxyrë. Një copë arkë, hë? Po ajo është tamam sënduku i skëterrës, vëlla! Tani unë do të ta shpjegoj fill e për pe punën.

Këtu raportuesi i kërkonte ndjesë zotit njënprefekt, që po kalonte prapë në formën klasike të të rrëfyerit dhe kjo për ca arsyen

tekniqe, me shpjegimin e të cilave ai s'do ta bezdiste raportlexuesin.

Pra, murgu nisi t'i shpjegonte eremitit Frrok përse qenë të këqij dy të huajt dhe pse qe e skëterrshme sidomos ajo arka e tyre, aparat apo magnetofoni siç e quanin ndryshe. Është një vegël ogurzezë, thoshte ai, më keq se shtriga që merr ujërat e vyshk barin. Sepse, ndërsa shtriga vdes bar e ujëra, ajo arkë muron këngët e vjetra, i ndrym brenda dhe ti e di ç'pëson kënga po iu murua zëri një herë. Është njëlloj si njeriu po iu murua hija. Vyshket e vdes, ja ç'pëson. Mua aq më bën, vazhdonte ai, unë i huaj jam, vendin tim e këngët e mia serbe i kam larg e në siguri, po më vjen keq për ju, Do t'jua shëmtojë jetën me atë aparat. Do t'jua kositin gjithë këngët e moçme që janë gëzim i jetës, e do t'jua lënë jetën shurdh pa to. Do të kujtoheni, po do të jetë vonë. Do të zgjoheni një mëngjes si në shkreti, e do të zini kokën me duar, po ndërkaq ata, të mallkuarit, do t'ju kenë lënë pendët. Do t'jua kenë grabitur të gjitha e ju do të jeni të dënuar ta çoni jetën në shurdhëri. Brez pas brezi do t'ju mallkojnë përkëtë nipat e stërnipat. Ja kështu.

Dullë Baxhaja shkruante më poshtë se eremiti Frrok e kishte dëgjuar në fillim me qetësi murgun, pastaj nga shrofëtimat e tij u kuptua që ai po acarohej. M'i shtive dreqnit, i thoshte murgut, më thuaj tani, ç'duhet bërë. Po murgu

nuk shpejtonte t'i përgjigjej. I thoshte se duhej bërë diçka, duhej menduar patjetër diçka. Pastaj, papritur, u ngrit, i tha se u bë vonë se po shpejtonte dhe do të vinte një ditë tjetër ta bisodonin prapë këtë punë.

Në mbyllje të raportit përgjuesi shkruante se, kur qe kthyer në han, murgu kishte ikur nëpër udhën e madhe.

## IX

Dezi, me sytë gjysmë të mbyllur, dalloi tufën e flokëve të të shoqit mbi nënkresën e bardhë, dy pëllëmbë larg fytyrës së saj dhe përgjumshëm mendoi: e diel. Ditët e tjera të javës zgjohej e vetme në shtrat, ngaqë atij i qe bërë zakon të shkonte në punë herët dhe vetëm të dielave flinte gjer vonë, njëlloj si ajo.

Dezi hapi sytë plotësisht dhe për disa sekonda vështroi fytyrën e fjetur të të shoqit, së cilës gjumi i jepte një shprehje të ngjashme me atë të njeriut që kërkon mëshirë. Kaloriferët qenkan ftohur fare, mendoi ajo, duke ngritur kuvertën mbi supet. Në dhomë mezë ndihej vëkësira e fundit e mbetur nga nata. Edhe avulli i xhamave qe i shprishur, i kthyer vende-vende

në rrëkeza të vogla, tamam fundi i një ngrohtësie. Dimri s'donte të dilte këtë vit.

Ashtu si në shumicën e mëngjeseve të saj, mendja e Dezit, pasi u vërtit në gjëra të kota, anësore e disa herë pa kuptim, shkoi te dy irlandezët që s'i kishte parë prej kohësh. Ideja e dimrit që mezi po ikte iu lidh, siç duket, me ta. Diçka kishin thënë për mbarimin e dimrit, ah, diçka për ngrohjen e kohës që kishte lidhje me mundësinë e një shtegtimi të tyre nëpër bjeshkë.

Që të ikin edhe më larg, mendoi ajo me një-farë pikëllimi. Po edhe ai ishte i përgjysmuar, njëlloj si avulli i xhamave. Nuk e kishte menduar kurrë se ata (kushedi pse, megjithëse ende mendonte për Vilin, ajo i përfontë tanë të dy bashkë, duke e quajtur Vilin «ata»), pra, nuk e kishte menduar kurrë se do të ishin treguar aq mospërfillës me të. Megjithatë nuk ndihej e fyer. Ishte e bindur se më tepër se mospërfillje kjo ishte një mungesë e shkaktuar nga pamundësia për t'u parë më shpesh. Kaq shumë qenkan të dhënë pas atij, Homerit, mendonte me ankim. Gati sa nuk e urrente atë vjetërsirë.

Megjithatë ishte e bindur se irlandezët diçka kishin biseduar për të. Edhe herën e fundit, kur Vili ishte duke vallëzuar me të dhe kur dytri herë e kishte vështruar ëmbëlsisht, shoku i tij i kishte thënë diçka dhe ai i qe përgjigjur, duke kaluar vetëtimthi bishtin e syrit mbi su-

pet e saj. Ishte e bindur që kishin folur pér të.

My darling. My lord. Dezi mori frymë thellë, duke sjellë ndër mend të vetmet fjalë anglisht që kishte mësuar nga filmat. Në të vërtetë do ta bënte të lumtur vetë ideja se diku, në një han midis fushës së ftohtë, bisedohej anglisht pér të.

Do të organizonin prapë një ballo, pastaj një darkë lamtumire, mendoi ajo me trishtim. Do t'i lindnin prapë ca ëndërrime, ca orë pa gjumë dhe pastaj, pas tyre do të vinte prapë zhgënjimi. Më mirë të mos bënин fare. Përse duhej shkaktuar një trazim i tillë? Përse, mendoi ajo me sytë e mjegulluar.

Megjithatë shumë shpejt u gjend në një darkë me ta. Ishin aty të gjithë dhe oxhaku ishte i ndezur njëlloj si më parë, vetëm se kishte ndodhur diçka, bisedat ishin këmbyer në atë mënyrë siç këmbehen vendet në tryezë. Ato që duhej të thoshte drejtori i postës, i thoshte Vili Norton, e kështu me radhë, kurse ajo, oh, ç'tmerr, ajo e kishte ndërruar bisedën me gruan e fabrikantit të sapunëve.

Zilja e telefonit te koka e krevatit e zgjoi. Mbuloi kryet me cepin e kuvertës, ndërsa nga lëvizjet e krevatit ndjeu si krahu i të shoqit u zgjat përgjumshëm pér të ngritur dëgjuesen.

— Alo, — tha ai me zë të zvargur. — Alo po të them.

Përpara se i shoqi të ndryshonte zërin, ajo

ndjeu një tendosje të trupit të tij si të shkaktuar nga një goditje e beftë.

— Si urdhëron, zoti Ministër, — tha ai, — ju dëgjoj, zoti Ministër. Ah, ashtu, e paskeni marrë? Më bëhet shumë qejfi, zoti ministër. Si? Miratuat dërgimin e përgjuesit të anglishtes? Faleminderit shumë, zoti ministër. Një lajm më të vërtetë i mrekullueshmë. Të them të drejtën e kisha humbur shpresën. Oh, mos kini dyshim, zoti ministër. Tani pëllumbhat do t'i kap me presh në duar. Madje shumë shpejt, ju jep fjalën, zoti ministër.

Ndërsa ai po fliste, Dezi e kishte larguar kuvertën dhe po dëgjonte. Ç'është ky përgjues i anglishtes, tha ajo me vete hutueshmë. I shoqi vazhdonte të fliste me ministrin. Përsëri përmendi fjalët «kapje me presh në duar» dhe «pëllumbhat».

Pasi e la telefonin, ajo pa se si fytyra e tij si një enë e mbushur plot e derdhte anash buzëqeshjen.

— Ç'është ky përgjues i anglishtes? — pyeti ajo.

— Ah, qenke zgjuar ti? — tha ai gëzueshmë. — Në të vërtetë s'kishe si të mos zgjoheshe. Ky telefon i mallkuar.

— Po flisje për një përgjues të anglishtes, — përsëriti Dezi.

— Ah, punë të mërzitshme të shtetit Ti e merr me mend sa të pakëndshme janë.

— Mos është fjala për dy irlandezët?

— Si? Hm, ku të paska shkuar mendja. Megjithëse... Dezi, fli më mirë, ç'e vret mendjen për budallallëqe.

— Do t'i përgjoni?

U duk se ai ngriu në shtrat. Pastaj sustat e krevatit kërcitën si të çliruara.

— E çë pastaj? Ja ta zëmë se do të bëjmë atë që thua ti. Pa shiko, u prish bota.

Një copë herë ajo nuk foli. Gojën e kishte të hidhur.

— Është e shëmtuar. I ftojmë për darkë, pastaj...

— Ha-ha, — qeshi ai, — kalama mbete gjithmonë.

Zgjati dorën për ta përkëdhelur në faqe, por ajo e mënjanoi kokën me neveri.

— Megjithatë mua kështu më pëlqen.

— Mos më ngacmo, — tha ajo, — do të fle.

Ajo bëri vërtet sikur e zuri gjumi, ndërsa ai, pasi priti pak, u ngrit nga shtrati dhe, duke u përpjekur të mos bënte zhurmë, doli prej dhomës. Me siguri shkoi në studio për të marrë në telefon spiunët e tij, mendoi ajo.

Ajo e përfytyronte si binin telefonat në dhomat e tyre të pista dhe spiunët, me sytë të fryrë nga gjumi, nga pijsa dhe sëmundjet e trashëguara, ngrinin dorezën e aparatit, ashtu siç e kishte ngritur ai pak më parë.

Unë jam gruaja e një nëpunësi vulgar, men-

doi ajo. I kishte qarë hallin më kot gruas së drejtorit të burgut apo të fabrikantit të sapunëve. Burri i saj merrej me një punë më të ndyrë se ata. Në të vërtetë ishte ajo për të qarë hallin.

Dezi hapi sytë. Në qelqet e dritäres, rrëkezat e shkaktuara nga avulli i shkrirë ngjanin si lotët mbi maskën tragjikomike. Do t'i përgjonin bisedat e tyre, mendoi ajo me ankth. Dhe ata ishin aq të hutuar, saqë do të binin menjëherë në grackë. «Pëllumbthat». Më kot i kishin quajtur ashtu. Ishin krejt të humbur, sikur t'i kishte lëshuar qifti, do të thoshte gjyshi Mara. Kishin për t'ua dëgjuar të gjitha, madje edhe bisedat për të. Dezi u rrëqeth nga neveria. Veshët e tyre të ndyrë, me zgjyrë, do të dëgjonin emrin e saj. Ajo lëvizi me nervozizëm në shtrat. Duhet bërë diçka, mendoi. S'ishte më punë ëndërrimesh alla filmash, ishte rasti për të bërë me të vërtetë diçka. Një paralajmërim...

Një karrocë me perde të myllura nisi të rendte në përfytyrimin e saj. Brenda karrocës një grua me vello të zezë, ajo vetë. O zot, po e gjitha kjo ishte ndërkaq nëpër filma. Megjithatë karroca me gruan e shqetësuar me vello vazhdonte të rendte drejt hanit «Rrashti i Buallit».

Përgjuesi i anglishtes mbërriti në N. në fund të javës. Përveç nënprefektit dhe njërit prej ndihmësve të tij, askush nuk e dinte në fillim profesionin e vërtetë të burrit me kostum të zi dhe mustaqe të holla spic, që kishte zënë një dhomë në hotel «Globi». Ishte e natyrshme që, menjëherë pas mbërritjes së tij, kureshtja e qytetit të kërkonte sqarimet e nevojshme për vizitorin kryeqytetas dhe, meqenëse mbeti e pakënaqur prej tyre, ishte akoma më e natyrshme që kureshtja të dyfishohej brenda javës. U tha për të se ishte blerës antikash dhe dorëshkrimesh të vjetra kishtare, kultivues ble-tësh, i sëmurë psikik që ajri i bjeshkëve i bën-te mirë. Ndoshta do të jepeshin edhe pandehma të tjera, të gjitha të llojit që shpjegonin zhdukjet e herëpashershme të tij nga hoteli, sikur një fije e së vërtetës të mos dilte në shesh. U lind së pari dyshimi në mjediset e përgjuesve, për arsy që kuptoheshin (kolegë, ambicie profesionale etj.), apo përgjuesit e dëgjuan pëshpërimën diku dhe për të njëjtat arsy e bënë atë ide të tyren? Kjo ishte e vështirë të gjendej. Ajo që mund të shpjegohej lehtë ishte pikërisht interesimi i përgjuesve për një zbulim të tillë. Si në të gjithë mjediset edhe në botën e tyre, megjithëse ajo qe bota e zërave të ulët dhe e gjysmëterrit, kishte elitë dhe shkallë të fundit, adhurim të mjeshtërve prej çirakëve ose

e kundërta, zili dhe urrejtje, ëndërrime të fillostarëve për lavdi, legjenda për përgjuesit kryeqytetas, për aventurat dhe bëmat e tyre të bujshme, ankesa për pamundësitë e provincës etj. Të gjitha këto në njëfarë mënyre i zgjoi njeriu me sjellje zotnie, me flokë të lëmuar dhe mustaqe spic, që dukej tepër rrallë në restorantin e hotel «Globit».

Por më i çuditshëm se të gjitha këto, ishte fakti që pëshpërima nga mjedisi i mbyllur i përgjuesve filtroi përjashta. Që devotshmëria dhe korrektesa e përgjuesve të N. nuk ishte e përkryer, kjo ishte diçka që dihej, madje prej kohësh, për të mos thënë që nga viti i parë i mbretërisë, kur që themeluar ky profesion i ri në N. prej të paharruarit Palok Veshi (mbiemri i tij në të vërtetë kishte qenë Gjoku, por që ndryshuar më vonë prej njerëzve për arsyet që kuptohet), pra, që devotshmëria e përgjuesve të N. nuk ishte e paqortueshme, kjo dihej fare mirë, megjithatë, që të arrinte puna gjer në një skandal të tillë, domethënë që pëshpërima nga mjedisi i tyre të kapërcente rrethojën magjike e të dilte haptazi në botën tjetër, kjo ishte me të vërtetë e papritur.

Nënprefekti që e bisedoi gjatë këtë me ndihmësit e tij, erdhi në përfundimin se ndryshe nga herët e tjera, dalja e sekretit në këtë rast nuk kishte të bënte fare me ndonjë dëshirë të fshehtë që të kërcënuarit ta merrnin vesh

she, tē paralajmēruar kështu, t'u mënjanë heshin rreziqeve. Nënprefekti mendonte se ishte e kundërta, domethënë që jo vetëm s'kishte asnjë synim keqardhjeje ndaj tē huajve, por, përkundrazi, mbërritja e përgjuesit, sipas tē gjitha tē dhënavë, duhej tē kishte zgjuar një valë patriotizmi dhe krenarie tē banorët e N., tē cilët e kishin pritur me entuziazëm (Mos kujtoni ju, tē huajt që vini me ato puro e me ato aparate se mund tē bëni këtu ç'të doni, gjej shesh e bëj përshesh. Jo, zotërinj, ne ju bëjmë atë që s'jua pret mendja, ju zbërthejmë edhe anglishten tuaj). Me sa dukej, ishte pikërisht kjo arsyaja e përhapjes së sekretit.

Arsyetimi për këtë hovëzim tē zjarrmisë patriotike, që, ç'ishte e vërteta, ishte ftohur disi kohët e fundit në N., e qetësoi nënprefektin, i cili e bëri menjéherë veshin shurdh ndaj pëshpërimës së mëtejshme.

Ajo ndërkaq vazhdonte. Emri i përgjuesit tē anglishtes kishte hyrë tani në gojë tē zonjave. Flitej për shërbime tē posaçme që ai i paskësh bërë mbretit në Tiranë, për lidhje dashurie tē tij me zonja kryeqytetase, madje me gra ambassadorësh e për turli gjérash tē tjera. Përgjues i klasës së parë ishte, jo shaka, thoshin me zili midis tyre përgjuesit e thjeshtë tē N. I mësuar nëpër tavane pallatesh e katedralesh, e jo mbi plevica gjithë bajga e pleshta si ata. Dullë Baxhaja, që duhej tē shtrihej përbri tij në tava-

nin e Rrashtit të Buallit, me siguri e ndiente veten ngushtë. Në të vërtetë nder i madh i kishte rënë Dullë Baxhasë që të punonte me këtë as. Apo ndoshta Dullë Baxhaja as që ishte më i nevojshëm tani dhe e kishin hequr prej irlandezëve. Po, po, me siguri e kishin hequr. E përse do të duhej ai tani që mjeshtri kishte arritur?

Por zëra të tjerë thoshin se Dullë Baxhaja vazhdonte të punonte me të huajt. Dhe kjo ishte e logjikshme: Kryeqytetasi nuk do të rrinte ditë e natë në pullaz të hanit, zaten, as që ishte nevoja për një gjë të tillë. Ai rrinte vetëm në orë të caktuara, kurse natën kthehej në dhomën e tij të rehatshme në hotel, duke lënë në pullaz Dullë Baxhanë.

Një ditë Dezi i tha të shoqit:

— Paska ardhur përgjuesi i anglishtes dhe ti s'më paske thënë.

— E çë pastaj? — u përgj ai. — Pa shiko, lajm i rëndësishëm fort për t'u thënë.

Sytë e saj ndiqnin vështrimin e tij që kërkonte qoshet e sallonit.

— Sidoqoftë, të faleminderit që këtë herë nuk e mohove, — tha ajo.

— A? — tha ai dhe, duke bërë sikur kërkonte diçka.

Ajo u ul në kolltuk me sytë ngulur në qilim. Kishte atë trishtim të veçantë, që e zinte herë pas here, një trishtim i topitur, i ngja-

shëm me copëra bore, gjysmë të ngrirë, ndaj i durueshëm më lehtë se trishtimi i vërtetë, i gjallë. Nuk kishte shkuar dot te hani. Qe lëkundur, ishte sprapsur nga pengesa të tilla si me kë të shkonte apo si t'ia shpjegonte shoqes shkakun e vajtjes atje. Nganjëherë qetësohej: tani ç'kishte për t'u bërë ishte bërë, përgjimi ishte kryer dhe ajo s'ndihmonte dot për asgjë. Por shumë shpejt mendonte të kundërtën: ndoshta ende s'kishin arritur të flisnin diçka vërtet të rrezikshme. Ndoshta kishte kohë të parandalohëj e keqja.

Tundimi për të shkuar i përtëritez. Parapërgatiste frazat me të cilat do t'ia arsyetonte shoqes së saj të vetme, gruas së drejtorit të postës, vajtjen në han, dhe prapë nisnin lëkundjet. Gjer në ç'shkallë duhej t'ia tregonte të vërtetën? Ç'duhet t'i thoshte dhe si?

Ç'është kjo torturë, thoshte nganjëherë me vete. Nuk e kishte ditur se kishte qenë kaq e paaftë për të ndërmarrë diçka. Po kjo duhet bërë, mendonte. Së paku të arrinte t'u thoshte të mos flisnin për të, në mënyrë që veshët e pistë të mos e dëgjonin emrin e saj. Së paku kaq të arrinte. Ndoshta të tjerat ata i kuptonin vetë.

Ishte një ditë e mbuluar me re, megjithatë, ndriçimi i marsit ndihej. Ai e bënte më të gjerë kupën qiellore. Vili kishte qëndruar përpara dritares dhe po vështronte përjashta. Pas shpinës së tij Maksi merrej me magnetofonin. Kënga monotone e lahutarit të ndillte gjumë.

Një zhurmë karroce në oborr të hanit e përmendi Vilin nga gjendja gjysmë e dremitur. Afroi ftyrën dhe më, fshiu avullin mbi xham, megjithatë nuk e dalloi dot kriesën që po ecte drejt karrocës. Një çast iu duk si një siluetë e njojur, po aty për aty forma njerëzore iu mje-gullua prapë.

C'është kjo grua, tha me vete, diku e kam parë. Dora e tij fërkonte në mënyrë nervoze qelqin e dritares, gjersa mendimi se avulli s'ish-te atje, por brenda syve të tij, e akulloi të terin. Kaq shumë i qe keqësuar tensioni i syrit sa nuk dallonte njeriun disa metra poshtë?

Gjendja e syve e kishte mërzitur përherë e më tepër kohët e fundit. Kishin vendosur të shkonin të dy me Maksin në kryeqytet për t'u vizituar, megjithatë nuk e kishte besuar që vë-shtrimi t'i dobësohej me aq shpejtësi. Glaukomë galopante, tha me vete emrin e sëmundjes, që e tmerronte kohët e fundit. Mbylli për disa sekonda sytë dhe i hapi prapë me një shpresë të fundit se ndoshta ishte një turbullirë e ças-tit dhe se do ta dallonte më në fund gruan që

po hipte në karrocë. Por gjithçka si edhe më parë ishte e veshur me mjegull. Karroca dukej sikur u përpi prej saj.

— Maks, — tha ai duke u kthyer nga shoku i tij, — duhet të nisemi menjëherë në Tiranë. Sytë i kam keq.

Maksi vrugoi ballin, siç bënte sa herë që binte fjala për sëmundjen e shokut.

Një ditë më vonë nënprefekti nuk u besoi syve kur çeli zarfin në të cilin zakonisht gjente raportin e Dullë Baxhasë dhe në vend të tij gjeti kërkesën e përgjuesit për dorëheqje.

Më bëjnë sytë mua apo Dullë Baxhaja pasка luajtur nga mendja, tha me vete. Një dorëheqje e tillë dhe pikërisht tani që operacioni kundër dy të huajve po i afrohej fundit. Për habinë e tij më të madhe përgjuesi e fillonte pak a shumë me këto fjalë letrën e tij. Pasi i kërkonte ndjesë zoti nënprefekt për shqetësimin, ai i shkruante se, kur ai të lexonte kërkesën e tij, do të thoshte me siguri se ose atij, zotit nënprefekt, i bënин sytë, ose Dullë Baxhaja kishte shkalluar nga mendja.

Jo, vazhdonte spiuni. As zotit nënprefekt nuk i bënин sytë, as Dullë Baxhaja nuk kishte luajtur. Ai po kërkonte dorëheqjen nga detyra duke qenë i pacenuar mendërisht e fizikisht.

Njerëz mendjekëqij, shkruante më poshtë Dullë Baxhaja, do të përpinqeshin ta shpjegonin kërkesën e tij si të shtyrë gjoja nga motive të ulëta, si ngritje në post, shtesë rroge etj., por ai shpresonte se me aq sa e njihte zoti nënprefekt, e kishte kuptuar se Dullë Baxhaja s'kishte punuar kurrë as për karrierë, as për para. Të tjerë qëllimligj do të përmendin ndoshta si shkak për dorëheqje fyeren apo ndoshta zilinë, që, sipas tyre, Dullë Baxhaja, duhej të kishte ndier pas ardhjes në N. të përgjuesit të anglishtes. Kështu mund të mendonin ata, vazhdonte spiuni dhe kjo ishte e natyrshme, përderisa, ashtu si nëntëdhjetë për qind e kastravecit është e përbërë prej ujit, nëntëdhjetë për qind e jetës së tyre ishte e përbërë nga fyeren dhe zilitë.

Nëntëdhjetë për qind ujë, përsëriti me vete nënprefekti. Edhe të tilla dinte Dullë Baxhaja. Ky njeri ka qenë i prerë për kryetar akademije dhe jo për spiun.

Kështu mund të mendonin ata, shkruante përgjuesi, por zotit nënprefekt me siguri i kujtohej mirë se ishte pikërisht Dullë Baxhaja ai që me një këmbëngulje që disa herë mund të kishte qenë e bezdissħme për zotin nënprefekt, kishte kërkuar ardhjen e përgjuesit nga kryeqyteti.

Jo, asnjë nga këto nuk qëndronte, vazhdonte letra. Dhe tani, për të mos e zgjatur më,

Dullë Baxhaja në mënyrë të qartë e të ndershme po e tregonte shkakun e kërkesës për dorëheqje. Më 11 mars ora 11 paradite, pas shtatë vjetësh shërbimi si përgjues i shtetit mbretëror, për herë të parë ai kishte fjetur në detyrë.

Ah, ja si qenka puna, mendoi i lehtësuar nënprefekti. Dihej se gjysma e nëpunësve të N. ia hiqnin gjumit gjatë orarit zyrtar, sidomos në stinën e verës. Mirëpo Dullë Baxhaja ishte i çuditshëm. Për ta bërë sa më tragjike frazën, ai e kishte rrethuar atë me vija të zezu, si të ishte një lajmërim vdekjeje.

Askush nuk e kishte parë këtë, vazhdonte shpjegimin e tij përgjuesi. Ai mund të mos tregonte, aq më tepër që kishte qenë i vetëm sipër tavanit të hanit «Rrashti i Buallit». Ai mund ta fshihte, por Dullë Baxhaja s'ishte i tillë. Ai s'kishte fshehur askurrë asgjë nga shteti i tij. I pakontrolluar nga askush, përveç ndërgjegjes së vet, ai kishte bërë rregullisht për vite me radhë të gjitha stërvitjet që duhet të bëjë përgjuesi në vetmi: mprehjen e dëgjimit në kushte të vështira dhe tejet të vështira: në erë, shi, bubullima, dallgë deti, uturimë pérroi apo lehje qensh, krokama korbash, klithma qyqesh etj. Ai s'kishte lejuar ta kaplonte gjumi as në netët plot zabullimë të verës, as në ngricat e dimrit, as pas dyzet e tetë orësh pa gjumë; as në tavanet, poshtë të cilave vinte gérhitja gjumëndjellëse e viktimave. Veç kësaj,

Dullë Baxhaja në raportet e tij kishte dhënë përherë me saktësi ato që kishte parë e kishte dëgjuar, pa shtuar apo pa pakësuar kurrë asnjë, pa bërë kurrë dredhira e hilera. Në fshehtësi dhe heshtje e kishte bërë punën, ashtu siç është detyra e përgjuesit, por, sa më i fshehtë e i padukshëm kishte qenë për të tjerët, aq i hapët kishte qenë pérherë me shtetin e vet mbretëror. Kështu që atij s'mund t'ia fshihte atë që i kishte ndodhur në paraditen e 11 marsit.

Nënprefekti lëshoi një psherëtimë përparrë se të vazhdonte leximin.

Më 11 mars, shkruante më poshtë përgjuesi, në orën 11 paradite, ndërsa ndodhej i shtrirë si zakonisht në tavanin e dhomës së hanit «Rrashti i Buallit», poshtë të cilit dy irlandezët kishin kohë që dëgjonin regjistrimin e një lahu-tari, ai kishte dëgjuar befas një zhurmë karroce në oborrin e prapmë të hanit. Ç'ishte kjo karrocë, kishte pyetur vetveten ai, nga kishte dalë, pse nuk e kishte parë më pérpara? Kishte fërkuar sytë, duke kujtar se kishte dremitur një çast, por s'kishte qenë dremitje. Kishte qenë gjumë, pra, turp i vërtetë. Dhe kishte qenë i tillë, saqë, edhe kur zhurma e karrocës e kishte zgjuar, ai ende s'kishte ardhur dot në vete dhe ashtu të mbështjellë me mjegull kishte parë një grua që po hipte në karrocë e po largohet.

Ishte e tepërt të zgjatej duke i treguar zotit nënprefekt tronditjen që ndjeu. S'ishte puna vetëm se nuk e kishte njohur gruan dhe se i kishte shpëtuar biseda që ndoshta ajo kishte bërë me viktimat. Në fund të fundit, ende s'dihej nëse ajo ishte takuar ose jo me ta. Dhe, përsa i përket fytyrës së saj, ajo mund të gjendej më vonë. Jo. S'ishin këto arsyet e tronditjes. Katastrofa kishte qenë e brendshme. Përgjuesi e ndiente veten të përshkuar prej saj si ena që ka marrë krismën tejetej. Vuajtja e tij ishte çnjerëzore, brerja e ndërgjegjes ulëritëse, kriزا e pandreqshme. Ai s'kërkonte as falje, as ngushëllim. Këto s'do të bënin gjë tjetër veç do t'ia shtonin edhe më vuajtjen. Ai kërkonte vetëm një gjë: tërheqje dhe harrim. Prandaj dhe po i paraqiste zotit nënprefekt në formë zyrtare dhe të prerë kërkeshën e tij për dorëheqjen nga detyra e përgjuesit të shtetit.

Për një kohë të gjatë nënprefekti mbeti me sytë mbërthyer te nënshkrimi i njohur i përgjuesit. Një ndjesi pikëllimi ia squlli gjendjen shpirtërore. Ç'ishte kjo kërkeshë për dorëheqje kështu? Vërtet ishte punë vrasje ndërgjegjeje apo në të fshihej diçka tjetër?

Mendime të zymta e të paqarta, duke mbuluar njëra-tjetrën si retë e shiut, po e përshkon turbull. Cila të ishte vallë ajo grua? Keqardhja që s'do të merrte më raporte nga Dullë Baxhaja, një keqardhje e mprehtë, me një shi-

je tē harruar rinie, thua se po merrte fund një dashuri, përzihej me dyshimin se vërtet Dullë Baxhaja nuk e kishte njohur atë grua apo bënte ashtu pér tē mos treguar kush qe.

Nënprefekti e ndiente kokën tē trazuar si pas një sëmundjeje. Tërheqje dhe harrim, përsëriti fjalët e tjetrit. I dukej se Dullë Baxhaja po tërhiqej ngajeta reale pér t'u rishfaqur përsëri më vonë si mysafir misterioz, profet apo pretendent i fronit mbretëror. Zot, çdo gjë mund tē pritej prej tij. Nganjëherë i dukej se mund tē ngjitej në sfera tē panjohura ireale pér t'u shndërruar në përgjues tē përgjithshëm tē botës. Kjo ide e fundit e rrëqethi. E ndiente se po mendonte marrëzira, por s'e ndalonte dot veten. S'ishin tē kota ato filozofi tē përgjuesit pér syrin e botës atje në stepat e Kashmirit.

Papritur, nënprefekti u kujtua se ai nuk e kishte parë kurrë Dullë Baxhanë. Vité me radhë kishte lexuar raportet e tij pa e ditur ç'pamje kishte dhe pa i dëgjuar kurrë zërin. Pa e parë, pa e dëgjuar kurrë, mendoi ngrirazi dhe fill pas kësaj gati sa s'thirri: po a ekziston vallë?

Nënprefekti u ngrit me vrull nga karrigia pér tē ndërprerë këtë marrëzi tē re.

## X

Mbi retinën e syrit, që ashtu i palëvizshëm siç ishte të zgjonte keqardhje, pika e lëngut të kthjellët u duk sikur e dyzoi pikëllimin. Pas saj ra pika tjetër dhe pastaj tjetra, dhe pas se cilës pikë retina humbte nën lëngun e dridhshëm.

— E? — tha Maksi, duke mënjanuar dorën në të cilën mbante shishen e vogël me lëng.  
— I ndien sytë më mirë tanë?

— Besoj se po, — tha Vili.

Pas katër ditësh që mjekohej me një lëng për uljen e tensionit të syrit, që porsa kishte dalë dhe që, për habinë e tij, e kishte gjetur në një nga farmacitë e Tiranës (thuhej se nëna mbretëreshë me vështrim të dobësuar qe bërë

shkak për ardhjen e tij), Vilit i dukej se sytë po i qetësoheshin disi.

Kjo kishte bërë që t'u rikthehej të dyve optimizmi i zbehur disi për shkak të sëmundjes. Kthjellimi nga pak i kohës kishte ndihmuar për këtë, dhe në mëngjes Vili kishte thirrur gjithë gëzim:

— Maks, shiko një zog, po fluturon drejt Bjeshkëve të Nemuna apo jo?

Maksi kishte zgjatur kokën nga dritarja:

— Pikërisht andej po ikën. Ç'mrekulli, Vili.

Vili e kuptoi se fjalët e fundit kishin kuptim të dyfishtë. Ç'mrekulli që Vili arrinte të dallonte një zog në fluturim dhe aq më tepër drejtimin e fluturimit të tij. Dhe e dyta që shenjat e afrimit të pranverës ishin tanë të sigurta. Në Bjeshkët e Nemuna gjatë shumicës së vitit s'fluturonte zog, ndaj dhe quheshin ashtu.

— Ç'mrekulli, Vili, — përsëriti Maksi duke fërkuar duart.

Shtegtimi i tyre në bjeshkë që për shkak të sëmundjes së Vilit që dukur ca kohë si i dyshimtë, tanë po bëhej prapë i mundshëm. Madje kishin biseduar me Shtjefnin për pajtimin e një karroce dhe për mundësitë që Martini t'i shoqëronte në udhëtim.

Shtegtimi do të ishte me të vërtetë kuro-rëzimi i punës së tyre. Kishin adresat e një-

mbëdhjetë rapsodëve, shumicën e të cilëve do t'i regjistrin për herë të dytë e disa për herë të tretë.

Veç kësaj një shpresë e turbullt, ndonëse kundër çdo logjike, i mbante ende se mund të gjenin ndonjë belbëzim të fundit të eposit për një ngjarje më të vonshme se viti 1913. Gjersa për vitin 1878 ai kishte dhënë dymbëdhjetë vargje, dhe tridhjetë e ca vjet më vonë, më 1913, pesë vargje, përsë të mos shpresohej që tani, pas njëzet vjetësh, të jepte së paku dy-tri vargje? Në fund të fundit për moshën e eposit këta dhjetëvjeçarë, që njerëzve u dukeshin shumë, s'ishin veçse grimca kohe: disa minuta përpara, disa minuta më pas.

E dinin se kjo s'ishte veçse një shpresë e kote. Eposi qe përmendur vërtet nga letargjia më 1913, por qe një mynxyrë e tmerrshme që kishte arritur ta zgjonte: copëtimi i vendit. Kurse historia e mëpastajme e Shqipërisë ishte e sheshtë e banale. Madje mund të thuhej se kohë më të mirë për vdekjen e eposit as që mund të gjendej.

I kishin biseduar të gjitha këto dhe, për habinë e tyre, prapë shpresonin për një epevent, siç e quanin midis tyre, me një fjalë që nuk ekzistonte, ngjarjen bashkëkohore të kthyer në epos.

Ndjenja e shqetësimit që u shkaktonte më parë gjendja e hallakatur e eposit, qe zëvendë-

suar tani nga siguria që ai ishte tashmë i sistemuar. Ai që dukej në fillim i pambledhshëm, i thërrmuar nëpër hapësirë e kohë, jele ylberesh, erë e shkumë, ishte tani i ndryrë në arkat metalike me numra përsipër. Nganjëherë u dukej e pabesueshme si kishin mundur ta shtrohin gjithë atë furi dhe tërbim.

Asnjëherë Dezi nuk e kishte vënë re me ag hollësi rrugicën me pllaka që vinte nga porta e jashtme, përmes oborrit te dera e shtëpisë. Binnte shi dhe pllakat jepnin një ndriçim të marrtë, shqetësues. Ajo i njihte ato një për një, sidomos në ditët me shi, e dinte mirë se cilat prej tyre, ngaqë kishin lëvizur, mund të të spërkatnin çorapet, ndaj dhe u shmangej pa gabuar asnjëherë. Mirëpo kështu nga lart, nga kati i dytë i shtëpisë nuk i kishte vërejtur kurrë imtësisht. Madje tani e kishte të vështirë të gjente se cilat prej tyre mund t'i spërkitnin pantallonat të panjohurit që do të ecte sipër tyre.

Përgjuesi i anglishtes duhej të vinte pas një çerek ore. Një i panjohur, në shtëpinë e saj, në orën njëmbëdhjetë paradite, pa dijeninë e të shoqit... Por rrëqethja vazhdonte vetëm disa sekonda. Jo pa njëfarë keqardhjeje truri i saj plotësonte me shpejtësi kuadrin: i panjohuri vinte i thirrur prej saj për diçka të veçantë,

që lidhej me profesionin e tij.

S'e kishte pasur lehtë të merrte vendimin për t'i shkruar pusullën e shkurtër me fjalët: «Dëshiroj t'ju takoj për diçka të rëndësishme. Ju lutem, gjithçka të mbetet midis nesh.»

Kjo kishte ndodhur një javë më vonë, pasi kishte bërë një përpjekje të pasuksesshme për t'i takuar irlandezët në hanin «Rrashti i Ballit». Ajo ecje me karrocë nëpër rrugën automobilistike të Veriut, gjoja për të parë afreskun e kishës së shën Marisë, ndalimi i karrocës përpara hanit dhe hyrja e saj atje gjoja për të pirë ujë, fjalët e pakta të këmbyera me bujtinarin dhe kthimi sërishmi te karroca, të gjitha këto i vinin në mend turbull, thua se nuk kishin ndodhur vërtet, por qenë përfytyruar midis dremitjes.

Pasi përpjekja për t'i takuar rastësishht të huajt i kishte dështuar, gjithë atë javë ju kishte vrarë mendjen për të gjetur mënyrën si të komunikonte me ta. Të provonte edhe një herë me karrocë, do të zgjontë me siguri dyshime te bujtinari; të merrte me vete gruan e drejtorit të postës, prapë nuk guxonë. Një herë mendoi t'u shkruante një letër të shkurtër dhe t'ua dërgonte me shërbyesen, të vetmin njeri besnik që kishte. Duke menduar për letrën, mendja i kishte shkuar prapë te përgjuesi i anglishtes. Po sifikur të takohej drejtpërdrejt me të? Në fund të fundit ai ishte çelësi i gjithçkaje, alfa dhe

omega e kësaj pune. Mendimi iu duk tërheqës si çdo projekt i guximshëm. Përgjuesi ishte vërtet çelësi i të gjithave. Veshi i tij ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me ta. Dhe në qoftë se vërtet ata kishin folur për të, me anglishten e tyre të mrekullueshme, kush tjetër veç atij mund t'ia tregonte asaj këtë? My lord... My love... Dalëngadalë ky mendim i fundit i errësoi gjithë të tjerët. Dhe pavarësisht se ende nuk donte t'ia pohonte vetes, ajo e ndiente se motivi kryesor i gjithë veprimeve të saj dhe shtytja për t'ia shkruar më në fund pusullën përgjuesit të anglishtes, ishte pikërisht ky. Natyrisht, thoshte me vete në çastet e rralla të kthjellimit, ata janë shtetas të huaj, kështu që nuk u kërcënohet asgjë. Megjithatë, e dëbonte shpejt këtë mendim dhe në pjesën më të madhe të kohës, madje edhe tanj që nga çasti në çast priste të hapej porta e oborrit, asaj i pëlqente të mendonte se po i shpëtonte ata të dy nga rreziku.

Ora pothuajse ishte njëmbëdhjetë dhe në çdo sekondë përgjuesi i anglishtes mund të shfaqej.

Më vonë, kur e kujtonte ardhjen e tij, ajo i rindërtohej në mendje në dy variante. Në të parin ai hynte ngadalshëm dhe syri i saj që nga dritarja kapte me imtësi çdo hap të tij, si kamera e ngadalësuar që jep hollësisht lëvizjet e personazhit. Shtytja e kanatit të portës, shkelja me radhë e pllakave të lagura, rënia e

ziles së brendshme, ngjitja e shkallëve, pastaj takimi i parë i syve të tyre dhe fjalët e tij: zonjë, jam tepër i gëzuar që më jepet rasti t'ju shërbej.

Në variantin e dytë, rruga e tij nga portat e kati i dytë i shtëpisë i njajtë më tepër një notimi në erë, që e sillte atë drejt saj, me atë shikim të ndezur nga kureshtja, pëlqimi dhe diçka tjetër, midis sigurisë dhe pafytyrësisë. O zot, tamam sy përgjuesi, kishte menduar ajo. Dhe pastaj fjalët: zonjë, jam i lumtur që mund t'ju shërbej.

Ishte dhe nuk ishte ashtu siç e kishte përfytyruar ajo. Flokët e lëmuar nxinin rrezikshëm, si të ishin të bërë nga e njëjtë materie, si edhe sytë e tij. Ajo s'kishte parë kurrë një njeri, sytë dhe flokët e të cilit të ishin në një marrëveshje të tillë. Sy përgjuesi të shartuar me ata të mikluesit. Nga mënyra si e vështronë asaj iu duk se ai kishte dëgjuar diçka për të në bisedat e dy të huajve. Po, po, ishte tamam një shikim gjithë nënkuptim, si ai që vendoset midis dy njerëzve që i lidh një e fshehtë. Dëshira për të dëgjuar sa më parë prej gojës së tij atë që ishte thënë për të zotëroi mbi gjithçka. Sikur të mos ishte e përbajtur nga natyra, ajo, pa e bërë të gjatë, do t'i lutej atij në çast: të lutem, më thuaj sa më shpejt, ashtu siç i ke dëgjuar, në anglisht (përkthimin ma bëj më vonë), gjithçka, gjithçka që ata kanë thënë për mua.

Por Dezi ishte e përmbajtur. Ajo nisi t'i liste larg e larg. Më vonë, kjo pjesë e takimit të tyre i kujtohej akoma më turbull. Madje prej tij nuk i kujtohej asgjë e saktë përveç faktit që, ndërsa ajo i liste, sytë e tij shkëndijonin si dy thëngjij që i përpushte herë pas here dikush, kurse ajo mendonte: ai di pér mua më shumë se ç'e mendoj unë.

— Dy të huajt e ardhur këtu unë i njoh, — tha më nō fund ajo me zë të dobët. — Ndoshta ju duket çudi se në ç'rrethana, por...

— Zonjë, — e ndërpreu ai me zë të ulët, si të kishte kujdes mos zgjonte dikë nga gjumi, — e shoh që e keni të vështirë të flisni, por kini parasysh që unë jam mësuar me gjëra të tilla.

— Ah, po, — tha ajo dhe ngriti sytë. Vështrimi i tij ishte fare pranë saj dhe pështjellshëm asaj i erdhi ndër mend grumbulli i historive që kishte dëgjuar pér të. Natyrisht, mendoi dhe buzëqeshi dobët. Dora e tij kapi me kujdes të sajën.

— Ju jeni e bukur.

— Si guxoni? — tha ajo duke kapsallitur sytë.

Pa ia lëshuar dorën, ai kërkonte të gjente vështrimin e saj.

— Zonjë, në saje të profesionit tim, kaq herë më ka rënë rasti që...

— Ah, e di flasin pér ju.

Ai buzëqeshi. Zëri iu bë fare i ulët.

— Shumë zonja të shquara që të tjerëtën dërrojnë t'i përshëndetin nga larg, unë kam pasur rastin t'i sodis të zhveshura në banjat apo dhomat e gjumit... Ndoshta edhe ju vetë, kur keni ardhur në kryeqytet, në hotel «Kontinental».

O zot, ia bëri ajo me vete. Kishte bujtur vërtet në atë hotel. Ky mendim ia mpiku një pjesë të trurit. Në qoftë se ai e kishte parë vërtet lakuriq, atëherë... Çfarë? Çfarë, ia bënte ende një zë brenda saj. Në qoftë se e kishte parë të zhveshur, kjo ishte gati njëlloj sikur...

Ai po u merrte erë flokëve të saj, po ajo nuk kuptonte më asgjë. Ndiente nevojën të mbështetet diku. Gjithë mendimet i qenë mbësh-tjellë në një pikë. Në qoftë se kishte ndodhur vërtet ajo që ai thoshte, atëherë çdo gjë tjetër sishte veçse një çështje forme.

Ndjeu duart e tij te beli dhe, në vend që ta shtynte, siç kishte kujtar ende gjer në atë çast, e la veten të tërhiqej prej tij.

Iku, tha Dezi me vete kur dëgjoi përplasjen e derës së jashtme. Hodhi diçka krahëve dhe ashtu e zhveshur siç ishte iu afrua dritarës dhe mënjanoi perden. Jashtë shiu curiste njëlloj si më parë sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Së paku të kishte marrë vesh së ç'thoshin ir-

landezët për të, mendoi krejt e mpirë. S'kishte arritur as ta pyeste. Po tani kjo nuk i interesonte edhe aq. Diçka qe zbruzur në tërë qenien e saj. S'donte të mendonte asgjë. Me hapa të ngadaltë shkoi në banjë, hapi ujët e ngrohtë dho u fut në vaskë.

Kur erdhi i shoqi për drekë, ishte ende aty.

Ndërsa ajo shtronte tryezën, ai nisi të tre-gonte diçka për fejesën e mundshme të mbretit me një konteshë hungareze.

— Ti se ç'ke, — tha ai, kur pa se biseda, për habinë e tij, nuk po e tërhiqte. — Të dhemb koka?

— Po, — tha ajo. — Gjithë mëngjesin s'më ka lëshuar.

Ai uli kokën mbi pjatë, me ndjenjën e zakonshme të fajit sa herë që bëhej fjalë për këdhimbjen e saj. E dinte se shkaku kryesor i saj ishte mungesa e fëmijës.

Dreka kaloi me ca fjalë të rralla, pastaj ajo tha se do të shtrihej, kurse ai, pasi pushoi pak, u nis prapë për në zyrë.

Në darkë u përsërit e njëjta gjë, me të vëtmin ndryshim që në vend që të shkonte në zyrë, ai u mbyll në dhomën e punës, kurse ajo u shtri prapë në shtrat.

U përpoq të flinte, por kjo ishte e pamundur. E kuptoi se kishte përpara një natë të pagjumë të copëzuar nga goditjet e orës prej bronzi; të cilat sa vinte e bëheshin më të dridh-

shme e të vëtmuara. Nuk ishte në gjendje ta kuptonte se ç'e shkaktonte pagjumësinë e saj. Ishte hera e parë që tradhtonte të shoqin, me gjithatë i dukej se nuk ishte vrasja e ndërgjegjes që e mundonte. Ishte diçka tjetër dhe pikërisht ajo zbrazëtia e padurueshme, që dukej sikur e kishte zëvendësuar krejt. Nga vinte valë, pse? Njëherë i erdhi të qeshte hidhtazi me vetveten: pa dyshim që dihej se nga vinte: kishte ëndërruar tjetër gjë, një lidhje me homoristin e huaj, gjuha angleze etj. etj. dhe kishte përfunduar në krahët e një përgjuesi. Dhe të kujt pa. Të atij që spiunonte të ëndërruarin e saj. Ishte me të vërtetë makabre.

Sikur të mos mjaftonte kjo, qysh tanë i përfytyrohej skena e ardhshme te gjinekologu, sytë e tij të përgjumur të zgjuar më në fund nga kureshtja: me cilin?... Jo, thirri me vete, kurrë s'do t'ia tregonte të vërtetën. Do të shpikte gjithfarëlloj historish, përrallash romantike, aksidentesh... (gjysmë e dehur, në një ballo dhe veç kësaj rastësisht, rastësisht, rastësisht), vetëm të vërtetën për përgjuesin nuk do t'ia tregonte. Ky mendim sikur e qetësoi disi. Goditja e tëmthave po i rrallohej. Ndoshta s'jam shtatzënë, mendoi duke e ndier se po qetësohej edhe më. Ishte alarmuar ndoshta para kohe. Në fund të fundit s'ishte as e para, as e fundit që e bënte. Gjysma e filmave a s'ishin me këtë, duke mos llogaritur librat? Ana Karenina dhe

Greta Garbo dhe të tjerat që s'po i kujtonte dot, ah, ta zinte më në fund gjumi, në të vërtetë dhimbja e kokës po e lironte dhe kjo ishte një mrekuli, vetëm se tëmthat... Ç'ishte kjo goditje Mizore... që përsëritez si kambanë... tashmë jashtë tyre... Ajo e rrasasi kokën në nën-kresë, me një shpresë të fundit se do ta shuanë rrahjen e tëmthave në të, në kohën që ndjeu se i shoqi, sikur ta ndiente ç'ndodhët në kokën e saj, lëvizi. Ishte e mundur një gjë e tillë, që ai ta kishte kuptuar, apo mos e gjithë kjo po vinte vërtet që jashtë për t'u përzier me ankthin e saj? E kishte kokën ende të turbullt, kur dëgjoi zërin e të shoqit:

— Dikush troket.

— Si? — ia bëri ajo, pa kuptuar ende as gjë, vetëm ndiente lëvizjen e krahut të tij që po zgjatej për të ndezur abazhurin, dhe pastaj, kur drita u ndez, zërin e tij, që nën dritë tingëlli i krejt ndryshe:

— Dikush po troket.

Trokitjet dëgjoheshin tanë qartë dhe midis tyre u ndie zëri i dikujt. «Zoti nënprefekt, zoti nënprefekt!»

Ky zë... tha ajo me vete e llahtarisor, pastaj shkundi kryet si për ta hequr që andej atë marrëzi, në kohën që i shoqi, që kishte brofur ndërkaq në këmbë, po i afrohej dritates.

— Zoti nënprefekt, zoti nënprefekt! — u dëgjua prapë që jashtë, këtë herë më shkodër.

— Përgjuesi i anglishtes, — tha ai i shtangur. — Diçka ka ndodhur.

Me sy të çakërritur ajo ndiqte lëvizjet e tij nëpër dhomë tek kërkonte këmishën, pastaj pantallonat dhe xhaketën.

— Mos, — dënesi ajo papritur me një zë të çjerrë, të huaj, saqë ai, sado i trallisur që ishte, e vështroi dy-tri sekonda si të mos e besonte se klithma qe e saj. — Mos dil.

Stuhishëm në mendjen e tij vërtiteshin variante të ndryshme të shkakut përse ai mund të kishte ardhur në këtë orë të natës. Asgjë e mirë s'mund ta shtynte të trokiste kështu, duke thërritur. O zot, o perëndi, rënkonte ajo me vete, ç'është kjo gjëmë. Mos vallë i shtyrë nga një dell marrëzie vinte për ta rrëmbyer apo për t'i treguar të shoqit ç'kishte bërë më të, për ta bindur që ta linte, për ta përbuzur, apo për t'i tallur të dy, apo ndoshta për ta vrarë ose për t'i kërkuar ndjesë burrit të saj. Të gjitha këto i dukeshin aty për aty aq të mundshme sa edhe të pamundshme. Mos vallë ishte penduar për atë që kishte bërë, apo ndoshta edhe më keq, në krizën e një vrasjeje ndërgjegjeje idiote, si nëpunës i bindur që mund të ishte, vinte t'i tregonte shefit se kishte shkelur rregullat e shtetit, duke dhënë sekretet për një çast dëfrimi... Po unë s'i kërkova asgjë, madje s'arrita as t'i tregoj përse e thirra, mezi mundi të arsyetonte ajo. Të gjitha

këto vazhdonin t'i vërtiteshin shkapërderdhazi në tru, tek ndiqte me sy të shqyer të shoqin që po vishej.

— Mos dil, — tha për herë të dytë.

— Dezi, mos u tremb, — tha më në fund ai, duke u shkëputur nga shtangia e tij, që, me gjithëse e llojit tjetër, nuk ishte më e paktë.  
— Diçka ka ndodhur, pa dyshim, po ti mos u tremb.

Ajo nuk arriti të thoshte prapë «Mos dil», se ai ishte ndërkaq në shkallë. Tani mbaroi, mendoi ajo. Tani e keqja s'pengohej dot.

Me një vrull u hodh nga shtrati dhe iu afrua dritares. U dëgjua prapë trokitja dhe pas saj zëri «zoti nënprefekt» këtë herë i ngjirur. Apo hapi dritaren. Ajri i ftohtë gjithë shi, ia akulloi këmishën e natës. U dëgjuan hapat e të shoqit, pastaj kërkëllima e llozit të hekurt, që e bëri atë të dridhej. U mbajt pas parvazit që të mos binte, në kohën që zërat e të dy burrave po përziheshin te pragu i portës. Ishte e pamundur të merrej vesh ç'thoshin. Fjalët ishin të mbështjella me dihatje, ofshama marrëzie ose urrejtjeje.

Tani po afroheshin drejt derës së brendshme dhe s'ishte aspak çudi që të dëgjoheshin krismat e revoleve. Ajo vazhdonte të rrinte e ngjitur pas dritares, si njeriu që pret dënimin. Shkallët kërcisin rëndshëm nën hapat e tyre. Nga çasti në çast ajo priste të shtynin derën

e dhomës së gjumit, por në vend të saj u hap dera e studios. U dëgjua rrotullimi i diskut të telefonit dhe fjalët e të shoqit: «Alo, xhandarmëria!»

Si?, desh klithi ajo. Të përfundonte e gjitha në mënyrë kaq banale. Kur qenë marrë vesh kaq shpejt? Jo, s'ishte e mundur. Nga studioja vinin fjalët e të shoqit: «Urgjent, dhjetë xhandarë të mirë, menjëherë.»

Ajo s'arriti të mendonte më asgjë, kur dera e dhomës së gjumit u hap vërtet. Dy-tri sekonda ai nuk foli, siç duket ngaqë vështrimi i tij e ndjeu se shtrati ishte bosh. Pastaj e dilloi me sa dukej siluetën e saj.

— Ka ndodhur diçka e tmerrshme, — tha ai.  
— Unë po shkoj menjëherë.

— Si? Çfarë?

— Atje te hani... I kanë sulmuar irlandezët ca të panjohur.

— I kanë vrarë?

— Jo. Ndoshta i kanë plagosur. Unë po iki.

Ti fli.

Ai mbylli derën dhe ajo prapë iu afrua dritarës. Megjithëse dridhej e gjitha, qëndroi aty gjersa zérat e njerëzve, bashkë me zhurmat e dy makinave, humbën në largësi.

C'natë e çmendur, mendoi duke vënë duart te tëmthat, me sytë gjysmë të mbyllur. Ndërsa me vete thoshte: se mos dita kishte qenë më pak e çmendur.

Kur nënprefekti u kthyte ndaj të gdhirë, ajo që i tregoi Dezit ishte krejt kaotike. Ndërsa ai fliste, Dezit iu duk se tregimi i tij në vend që të ndriçohej disi, po humbte edhe fijen e fundit të qartësisë.

Dezi dy-tri herë hapi gojën të pyeste, por ai nuk e la:

— Mos më pyet. As unë s'mora vesh gjë të qartë. Ishte një marrëzi e tillë, uf, një lesheli, mister. Unë do të fle ndonjë orë të mbledh veten. Koka po më çahet dysh.

Ajo e priti gjersa të zgjоhej për të marrë vesh ndonjë gjë më të saktë, por s'qe e mundur. Ai qe bërë edhe më i errët, thuajse kishte fjetur për të përligjur disi gjithë atë lëmsh. Do të besoje se as vetë s'qe në gjendje të dallonte nëse ato që thoshte kishin ndodhur vërtet apo një pjesë i kishte parë në ëndërr. Ishte kaq e pabesueshme, saqë një herë Dezi dyshoi se mos bënte vetë ashtu dhe mendja e saj, aty për aty, sajoi një hamendje të tërë se mos përgjuesi i anglishtes kishte gjetur kohën gjatë rrugës... Por e hoqi përfundimisht atë dyshim kur tringëlliu telefoni dhe ngatërresa, e zmadhuar tani nga telat telefonikë, ndihej se fryhej e mbështillte çdo gjë.

E vërteta ishte se edhe më vonë kur gdhieu dita dhe erdhën raportet e para dhe pastaj procesverbalet dhe dëshmitë dhe më vonë ak-

ma, kur të gjitha këto u renditën në dosjen gjyqësore, madje një pjesë doli edhe në shtyp, nuk u sqarua ndonjë gjë e madhe në krahasim me atë çka i tregoi nënprefekti së shoqes në mëngjesin e ditës së paharruar. Madje Dezit i dukej se ishte përherë po ai rrëfim, vetëm se i rreshtuar më me kujdes, sidomos nga pikëpamja gjuhësore.

Ngjarja, sipas raporteve dhe dëshmive të ndryshme (ndër të cilat kryesorja mbetej gjithmonë ajo e përgjuesit të anglishtes), duhej të kishte ndodhur pak a shumë kështu:

Rreth orës dy të natës, përgjuesi i anglishtes, i cili, për arsyet e braktisjes pa asnje shpjegim të postit prej Dullë Baxhasë, kishte qenë i detyruar ta zëvendësonte atë në tavannin e dhomës së dy irlandezëve, kishte dëgjuar në fillim një zhurmë dhe pastaj një klithmë të fuqishme. Kjo klithmë vërtetohej prej të gjitha dëshmive, veçse shpjegimet për të ishin të ndryshme. Ndërsa përgjuesi i anglishtes shkruante në raportin e tij se klithma i qe dukur si e Martinit (kjo bëhej sidomos e besueshme prej faktit që Martini qe plagosur i pari prej sulmuesve), të tjerë, duke përfshirë këtu edhe Martinin, dëshmonin se klithma ishte e tjetër-kujt. Disa thoshin se klithmën e kishte lëshuar ndonjë nga bujtësit e shkelur ndoshta në terr prej mësymësve, të tjerë ngulnin këmbë se përkundrazi kishte klithur dikush prej band-

tëve për arsyetë ndonjë gjërvishtjeje, apo të kundërgoditjet në terrë të Martinit, apo thjesht për të krijuar psikozë histerie përpara mësimyjet. Shtjefni mendonte se kishin klithur irlandezët, gjë e natyrshme për t'u besuar prej të gjithëve, sikur Martini të mos ngulte këmbët se klithma ishte dëgjuar përpara se banditetët të shqyjenin derën e të huajve. Kishte edhe nga ata që dyshonin se kishte klithur vetë përgjuesi i anglishtes.

Duke shfletuar dosjen, nënprefekti që habitur gjithmonë se përsë prej gjithë të pranishmëve në han natën e ngjarjes, klithmës së dëgjuar i jepej një rëndësi aq e madhe, kurse në të vërtetë ajo nuk kishte kurrfarë dome-thënieje për çështjen. Ai ua shfaqi këtë mendim dëshmitarëve, por ata e vështruan me ca sy të tillë sikur ai të fliste një idiotësi të papërfytyrueshme dhe ai u bind se nuk do të merrej dot vesh kurrë me ta për punën e saj. Në të vërtetë sa vente ai po bindej se nuk kishte klithur askush, dhe se ajo që secili kujtonte se kishte dëgjuar prej tjetrit nuk ishte veçse kli-thma e brendshme e atij vetë.

Kështu, pra, pas klithmës ose së ashtuqu-ajturës klithmë nga dera e hanit kishin shpër-thyer brenda një grup të panjohurish, që disa çaste pas fillimit të rrëmujës u morën për banditë, vrasës, ose të ikur nga çmendina. I pari që u përllesh me ta ishte Martini, të cilin

e plagosën në kokë me një shufër hekuri. Disa nga bujtësit kishin armë, por asnjë prej tyre s'mundi të shtinte për shkak të errësirës, hutimit dhe frikës se mos vriste gabimisht dikë. Bujtinari Shtjefën kishte arritur të ndizte llambën e vajgurit, por aty për aty, dikush, me siguri ndonjë prej banditëve, ia kishte thyer llambën mu në duar, megjithatë në sekondat e pakta që llamba bëri dritë ai mundi të njihet ftyrën e heremtit Frrok, njojje kjo fatale për mësymësit. Midis territ dhe rrëmujës, duke shkelur, siç u mor vesh më vonë, mbi trupin e Martinit të plagosur, ata u sulën te shkallët e drunjta për t'u ngjitur në katin e dytë drejt dhomës së irlandezëve, gjë që tregonte një synim të paracaktuar. Në kohën që po shpërthenin derën, irlandezët filluan të thërrisin «Ç'po ndodh!», «Kush troket», «Ndihmë!». Përgjuesi i anglishtes, që ende në atë çast ndodhej mbi tavanin e dhomës së tyre, dëgjoi gjithçka që ndodhi më pas: shpërthimin e derës, ulërimat e përziera të mësymësve dhe të viktimateve, ofshamje, mallkime si dhe goditjet e diçkaje metalike. Pikërisht në atë çast ai e braktisi postin e përgjimit dhe, duke u hedhur nga dritarja në oborrin e prapmë të hanit, u nis me vrap drejt qytetit për të lajmëruar për ngjarjen.

Kur nënprefekti me xhandarët kishin arritur te hani, kishin gjetur atje një pamje të

pabesueshme. Nën dritën e llambës së vetme me vajguri që kishte mbetur pa u thyer du-keshin ende gjurmët e vandalizmit të mësy-mësve. Përveç ndihmësit të bujtinarit, Martinit, qenë goditur gjithashtu në rrëmujë e sipër disa nga bujtësit, si edhe njëri prej dy të huajve. Tjetri kishte zënë kokën me duar dhe qante. Materialet e tyre, sidomos aparati i regjistrimit, qenë shkatërruar krejt. Ky i fundit kishte qenë me ç'dukej veçanërisht synim i mllefit të tyre. Përveç që e kishin thyer në mënyrën më barbare, kishin copëtuar pjesën më të madhe të bobinave, disa i kishin shqyer, u kishin nxjerrë telat, ua kishin këputur, shkulur dhe shkapërderdhur andej-këndej.

E gjithë kjo kishte vazhduar për pak kohë. Sapo bujtësit kishin ardhur në vete nga tronditja, mësymësit qenë larguar nëpër terr. Sipas mendimit të bujtinarit, në kohën që nën-prefekti me xhandarët kishin arritur banditët duhej të ishin ende në ikje e sipër. Njëri prej tyre duhej të qe plagosur në kohën që bujtësit kishin qëlluar me pushkë bandën që po ikte, (britmën e tij e kishin dëgjuar të gjithë), kësh-tu që zoti nënprefekt me pak përpjekje mund të kapte një pjesë të bandës.

Në çastin që nënprefekti po u jepte urdhrat e nevojshëm xhandarëve për të nisur ndjekjen në mënyrë që banditët të kapeshin pa arritur dot bjeshkët, bujtinari Shtjefën qe kujtar t'i

jepte atij dëshminë tepër të rëndësishme se kishte njohur midis vandalëve ftyrën e heremitit Frrok.

Ndjekja e banditetëve kishte nisur në çast. Për satin e keq të tyre hënëzonte pak, kështu që xhandarët nuk e patën të vështirë që nga xhadeja, ku makina e tyre ecte me drita të shuara, të dallonin që larg siluetat e tyre. Të parët që u kapën qenë i plagosuri me dy të tjerët që e mbanin. Të tjerët u kapën më larg, pikërisht në këmbët të bjeshkëve, kurse eremitin Frrok e gjetën në shpellën e tij në një gjendje delirante.

Në mëngjes herët gjithë N. e kishte marrë vesh ngjarjen. Në rrugën e burgut ku pritej të kalonte banda e çmendur, veprimet e së cilës ende dukeshin të shtyra nga shkaqe misterioze, që mbledhur një turmë e vogël. Kishte nisur prapë shiu i imtë, por njerëzit nuk largohen. Ata priten gjersa në krye të rrugës u dukën më në fund të arrestuarit të lidhur me pranga dy nga dy. Ftyrat e tyre dukeshin edhe më të verdha për shkak të flokëve të quillur që u binin si fitile mbi ballë. Po për atë shkak edhe sytë u dukeshin më të mëdhenj dhe si të palidhur mirë me ftyrat.

— Eremiti Frrok, eremiti Frrok, — thanë dy-tre zëra të trembur, kur vargu i të arrestuarve dhe xhandarëve u afrua edhe më. — Shiheni atë qyqar.

Eremiti, më i verdhë se të tjerët, por me një të verdhë të stohtë, midis së cilës dukej e pabesueshme që sytë të ruanin ende atë ndriçim etheje, vështronte ngultazi kureshtarët.

- Duart i kanë të gjakosura, o perëndi,
- pshëritiu një grua plakë. — S'bën kështu.
- Jo, nënë, — shpjegoi dikush. — Si duart me gjak, po prangat janë të ndryshkura dhe duken ashtu nga shiu.

Dy ditë më vonë reportazhi për ngjarjen në njëren nga gazetat e kryeqytetit fillonte pikërisht me përshkrimin e të arrestuarve që herë quheshin banditë, herë fanatikë, herë anëtarë të një sekti misterioz. Reportazhi jepte, pastaj, të dhëna për ngjarjen dhe mbyllej me përshkrimin e aparatit dhe bobinave të shkatërruara dhe me një intervistë të shkurtër krejt të turbullt të dy shkencëtarëve të huaj. Tani eposi është prapë i thërrmuar sic qe, — kishte thënë me lot në sy njëri prej tyre duke treguar me dorë telat e shqyer dhe të këputur. Ne u përpoqëm ta mblidhним atë, por... ai na u thërrmuva, ja kështu, si nga një katastrofë... Gazetari shkruante se shkencëtari i huaj kishte përmendur shumë herë fjalën «katastrofë», madje edhe «katastrofë kozmike».

## XI

Dy ditë ata qëndruan të mbyllur në një dhomë të hotelit «Globi» të N. pa pranuar të takonin kurrkënd, kurse ditën e tretë u nisën me një karrocë te hani «Rrashti i Buallit» pér të marrë valixhet. Koha ishte e vrenjtur dhe aq e ftohtë sikur të qe mesi i dimrit. Shtejfni që nuk e kishte Martinin, i ndihmoi të çonin valixhet gjer te karroca, pa folur pothuajse fare. Aparatin e kthyer tashmë në një rrangallë pa vlerë si dhe shumicën e bobinave të shkallimuara i lanë aty. Disa bobina që duke-shin më pak të dëmtuara deshën t'i merrnin me shpresë se diçka do të kishte mbetur në to, por në çastin e fundit Vili tha: léri më mirë, s'besoj se do të na duhen më.

Ai fërkonte vazhdimisht sytë me dorë dhe,

megjithëse nuk ankohej më, Maksi e kuptonte se vështrimi i qe mjegulluar përsëri. Ndërprerja e kurimit me lëngun, shishja e të cilat qe thyer bashkë me të tjerat, ia kishte keqësuar sytë krejt.

Ndërsa po hipnin në karrocë, kthyen dhe një herë kokën nga porta e hanit ku tabela gjysmë e shuar dukej se shpërndante një hije harrese dhe braktisjeje mbi gjithë peizazhin përreth. Të gjitha lëvizjet dhe zhurmat s'bënnin gjë tjetër veçse e bënин të prekshme një ndjesi hidhërimi dhe humbjeje të pandreqshme. I qenë afruar enigmës së Homerit dhe tamam kur ajo po u zbulohet, u kishte ikur në-për duar kot, fare kot. Disa herë, për t'i dhënë zemër vetes, kishin thënë se mund të vinin prapë, vitin e ardhshëm ose disa vjet më vonë, për të nisur nga e para kërkimet, por edhe vetë e dinin se kjo nuk ishte e vërtetë dhe se ata nuk do të vinin më. Sepse, edhe po të vinin, rapsodët nuk do t'i gjenin dot më, ose do t'i gjenin të rrallë e të shurdhët dhe jo vëtëm ata, por gjithë laboratorin e fundit do ta kishte mbuluar pluhuri i harresës. Epoka e eposeve kishte kaluar në botë dhe kishte qënë vërtet një rastësi që ata kishin kapur shkëndijimet e fundit të tyre përpara shuarjes së përjetshme. I kishin kapur dhe i kishin humbur prapë. Tisi i muzgut po binte përgjithmonë mbi truallin epik.

Ishte pikërisht ashtu: muzgu po binte përgjithmonë. Sepse një ardhje tjetër, megjithëse s'e thoshin, nuk e përfytyronin veçse si një udhëtim nëpër globin e ftohur tokësor, pas shuarjes së jetës kur sipër hirit mezi dukeshin gjurmët e shkopit të të verbrit të madh, të fshehtën e së cilës më kot ata qenë munduar ta zbulonin.

Kështu mendonin, ndërsa karroca po i afrohej N. ku ata do të rrinin gjer në fund të javës, në pritje të autobusit të kryeqytetit.

Ashtu si edhe më parë nuk dolën nga hoteli dhe nuk u takuan me njeri. Të fundit që patën punë me ta qenë hotelieri i «Globit» dhe hamalli Cute Arapi, i cili, pasi u çoi valixhet gjer te stacioni i autobusit, s'dihet përsë shkoi në mejhane, u bë tapë dhe nisi të qante e të kujtonte gruan e parë për të cilën gjer atëherë s'e kishin dëgjuar të fliste kurrë.

Kaluan ditë. Ishte mesi i një javë të zakonshme në N., nga ato javë pa ngjarje, kur shiu i hollë që binte ndihej menjëherë që ishte më tepër se pjesa e klimës së tij. Ai i shkonte N. dhe jo vetëm arkitekturës, por në njëfarë mënyre krejt stilit të jetës. Me shushurimën e shtruar monotone dukej se ai përpiquej t'i ndihmonte të gjithë për t'u çliruar nga ngarkesa e tepërt dhe për të korrigjuar mënjanimin ngajeta normale.

Në të vërtetë dimri i fundit, megjithëse

në fillim qetazi e si pa kuptuar, kishte sjellë gjëra të jashtëzakonshme në jetën e N. Ardhja e shkencëtarëve të huaj, emri i Homerit i lidhur tashmë me qytetin e tyre, thashethemet dhe përfytyrimet e zonjave, misteret te hani «Rrashti i Buallit», pastaj mbërritja e përgjuësit të anglishtes, sulmi misterioz të hani, prangat e përgjakura dhe ardhja e gazetarëve nga kryeqyteti, të gjitha këto kishin qenë tepër për një qytet të vogël si N. e aq më tepër të grumbulluara në një stinë të vetme.

Dhe ja tani e gjithë kjo po kalonte. Në kafenetë e qytetit ata që edhe më parë kishin qenë kundër vrullit të fantazisë, por që nën presionin e të tjerëve i kishin bërë udhë më në fund, tani përsëritnin me zë të lartë: Mirë na u bë, zotërinj, ç'na duhej neve ta lidhним emrin e qytetit tonë me emrin e një të vdekuri para katër a pesë mijë vjetësh. Kjo ishte vërtet një marrëzi e paparë. Të ishte fjala për ndonjë fabrikë salce apo hapjen e një qendre llixhash, për të cilën ka kohë që flitet, hajde de, e kuptueshme do të ishte, po kjo ishte fare pa kuptim. Nacionalizëm romantik. Idolatri e përenduar. Është njëlloj si të lidhesh me kapistall pas një fantazme. Dhe ç'fantazmë, zotërinj: një fantazmë e verbër!

Ata që dëgjonin tundnin kokat ngadalshëm si të thoshin: vërtet si kishin dalldisur gjer në atë shkallë sa të mos i kishin menduar

të gjitha këto? Një fantazmë e verbër, o përendi. Po nejse, shqyr që puna kishte marrë fund me kaq, se mund të kishte shkuar keq e më keq.

Kështu mendonin ata, por jo mjeku gjinekolog i N., atë pasdite të enjteje, tek rrinte te xhamllëku i madh i katit të parë të shtëpisë së tij, një pjesë të së cilës e kishte kthyer në klinikë private. Te rrugina e ngushtë, duke shkelur me kujdes për t'iu shmangur pellgjeve të vogla të ujit, po largohej nëpër shi silueta e gruas që ai porsa kishte vizituar. Në ftyrën gjatuce të mjekut diku midis mjekrës dhe buzës së poshtme (për shkak të gjatësisë, gjithçka në atë ftyrë ndodhë ndryshe nga ftyrat normale) kishte mbetur një si nënqeshje që mund të quhej njëkohësisht hutim i përzier me ironi dhe me kureshtje të sëmurë të kënaqur më në fund pas një pritjeje të gjatë. Jo, s'ishte aq e lehtë zhdukja e pasojave të ardhjes së dy të huajve në N.

Rrëshqitazi vështrimi i tij kapi rrözëlli-min e ftohtë të veglave mjekësore në raftin e bardhë. Për të zhdukur, për shembull, pasojat tek ajo grua, duhej ndërhyrë me ato vegla në barkun e saj. E pabesueshme, tha me vete, duke hapur sytë nga rrugina, ku gruaja qe zhdukur më në fund. Kaq vjet kishte pritur ardhjen e saj në klinikën e tij. Stinët iknin njëra pas tjetrës dhe ai mendonte: me sa duket

s'ka për ta tradhtuar nënprefektin. Por ajo kishte ardhur më në fund dhe pikërisht atëherë kur ai e kishte humbur shpresën. Dhe ishte pikërisht ashtu siç e priste: shtatzënë.

Me mollëza të skuqura ajo dëgjoi fjalët e tij: ju jeni shtatzënë, zonjë. Dhe pa pritur që ai të kërkonte ndonjë sqarim, thua se qyshkur e kishin bërë marrëveshjen e heshtur, ajo nisi të fliste. Jo, nuk kishte ndër mend ta fshihte prej tij (do të ishte madje pa kuptim), pra s'kishte ndër mend t'i fshihte asgjë, kishte pasur një aventurë dashurie me njërin prej dy shkencëtarëve homeristë dhe pikërisht me atë që vuante nga glaukomia... Këto kishin qenë pak a shumë fjalët e saj, të thëna gati automatikisht, si të mësuara përmendsh, ndërsa vishej me ngut, me sytë nga dera, pa iu përgjigjur pyetjes së tij se kur kishte ndër mend ta bënte abortin, si dhe fjalëve të fundit se parësisht se ai ishte një mjek province, ai dinte të ishte një xhentëlmen, kështu që ajo mund të ishte e sigurt se burri i saj s'kishte për ta marrë vesh kurrë të vërtetën.

E pra, eh, ia bëri mjeku, duke qëndruar ende në këmbë te xhamllëku i hirnosur prej shiut. Askush s'mund ta dijë kurrë se ç'mund të ndodhë në provinçat e thella. Dhe si një therje e vjetër reumatizmi e përsëritur nga lagështia e motit, i erdhi keqardhja që nuk kishte mbajtur shënimë për të gjitha këto.

Duhej të ishte po ajo ditë, kur në kuvertën e vaporit të udhëtarëve të linjës Durrës-Bari, që po nisej nga Shqipëria, Vili Norton dhe Maks Rothi, të mbështjellë me pelerinat e tyre, vështronin brigjet që sa vente largohe-shin. Në të vërtetë shikonte vetëm Maksi, sepse tjetri nuk dallonte pothuajse asgjë. Gjatë javës së pritjes së vaporit më kot shoku i tij qe përpjekur t'i mbushte mendjen që ta rifillonte mjekimin e syve, mirëpo Vili e kishte pritur çdo ndërhyrje të tij me një mospërfillje të plotë. Një herë i kishte thënë se do të fillonte mjekimin me të mbërritur në Nju-Jork, por ato fjalë i kishte shqiptuar me një ton të tillë ku nuk ishte e vështirë të dalloje dozën e fatalizmit.

Vjedhurazi Maksi vështronte profilin e shokut të tij, ndërsa mendonte se një dozë fatalizmi i qe krijuar me këtë rast dhe atij vetë. Hakmarrja e Homerit... Sado që qe përpjekur ta largonte atë mendim, ai kishte pikuar tinazi në ndërgjegjen e tij. I verbri i madh hakmerrje ndoshta me ata që kërkonin të gjenin enigmën e tij. Ishte ngjethëse ta mendoje, pa dyshim. Apo ndoshta ishte diçka e nevojshme kjo humbje e shikimit, njëfarë kërkese e fillimit për të qenë në gjendje t'i hyje mes përmes natës homeriike...

Ai lëvizi, si të donte të shkëputej nga

mendimi i zymtë. Iu kujtua se në xhep e kishte ende të pahapur gazeten që kishte blerë në port, para se të hipnin në vapor. E nxori dhe, duke u përpjekur ta qetësonte me njërën dorë gufmimin e saj prej erës, tha:

— Pa shih, pa shih. Paska dicka pér ne.

— Ashtu? — ia bëri Vili.

Gjetën një kënd ku nuk i zinte era dhe Maksi nisi të lexonte pér vete.

— Së shpejti do të hapet gjyqi i banditëve, — tha pas pák, duke ndërpërre leximin. — Paska një hamendje interesante se kush mund t'i ketë shtyrë kundër nesh.

— Vërtet? E ç'është ajo?

— Prit, — tha Maksi dhe lexoi një copë herë në hesktje. — Hm, këtu përmenden serbët.

— Ah, më ka shkuar mendja, — tha Vili.

— Ai murgu me pamje babloku, të kujtohet?

— Sigurisht. Ja, dëgjo ç'shkruan gazeta: «S'është herë e parë që shovinistët sllavë goditën kështu shkencëtarët që janë marrë me studimin e lashtësisë së etnisë dhe të kulturës shqiptare. Një egërsi dhe zili barbare, nga ato që shkaktohen, veç të tjerash, prej kompleksit të inferioritetit, i kap sidomos ata sa herë që dëgjojnë të bëhet fjalë pér prejardhjen e shqiptarëve prej ilirëve. Çdo shkencëtar që merret drejtpërdrejt apo tërthorazi me këtë, shpallet armik i tyre. Dhe kështu ata që dhjetë

vjet më parë, në një rruginë të errët të Zagrebit, vranë me një purtekë të hekurt dijetarin jugosllav Milan Shuflai, s'kishte pse t'u dridhej dora të goditnin dy homeristë të ardhur që përtej oqeanit.»

Vili vuri duart te tëmthi, ku kishte ende mbeturinën e fryrjes nga goditja.

— Si e ka lejuar censura mbretërore një shkrim të tillë? — tha ai me zë të dobët. — Me sa di unë, marrëdhënjet e mbretit Zog me Jugosllavinë janë normale.

— Do t'i ketë shpëtuar, — tha Maksi. — Ah, shiko, në faqet e brendshme ka prapë përnë.

Ndërsa ai lexonte, rrudhat mbi ballë po i lëviznin nga padurimi. Dy-tri herë tundi kokëu, u duk se do të buzëqeshtë, pastaj murmuriti: «E pabesueshme!»

— Çfarë? — pyeti Vili.

— E pabesueshme, Vil, — tha, pa i shkëputur sytë nga gazeta. — Epeventi që kërkonim është këtu. Dhe e di për kë është bërë? Oh, është vërtet e pabesueshme. Epeventi më i ri që mund të mendohet. Një ep për ne të dy.

— Ç'po flet?

— Ja, shiko këtu. Ah, po ti nuk i dallon dot gërmat. Më fal, Vili. E humba krejt. Prit të ta lexoj. Një aprath i zi ka dalë prej detit. Me këto fjalë fillon.

— Si, si? — ia bëri Vili.

- Një aprath i zi ka dalë prej detit.
- Ç'është kjo fjälë aprath? Unë nuk e di.
- Besoj se është fjala «aparat», ndryshuar sipas natyrës së shqipes, — tha Maksi.
- Pa dyshim që ashtu është. Dëgjoje më tutje:

*Një aprath, ehu, ka dal prej detit,  
Disa thonë ka ardhur për të mirë,  
Disa thonë ka ardhun veç për kob.*

*Ngjall bilbilat, thonë disa, kur ngrijnë,  
Ngrin lahutat, thonë, medet, disa.*

Maksi ngriti sytë si për ta ndarë çmeritjen me shokun e vet. Ende s'i besonte asaj që kishte lexuar.

— Ka më? — tha Vili. — Vazhdo.

Maksi u gëlltit, pastaj vazhdoi leximin:

*Eremiti Frrok doli nga shpella,  
Ku shtat vjet i myllun kish pas kenë.  
Disa thonë ka ken ai burrë i mirë,  
Disa thonë ka ken ai veç për kob.  
U përllesh, medet, ai me aprathin,  
Gjak i zi e vaj i zi ka rrjedhun,  
Fije-fije zorrët ia ka nxjerrun,  
Bjeshkë e qiell jan dridhun prej vikamës.*

Maksi ngriti sytë nga gazeta për të parë shokun. Vështrimi i tjetrit dukej i pakapshëm

me atë shkëputjen e zakonshme të kohëve të fundit.

— Qenka përnjimend për ne, tha, — në gjuhën shqipe. — Ç'keqkuptim tragjik!

Tani ishte vonë për ta ndrequr. Këndeja e tutje nëpërmjet atij keqkuptimi ata do të bënин pjesë në atë univers enigmatik. Rrethi vicioz qe mbyllur. Sirena e vaporit lëshoi një klithmë të zgjatur. Maksi deshi të shfletonte prapë gazetën, por diçka në fytyrën e Vilit ia mbajti vështrimin të mbërthyer. Iu duk se diçka bëhej gati të ndodhte në atë fytyrë. Diçka thithej që përbrenda me shpejtësi duke lënë sipër lëkurën e vjetër të gërryer nga era me sytë që, ashtu si gjithë sytë e gjysmë të verbërve, i ngjanin tani vështrimit të shtatoreve.

— Një aprath i zi ka dalë prej detit, — murmuriti ai me zë fare të ulët. Maksi disi i befasuar deshi të pyeste «çfarë?», por e ndjeu se pyetja s'kishte kuptim.

Papritur, me një lëvizje që Maksit iu duk si e një trupi tjetër, Vili nxori dorën e djathtë nga pelerina, e ngriti atë drejt fytyrës dhe, duke e hapur, e mbështeti pëllëmbën midis pjesës së sipërme të faqes dhe të veshit, ndërsa gishtërinjtë, si ndonjë kreshtë i dilnin sipër kokës. Gjesti i majekrahut, tha Maksi me vete, por nuk arriti të mendonte asgjë, sepse tjetri, ndërkaq, me një zë të lëmuar e anonim nisi të